



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 346 Akti

Nr. 419 Vendimi
Tiranë, më 12.7.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Brunilda Bekteshi	Kryesuese
Etleda Çiftja	Relatore
Pamela Qirko	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin, në datën 12.7.2021, ora 9:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mbylli seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Albert Spiro**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, komisionere Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit Albert Spiro, dhe pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Z. Albert Spiro është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të saj si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

2. Z. Albert Spiro, bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 12.11.2019, me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Alma Faskaj, Brunilda Bekteshi dhe Pamela Qirko.

3. Në datën 3.12.2019, përmes postës elektronike¹, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit për fillimin e procesit të rivlerësimit, e njoftoi mbi përbërjen e trupit gjykues dhe i kërkoi të deklaronte nëse gjendej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues. Komisioni, i kërkoi gjithashtu subjektit informacion shtesë sipas pyetësorit standard.

4. Me vendimin nr. 24, datë 10.4.2020, të Komisionit për rishpërndarjen me short dhe transferimin e çështjeve të komisioneres Alma Faskaj, në cilësinë e relatores së caktuar me procedurat e shortit të muajit nëntor të vitit 2018 dhe të muajve mars dhe nëntor të vitit 2019, është bërë ndryshimi i përbërjes së trupit gjykues, si pasojë e zëvendësimit për arsye shëndetësore të anëtares Alma Faskaj me anëtares Etleda Çiftja. Pas këtij ndryshimi, trupi gjykues përbëhet nga komisionerët Brunilda Bekteshi, Etleda Çiftja dhe Pamela Qirko.

5. Pas zëvendësimit të anëtarit të trupit gjykues, Komisioni, me anë të postës elektronike², njoftoi subjektin mbi këtë zëvendësim dhe i kërkoi të deklaronte nëse ishte në kushtet e konfliktit të interesit. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të tij³, deklaroi se nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit me anëtares zëvendësuese Etleda Çiftja.

6. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të

¹ E-mail, datë 3.12.2019, ora 12:17, “Njoftim për fillimin e procesit të rivlerësimit”.

² E-mail, datë 9.6.2020, ora 11:12, “Komisioni – njoftim për zëvendësim anëtari të trupit gjykues dhe deklarim i konfliktit të interesit”.

³ E-mail datë 9.6.2020, ora 16:49, Re: “Komisioni – njoftim për zëvendësim anëtari të trupit gjykues dhe deklarim i konfliktit të interesit”.

Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGj), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

7. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin datë 9.6.2020, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të caktojë kryesuese të trupit gjykues komisioneren Brunilda Bekteshi, të gjithë anëtarët të deklarojnë mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit, si dhe të fillojë hetimi administrativ i thellë dhe i gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit.

8. Trupi gjykues, me vendimin e datës 17.6.2021, vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit Albert Spiro, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, sipas ligjit nr. 84/2016, të drejtën për të paraqitur prova/shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; si dhe (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

9. Në datën 17.6.2021, përmes postës elektronike⁴, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën; si dhe (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative. Në këtë njoftim, subjektin iu kërkuua të paraqiste edhe shpjegime brenda datës 5.7.2021.

10. Në datën 5.7.2021 subjekti paraqiti pretendimet me shkrim dhe dokumentacionin justifikues bashkëlidhur pretendimeve në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht, me anë të postës elektronike⁵ dhe pranë zyrave të Komisionit.

11. Më tej, Komisioni, me anë të postës elektronike⁶, njoftoi subjektin e rivlerësimit se trupi gjykues, me vendimin e datës 5.7.2021, vendosi ta ftojë për t'u dëgjuar në seancën dëgjimore lidhur me rezultatet e hetimit për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, në datën 7.7.2021, ora 10:00, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe Kodin e Procedurave Administrative.

12. Bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Albert Spiro, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës, si dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

II. SEANCA DËGJIMORE

⁴ E-mail, datë 17.6.2021, ora 13:36, "Komisioni – Njoftim mbi përfundimin e hetimit administrativ kryesisht për procesin tuaj të rivlerësimit".

⁵ E-mail, datë 5.7.2021, ora 12:40, "Dërgim i shpjegimeve".

⁶ E-mail, datë 5.7.2021, ora 16:53, "Komisioni – Ftesë për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore publike".

13. Në datën 7.7.2021 u zhvillua seanca dëgjimore në prezencë të subjektit të rivlerësimit dhe në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht në seancë.

14. Relatori i çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryer mbi të tria kriteret e rivlerësimit dhe të kaluara si barrë prove apo për shpjegime.

15. Z. Albert Spiro, pasi dëgjoji relacionin, shprehu qëndrimin e tij, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij.

16. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi ta konsiderojë të plotësuar procesin e rivlerësimit për subjektin Albert Spiro, duke u bazuar mbi të tria kriteret e rivlerësimit.

17. Seanca dëgjimore e datës 7.7.2021 u ndërpre, për të rifilluar në datën 12.7.2021, për shpalljen e vendimit.

18. Në përfundim të seancës dëgjimore të datës 7.7.2021, subjekti i rivlerësimit Albert Spiro, kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

19. Subjekti i rivlerësimit Albert Spiro, ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

20. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

21. Sipas krerëve IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”: (i) ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror; (ii) DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjekti të rivlerësimit; dhe (iii) KLGJ-ja është organi ndihmës për vlerësimin profesional, i cili në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të pesë dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

22. Referuar vendimit nr. 2/2017⁷, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

23. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Albert Spiro, i cili është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

24. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private nga viti 2003 deri në vitin 2016 dhe në datën 26.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar “Deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar, *Vetting*”. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, është konstatuar se:

- deklarimi nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin;
- ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të justifikuar pasuritë;
- ka mosdeklarim pasurie ndër vite;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

25. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*, të vitit 2017”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI, për vitet 2003 – 2016; (ç) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) deklarimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; si dhe (dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, e në vijim, deri ditën e seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

⁷ Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultojnë se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

ka përfitur tokë bujqësore të llojit “arë”, me sipërfaqe totale 8015 m². Në datën 15.7.2005 ASHK-ja Gjirokastër ka regjistruar në pronësi të shtetasit K.R.S. pasuritë tokë bujqësore, të ndodhur në z. k. ***, fshati K., Gjirokastër, si vijon: (i) pasurinë e llojit “arë” me sip. 1200 m², me nr. ***; (ii) pasurinë e llojit “arë” me sip. 300 m², me nr. ***; (iii) pasurinë e llojit “arë” me sip. 300 m², me nr. pasurie ***; (iv) pasuria e llojit “arë” me sip. 1080 m², me nr. ***; (v) pasurinë e llojit “arë” me sip. 570 m², me nr. ***; (vi) pasurinë e llojit “arë” me sip. 150 m², me nr. ***; (vii) pasurinë e llojit “arë” me sip. 480 m², me nr. ***; (viii) pasurinë e llojit “arë” me sip. 570 m², me nr. ***; (ix) pasurisë e llojit “arë” me sip. 300 m², me nr. ***; (x) pasurinë e llojit “arë” me sip. 996 m², me nr. ***; (xi) pasurinë e llojit “arë” me sip. 100 m², me nr. ***; (xii) pasurinë e llojit “arë” me sip. 315 m², me nr. ***; (xiii) pasurinë e llojit “arë”, me sip. 330 m², me nr. ***; (xiv) pasurinë e llojit “arë” me sip. 1000 m², me nr. ***; (xv) pasurinë e llojit “arë” me sip. 390 m², me nr. ***.

1.4. Gjithashtu, nga dokumentacioni i dërguar nga ASHK-ja Gjirokastër¹⁰ konfirmohet se sipas listës së trojeve të fshatit K., në emër të shtetasit K.R.S. figuron e regjistruar edhe pasuria e llojit “truall” me sip. 300 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, nga të cilat 118 m² ndërtesë.

1.5. Nga shqyrtimi i kartelave të pasurive rezulton se shtetasi K.R.S. nuk është pajisur me certifikatë pronësie për pasuritë tokë bujqësore dhe truall + ndërtesë.

1.6. Nga dokumentacioni i administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile¹¹ vërtetohet se sipas certifikatës së gjendjes familjare të datës 1.8.1991, të fshatit K., familja e shtetasit K.R.S. përbëhej nga K.R.S., I.R.S. dhe Albert K. Spiro.

1.7. Me anë të pyetësorit nr. 2¹², subjektit iu kërkua informacion lidhur me datën e përfitimit të tokës bujqësore sipas AMTP-së nr. ***.

1.8. Në përgjigje¹³, subjekti deklaroi se ka qenë banor i zonës i regjistruar në gjendjen civile së bashku me dy prindërit e tij dhe se AMTP-ja është plotësuar dhe i është dorëzuar prindërve të tij, dhe nuk ka dijeni për datën e saktë, pasi nuk ka qenë i pranishëm për shkak se ka qenë në emigracion.

1.9. Komisioni i kërkoi shpjegime në lidhje me konstatimin se: (i) subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2013 ndryshimet në pjesën takuese në bashkëpronësinë e tokës bujqësore të përfitur sipas AMTP-së nr. *** dhe në bashkëpronësinë e pasurisë truall + ndërtesë nga trashëgimia.

1.10. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁴ subjekti i rivlerësimit shpjegoi se pjesa takuese në këtë pasuri është deklaruar në DIPP-në e vitit 2003 si “tokë bujqësore”, me sip. 0,8 ha, me pjesë zotëruese 33 %, me vendndodhje Z. dhe konstatimi i Komisionit mbi mosdeklarimin e ndryshimeve mbi këtë pasuri nuk është i saktë, pasi statusi juridik i nuk ka ndryshuar. Ato vazhdojnë të jenë në pronësi të familjes bujqësore K.R.S. dhe nuk ka çelur trashëgiminë ligjore pas vdekjes së dy prindërve të tij.

¹⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 15.4.2019; lista e trojeve e fshatit K.

¹¹ Shkresë nr. *** prot., datë 29.4.2021; certifikatë vdekjeje; certifikatë familjare e datës 1.8.1991.

¹² E-mail i datës 7.5.2021, ora 12:35.

¹³ E-mail i datës 13.5.2021, ora 19:33.

¹⁴ E-mail i datës 5.7.2021, ora 13:36.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

1.11. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

1.12. Nga hetimi administrativ u provua se pronësia e tokës bujqësore dhe e pasurisë truall + ndërtesë në emër të babait të subjektit, është përfituar sipas ligjit nr. 7501, “Për tokën”, në zbatim të cilit është plotësuar AMTP-ja nr. ***, pa datë, dhe sipas listës së trojeve të fshatit K., Gjirokastër. Komisioni vlerëson se pretendimi i subjektit se këto pasuri vazhdojnë të jenë në pronësi të familjes bujqësore të shtetasit K.R.S. dhe nuk ka çelur trashëgiminë ligjore për këtë pasuri pas vdekjes së prindërve të tij, qëndron dhe është i drejtë dhe i bazuar.

1.13. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka provuar burimin e ligjshëm të krijimit për këtë pasuri.

2. Apartament banimi me sip. 98 m² dhe garazh me sip. 25 m², në vlerën 6.500.000 lekë, në Vlorë

2.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti ka deklaruar apartament banimi me sip. 98 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, Vlorë, me vlerë 5.500.000 lekë, me pjesë takuese 50 % dhe garazh me sipërfaqe 25 m², blerë në vlerën 1.000.000 lekë, me pjesë takuese 50 %. Si burim krijimi deklaron të ardhurat nga shitja e apartamentit në Gjirokastër në shumën 6.200.000 lekë dhe kursimet familjare nga pagat. Për vërtetimin e deklaratimit subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues¹⁵.

2.2. Komisioni konstaton se nga dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017 dhe të administruar nga notere L.C.¹⁶, vërtetohet se ndërmjet subjektit, në cilësinë e porositesit, shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shtetasit Sh.L., në cilësinë e të porositurve/investitorëve, është lidhur kontrata paraprake e shitblerjes së sendit të ardhshëm me nr. ***, datë 30.12.2008, me objekt “blerjen e dy apartamenteve dhe një garazhi”. Në këtë

¹⁵ Certifikatë pronësie nr. ***, e pasurisë apartament nr. ***, me sip. 98 m², e ndodhur në z. k. ***, Vlorë, në pronësi të shtetasve Albert dhe M. S., bashkëlidhur kartelë pasurie, hartë treguese; kontratë shitjeje nr. ***, datë 7.1.2011; kontratë shitjeje nr. ***, datë 7.1.2011; kontratë kapari nr. ***, datë 9.12.2008; kontratë shitjeje nr. ***, datë 10.1.2009; nxjerrje llogarie, datë 17.10.2016, pranë BKT-së; dy kërkesa të datës 4.10.2016, nga shtetasi Albert Spiro, drejtuar Arkivit Qendror Shtetëror dhe Arkivit Vendor Shtetëror Gjirokastër; vërtetim nr. *** prot., datë 30.3.2015, nga BKT; vërtetim nr. extra prot., datë 10.10.2016, lëshuar nga Arkivi Shtetëror Vendor Gjirokastër; vërtetim nr. *** prot., datë 12.10.2016, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave; vërtetim hipotekor nr. ***, datë 24.6.2004, për pasurinë apartament banimi nr. ***, me sip. 104.9 m², i ndodhur në z. k. ***, lagjja “****”, Gjirokastër, në pronësi të shtetasve Albert dhe M.S. dhe harta treguese; kontratë shitjeje nr. ***, datë 12.5.2003, midis Entit Kombëtar të Banesave Gjirokastër dhe shtetasit Albert Spiro, për apartamentin e ndodhur në lagjen “****”, Gjirokastër, bashkëlidhur formulari nr. ***, kontratë për privatizim banese, formulari nr. *** për treguesit kryesorë për apartamentin, planimetria e apartamentit dhe gjenplani; certifikatë pronësie për pasurinë nr. ***, z. k. ***, në pronësi të shtetasve Albert M.S.; kartelë pasurie nr. ***, z. k. ***, hartë treguese; kontratë shitjeje nr. ***, datë 7.1.2011; kontratë paraprake nr. ***, datë 30.12.2008.

¹⁶ Shkresë e datës 28.4.2021, ku janë administruar: kontratë paraprake nr. ***, datë 30.12.2008; kontratë shitjeje nr. ***, datë 7.1.2011; kontratë shitjeje nr. ***, datë 7.1.2011; kontratë shitjeje nr. ***, datë 7.1.2011.

kontratë është parashikuar çmimi total prej 50.300 euro dhe termat e pagesës sipas të cilave në datën e prenotimit¹⁷ është paguar nga pala porositëse: kësti i parë në vlerën 26.000 euro; më tej është parashikuar që kësti i dytë me vlerë 10.000 euro do të likuideohej deri më 30.3.2009; kësti i tretë me vlerë 10.000 euro do të likuideohej deri më 30.6.2009; dhe kësti i fundit me vlerë 4.300 euro do të likuideohej deri në datën 30.8.2009.

2.3. Nga dokumentacioni i administruar nga ASHK-ja Vlorë¹⁸ rezulton se ndërmjet subjektit, shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shtetasit Sh.L. janë lidhur këto kontrata: (i) kontrata e shitjes nr. ***, datë 7.1.2011, sipas të cilës subjekti ka blerë pasurinë apartament, me sipërfaqe 44 m², kundrejt çmimit 2.500.000 lekë¹⁹; (ii) kontrata e shitjes nr. ***, datë 7.1.2011, sipas të cilës subjekti ka blerë pasurinë apartament me sipërfaqe 54 m², kundrejt çmimit 3.000.000 lekë²⁰; (iii) kontrata e shitjes nr. ***, datë 7.1.2011, me anë të së cilës subjekti ka blerë pasurinë garazh me sipërfaqe 25 m², kundrejt çmimit 1.000.000 lekë²¹. Në këto kontrata, palët janë shprehur se likuidimi i çmimit është bërë nga pala blerëse jashtë zyrës noteriale pa përcaktuar se kur janë bërë këto pagesa.

2.4. Referuar dokumentacionit të ZVRPP-së Vlorë²², të paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017, vërtetohet se është bërë bashkimi i dy apartamenteve që në ndërtim dhe më pas është bërë regjistrimi tyre pranë ZVRPP-së si një pasuri e vetme me nr. pasurie ***, me sipërfaqe totale 98 m².

2.5. Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit të rivlerësimit me shoqërinë “****” sh.p.k., ortakun/administrator G.Xh., ortakët K.Xh., F.Xh. dhe T.Xh., duke i dërguar shkresë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë²³ dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë²⁴ (për shkak se ka trashëguar arkivën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tepelenë). Nga dokumentacioni i dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë²⁵ dhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë²⁶ rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk kishte gjykuar procese gjyqësore me këto palë.

2.6. Për të analizuar mjaftueshmërinë dhe ligjshmërinë e të ardhurave për blerjen e këtij apartamenti, Komisioni analizoi fillimisht të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në Gjirokastrë, si vijon:

Të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në Gjirokastrë

2.7. Nga hetimi i Komisionit rezultoi se sipas dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti në deklaratën *Vetting*, të administruar dhe nga noter B.Xh.²⁷, ndërmjet subjektit, bashkëshortes

¹⁷ Si datë porosie është vendosur data 29.12.2008.

¹⁸ Shkresë nr. ***, datë 22.1.2020.

¹⁹ Nr. pasurie ***, z. k. ***, Vlorë.

²⁰ Nr. pasurie ***, z. k. ***, Vlorë.

²¹ Nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***.

²² Shkresë e datës 24.1.2013, bashkim pasurie, e ZVRPP-së Vlorë.

²³ Shkresë nr. *** prot., datë 14.4.2021; shkresë nr. *** prot., datë 20.4.2021.

²⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 20.4.2021; shkresë nr. *** prot., datë 18.5.2021.

²⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 19.4.2021; shkresë nr. *** prot., datë 22.4.2021.

²⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 24.5.2021.

²⁷ Protokolluar me nr. *** prot., datë 20.5.2021.

M.S. dhe shtetasit P.Ll. është nënshkruar kontrata e kaparit nr. ***, datë 9.12.2008. Në këtë kontratë shtetasit Albert dhe M.S. deklarojnë se i kanë marrë shtetasit P.Ll. shumën prej 3.200.000 lekësh, që përbën një pjesë të çmimit të shitjes së një apartamenti banimi të regjistruar me nr. **. Në vijim, palët deklarojnë se çmimi i shitjes do të jetë 6.200.000 lekë dhe pjesa e mbetur e çmimit do të likuideohej nga blerësi menjëherë pasi të përfitojë kredinë për të cilën ka aplikuar në Bankën Popullore.

2.8. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur lëvizjet e llogarisë bankare të bashkëshortes M.S., ku pasqyrohen këto transaksione²⁸: (i) në datën 9.12.2008 shtetasi P.Ll. ka transferuar shumën 3.200.000 lekë me përshkrimin “P.Ll., likuidim detyrimi për blerje apartamenti në favor të M.S.”. Më pas, kjo shumë është transferuar në datën 15.12.2008, në favor të shtetasit Sh.L., me përshkrimin “M.S. sa kalon për Sh.L. blerje banese”; (ii) në datën 14.1.2009 shtetasi P.Ll. ka transferuar shumën 3.000.000 lekë, me përshkrimin “P.Ll. ose L.H. për M.S. lik. detyrimi për blerje apartamenti B/O Banka Popullore”. Më tej, kjo shumë është kaluar në depozitë me afat, që është maturuar në datën 17.4.2009. Po në këtë datë është transferuar në favor të shtetasit Sh.L. shuma 1.935.000 lekë, me përshkrimin “M.S. sa kalon për Sh.L., detyrim”.

2.9. Nga veprimet e mësipërme bankare provohet se shuma që subjekti ka përfituar nga shitja e apartamentit në Gjirokastrë është 6.200.000 lekë.

2.10. Nga ana tjetër, subjekti ka paraqitur në deklaratën *Vetting* të vitit 2017 kontratën e shitjes nr. ***, datë 10.1.2009, të administruar nga ASHK-ja Gjirokastrë²⁹, me palë shitëse subjektin dhe bashkëshorten e tij dhe palë blerëse shtetasin P.Ll., ku parashikohet shitja e pasurisë me sip. 104,9 m², me nr. **, z. k. **, vol. **, f. **, ku çmimi i shitjes është vendosur në vlerën 4.479.230 lekë dhe çmimi për m² në vlerën 42.700 lekë. Në kontratë palët deklarojnë se çmimi është likuiduar tërësisht nga blerësi dhe shitësit e kanë marrë tërësisht. Gjithashtu, është administruar edhe kopje e depozitimit në BKT e pagesës prej 273.123 lekësh, në datën 30.12.2009, me përshkrimin “Albert Spiro sa derdh tatim shitje, sipas kontratës nr. **, datë 10.1.2009” .

2.11. Me anë të pyetësorit nr. 2³⁰, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit lidhur me çmimin e shitjes së këtij apartamenti dhe për paraqitjen e dokumentacionit që provon pagesën e detyrimeve tatimore mbi fitimin e realizuar nga shitja e kësaj pasurie.

2.12. Në përgjigje³¹, subjekti deklaroi se çmimi i shitjes së pasurisë apartament banimi në Gjirokastrë është 6.200.000 lekë, sipas parashikimit në kontratën e kaparit. Diferenca ndërmjet kontratës përfundimtare të shitjes dhe kontratës së kaparit është për shkak se apartamenti është shitur së bashku me arredimin dhe të gjitha pajisjet elektroshtëpiake. Duke mos pasur të pasqyruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme koston e ndërtimit dhe midis shitësve dhe blerësve nuk kishte kundërshtime, me sugjerim edhe të noteres, hartimi i kontratës noteriale të shitjes me nr. **, datë 10.1.2009, është bërë me çmimin e referencës së shitjes së pasurisë së paluajtshme. Gjithashtu, subjekti deklaroi se ZVRPP-ja Gjirokastrë ishte e paqartë lidhur me llogaritjen e vlerës së banesës si në vitin 2003 kur është bërë regjistrimi i parë, edhe në

²⁸ Informacion i cili konfirmohet edhe nga dokumentacioni i përcjellë nga BKT-ja me shkresë nr. ***, prot., datë 17.1.2020.

²⁹ Shkresë nr. ***, prot., datë 15.4.2019.

³⁰ E-mail i datës 7.5.2021.

³¹ E-mail i datës 13.5.2021, ora 19:33.

momentin e lidhjes së kontratës në vitin 2009. Detyrimi tatimor është paguar në fund të vitit 2009, pasi vetëm në atë moment u saktësua shuma që duhej paguar si detyrim tatimor. Bashkëlidhur ka paraqitur edhe dokumentacionin provues³².

2.13. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: (i) ka mospërputhje në lidhje me çmimin e shitjes së këtij apartamenti midis kontratës së kaparit të datës 9.12.2008 (në vlerën 6.200.000 lekë) dhe kontratës së shitjes së datës 10.1.2009 (në vlerën 4.479.230 lekë); dhe (ii) duket se subjekti ka shmangur detyrimet tatimore për shkak se mungon dokumentacioni ligjor justifikues për pagesën e tatimit për shumën 1.720.770 lekë, e cila vjen nga diferenca midis shumës së rënë dakord në kontratën e kaparit dhe vlerës së kontratës së shitjes.

2.14. Në përgjigje të rezultateve të hetimit³³ subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se çmimi total i shitjes së pasurisë apartament banimi në Gjirokastrë është 6.200.000 lekë, sipas parashikimit në kontratën e kaparit dhe pagesa është bërë nëpërmjet bankës nga blerësi. Diferenca midis kontratës përfundimtare të shitjes dhe kontratës së kaparit vjen për shkak se apartamenti është shitur së bashku me mobilimin dhe të gjitha pajisjet elektroshtëpiake. Për vërtetimin e këtij deklarimi subjekti paraqiti deklaratën noteriale nr. ***, datë 21.6.2021, të shtetasit P.Ll., i cili ka deklaruar se: *“[...]banesën e bleva me të gjitha orenditë e brendshme, sendet e luajtshme që përbënin dy dhoma gjumi të kompletuara, kuzhina me gjithë orenditë me aneksin, një korridor i mobiluar, si dhe të gjitha sendet elektroshtëpiake. Ata morën vetëm sendet e tyre personale. Fillimisht kemi nënshkruar kontratën e kaparit në vlerën 6.200.000 lekë dhe pasi pagova 3.200.000 lekë m’u dorëzua banesa dhe fillova të banoj në të. Në fillim të vitit 2009 pagova edhe shumën tjetër prej 3.000.000 lekësh dhe të dyja shumat janë paguar nëpërmjet bankës”*.

2.15. Në vijim, subjekti ka shpjeguar se shitjen e mobilimit dhe të elektroshtëpiakeve në banesë e tregon edhe deklarimi i tij në vitet 2009 – 2010, ku ka deklaruar shpenzime për mobilim për shtëpinë në Vlorë të blerë në këtë periudhë, pasi ishte shitur mobilimi i mëparshëm. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se qëllimi i nënshkrimit të kontratës së kaparit ka qenë sigurimi i palës blerëse për dhënien e parave deri në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitjes dhe nuk i kushtoi shumë vëmendje përshkrimit të pronës dhe sendeve të shitura me të, por janë përshkruar si çmim i shitjes së apartamentit të banimit.

2.16. Lidhur me vlerën e vendosur në kontratën e shitjes, subjekti ka sqaruar se, duke mos pasur të pasqyruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme koston e ndërtimit të objektit, me pëlqimin e blerësit dhe me sugjerimin e noteres u hartua kontrata e shitjes me çmimin e referencës së shitjes së pasurisë së paluajtshme të zonës. Në vijim, subjekti ka shpjeguar se dhënia e kaparit në vlerën 6.200.000 lekë është realizuar me akt publik, e cila tregon se nuk ka pasur qëllim fshehjen e vlerës së marrë dhe shmangien e detyrimeve tatimore. Gjithashtu, sqaron se, duke qenë se banesa e tij ishte një pasuri e fituar nga Enti Kombëtar i Banesave, në

³² Kontratë shitjeje nr. ***, datë 23.5.2003; vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. ***, datë 24.6.2004; kontratë shitjeje nr. ***, datë 10.1.2009; dhe mandatpagesë e datës 30.12.2009, e BKT-së.

³³ E-mail i datës 5.7.2021, ora 12:40.

kontratën e të cilës nuk ishin mirëpërcaktuar të dhënat si kosto e ndërtimit të ndërtesës, sipërfaqja e banesës, etj., palët e përfshira në të u ndeshën me vështirësi në përcaktimin e kostos së ndërtimit si element në llogaritjen e tatimit të fitimit. Sipas informacionit të publikuar në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve³⁴ rezulton se udhëzimi i përbashkët nr. 29, datë 30.7.2018, “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme”, ka shfuqizuar udhëzimin nr. 9, datë 26.2.2008, “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme”, i ndryshuar. Pra, në momentin e shitjes së banesës në Gjirokastrë në datën 10.1.2009, duhej të aplikoheshin tatimi sipas llogaritjeve të këtij udhëzimi. Në këtë udhëzim³⁵, pika 6.2 përcaktohet se: *“Për ndërtesat e ndërtuara dhe të regjistruara pas datës 1.1.1996 e në vitet në vijim, të cilat nuk kanë vlerë në blerje, për efekt të përcaktimit të tatimit për kalimin e së drejtës së pronësisë, si vlerë minimale në blerje, do të merret kosto mesatare për 1 m² të sipërfaqes së shfrytëzueshme e përcaktuar nga Enti Kombëtar i Banesave në: [...] në Udhëzimin e Kryeministrit nr. 1, datë 8.5.2003 [...]”*.

2.17. Referuar Udhëzimit nr. 1, datë 8.5.2003, të Kryeministrit, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB-ja, të vlerave të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit K”, është përcaktuar se kostoja mesatare për 1 m² e sipërfaqes së shfrytëzueshme në qytetin e Gjirokastrës është 28.967 lekë/m². Duke qenë se këto ishin udhëzimet në fuqi, që aplikoheshin nga zyrat e pasurive të paluajtshme në atë kohë për llogaritjen e “Tatimit për kalimin e të së drejtës së pasurisë së paluajtshme”, në rastin e tij është llogaritur vlera e tatimit për totalin e shumës së përfituar prej 6.200.000 lekësh.

2.18. Subjekti ka paraqitur një tabelë, ku ka interpretuar dy mënyra për llogaritje të shumës së paguar për tatimin në vlerën 273.123 lekë, konkretisht: (i) sipas kontratës së shitjes, ku është pasqyruar diferencën midis vlerës së shitjes prej 4.479.230 lekësh me vlerën 3.038.638 lekë (sipërfaqe x koston mesatare e ndërtimit për sipërfaqe të shfrytëzueshme të vitit 2003), pra 1.440.592 x 10%, nga ku ka rezultuar detyrimi tatimor në vlerën 144.059 lekë përkundrejt shumës së paguar prej 273.123 lekësh; dhe (ii) sipas kontratës së kaparit, ku është pasqyruar diferenca midis vlerës së pasqyruar në kontratën e kaparit prej 6.200.000 lekësh me vlerën 430.000 lekë (të përshkruar si vlerë mobilimi/arredimi) dhe me vlerën 3.038.638 lekë (sipërfaqe x koston mesatare e ndërtimit për sipërfaqe të shfrytëzueshme të vitit 2003), pra, 2.731.362 x 10%, nga ku ka rezultuar detyrimi tatimor në vlerën 273.136 lekë përkundrejt shumës së paguar prej 273.123 lekësh.

2.19. Sipas subjektit, ZVRPP-ja Gjirokastrë ka llogaritur tatimin mbi vlerën e përcaktuar në kontratën e kaparit nr. ***, datë 9.12.2008, në shumën 6.200.000 lekë, duke e vlerësuar arredimin në shumën 430.000 lekë, ndërkohë që në pyetësin standard ka deklaruar se vlera e investuar në këtë apartament është rreth 1.000.000 lekë dhe jo 430.000 lekë sa e ka llogaritur ZVRPP-ja, duke paguar në mënyrë jo të saktë dhe për vlerën e sendeve të luajtshme mobilimin. Gjithashtu, subjekti shpjegon se ZVRPP-ja Gjirokastrë, si në momentin e regjistrimit të pasurisë mbi bazën e kontratës së vitit 2003, edhe në momentin e shitjes së pasurisë, kishte paqartësi për llogaritjen e vlerës së banesës. Vështirësitë konfirmohen nga fakti se megjithëse kontrata e shitjes është lidhur në datën 10.1.2009 dhe aplikimi është bërë në këtë periudhë,

³⁴ <https://www.tatime.gov.al/d/8/45/0/731/mbi-kalimin-e-se-drejtës-se-pronësisë-se-paluajtshme-dhe-taksat-e-tatimet-qe-do-te-llogariten->

³⁵ Udhëzimin nr. 9, datë 26.2.2008, ndryshuar me udhëzim nr. 21, datë 26.2.2009 (fletore zyrtare nr. 18, datë 26.2.2009).

pagesa e detyrimit tatimor është bërë në datën 30.12.2009, rreth 12 muaj më vonë, si dhe nga fakti që nuk ka paguar penalitete.

2.20. Në lidhje me pagimin e detyrimeve tatimore, subjekti ka shpjeguar se për shitjen e sendeve (mobilim, elektroshtëpiake) nuk ka parashikim ligjor që të përcaktojë detyrime tatimore mbi shitjen e sendeve të luajtshme. Madje, Komisioni, në praktikën dhe vendimet e marra, ka konsideruar të ardhura të ligjshme të ardhurat nga shitja e sendeve ose pasurive të luajtshme, si automjetet etj. Në vijim, shpjegon se vlera e blerjes së elektroshtëpiakeve dhe çmimi i mobilimit ka qenë në vlerë më të lartë se vlera e shitur. Megjithëse nuk ka mbajtur fatura për të provuar vlerën e blerjes së tyre është përpjekur të gjejë dëshmi dhe prova të tjera, por për shkak të periudhës shumë të gjatë, vlerave të vogla të blerjes së tyre dhe mospasjes së kontakteve me disa prej shitësve ku ka bërë mobilimin apo blerë elektroshtëpiaket, deklaroi se është në pamundësi objektive, sipas përcaktimeve të nenit 32.2 të ligjit nr. 84/2016.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

2.21. Komisioni, referuar: (i) deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

2.22. Lidhur me pretendimin e subjektit se kontrata e shitjes është hartuar me çmimin e referencës së shitjes së pasurisë së paluajtshme të zonës, Komisioni vëren se, bazuar në Udhëzimin nr. 1, datë 20.8.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kosto mesatare të ndërtimit të banesave, nga EKB-ja për vitin 2008”, kostoja mesatare e shitjes lekë/m², sipërfaqe shfrytëzimi në tregun e lirë sipas tabelës nr. 2, “Të dhënat e tregut të lirë të apartamenteve sipas qyteteve”, për qytetin e Gjirokastrës është 53.731 lekë/m² për sipërfaqe shfrytëzimi, përkundrejt çmimit 42.700 lekë/m² të kontratës së shitjes (5.636.382 lekë përkundrejt 4.479.230 lekë).

2.23. Në pikën 6.2 të udhëzimit nr. 9, datë 26.2.2008, “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme”, i ndryshuar, parashikohet se për ndërtesat e ndërtuara dhe të regjistruara nga 1.1.1996 deri më 31.12.2002, të cilat nuk kanë vlerë në blerje, për efekt të përcaktimit të tatimit për kalimin e së drejtës së pronësisë, si vlerë minimale në blerje, do të merret kosto mesatare për m² e sipërfaqes së shfrytëzueshme, e përcaktuar nga Enti Kombëtar i Banesave në: vendimet e Këshillit të Ministrave: nr. 815, datë 9.12.1996; nr. 13, datë 5.1.1998; nr. 214, datë 28.4.1999 dhe nr. 362, datë 14.7.2000; udhëzimet e Kryeministrit nr. 5, datë 31.5.2001 dhe nr. 3, datë 16.10.2002. Referuar vendimit nr. 13, datë 5.1.1998, kostoja mesatare e ndërtimit për sipërfaqe të shfrytëzueshme në qytetin e Gjirokastrës ka qenë 27.704 lekë/m², duke rezultuar në një shumë prej 2.906.150 lekësh për apartamentin në fjalë.

2.24. Pra, pavarësisht se ASHK-ja Gjirokastër nuk e disponon formularin e përlllogaritjes së tatimit për kalimin e pronësisë, nëse aplikohet norma 10 % mbi diferencën midis shumës 5.636.382 lekë (sipërfaqe e vlerësuar me çmim reference në vitin e shitjes) me shumën 2.906.150 lekë (sipërfaqe e vlerësuar me çmim reference në vitet e ndërtimit), rezulton shuma

273.023 lekë³⁶, saktësisht e barabartë me shumën e tatimit të depozituar për llogari të tatim-taksave në datën 30.12.2009, në BKT.

2.25. Lidhur me pretendimin e subjektit se diferenca midis kontratës përfundimtare të shitjes dhe kontratës së kaparit vjen për shkak se apartamenti është shitur së bashku me mobilimin dhe të gjitha pajisjet elektroshtëpiake, Komisioni vlerëson se ky pretendim është i pabazuar, për atë që nuk është pasqyruar as në kontratën e kaparit dhe as në kontratën e shitjes. Për sa i përket kontratës noteriale të shtetasit P.Ll., blerësi i këtij apartamenti, Komisioni vlerëson se kjo deklaratë nuk mund të merret në konsideratë si provë, duke qenë se është hartuar vetëm pas konstatimit të mospërputhjes nga ana e këtij të fundit.

2.26. Për sa i përket vlerës së shpenzimeve të mobilimit prej 430.000 lekësh e paraqitur në përlllogaritjet e kryera nga subjekti, duket se është përcaktuar në funksion të arritjes së rezultatit prej 273.123 lekësh (vlera e detyrimit tatimor të paguar).

2.27. Në përfundim, rezulton se detyrimet tatimore janë paguar mbi çmimin 5.636.382 lekë dhe jo 6.200.000 lekë dhe, për rrjedhojë, ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën 563.618 lekë.

2.28. Në çdo rast, kjo nuk zhbën faktin se subjekti ka nënshkruar një kontratë me çmim shitjeje jo në përputhje me kontratën e kaparit dhe transfertat që janë kryer nga blerësi për këtë apartament.

2.29. Në këto kushte, Komisioni vlerëson se nga analizimi i përlllogaritjes së tatimit mbi shitjen e pasurisë rezulton e provuar se tatimi është paguar për vlerën 5.636.382 lekë dhe rezulton se detyrimet tatimore nuk janë paguar për vlerën prej 563.618 lekësh, e cila nuk u mor në konsideratë në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.

2.30. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën 563.618 lekë, për efekt të llogaritjes së pagesës së tatimit mbi shitjen, duke u gjendur në kushtet e gremës “b”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

2.31. Më tej, Komisioni analizoi burimin e krijimit/blerjes së apartamenti në Gjirokastër dhe mënyrën e fitimit të pronësisë.

2.32. Nga dokumentacioni i administruar nga ASHK-ja Gjirokastër³⁷, rezulton se në kontratën noteriale të shitjes së truallit me nr. ***, datë 23.5.2003, të lidhur ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe Entit Kombëtar të Banesave, Drejtoria Rajonale Gjirokastër, EKB deklaroi se në cilësinë e shitësit ka në pronësi të tij një pasuri të paluajtshme truall, të ndodhur në lagjen “***”, Gjirokastër, mbi të cilin është ndërtuar një pallat ish “***”, ***-katësh, i ndërtuar në vitin 1996 me mjetet financiare të secilit pronar të apartamenteve përkatëse të këtij pallati dhe se i shet palës blerëse sipërfaqen takuese të truallit, ku përfshihet sipërfaqja e ndërtimit të apartamentit, plus ambientet e përbashkëta me sip. 23,08 m², në vlerën 8.309 lekë.

³⁶ Shuma totale prej 273.123 lekësh e përbërë nga 273.023 lekë, paguar për ZVRPP-në dhe 100 lekë komision bankar.

³⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 15.4.2019; kontratë noteriale e shitjes nr. ***, datë 23.5.2003.

2.33. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003, subjekti ka deklaruar: shtëpi banimi (apartament) me sip. 120 m², të blerë në vitin 1997 dhe në kolonën e vlerës ka shënuar 26.000 USD. Si burim krijimi ka deklaruar të ardhura nga emigracioni në vitet 1992 -1997.

2.34. ILDKPKI-ja³⁸ ka vënë në dispozicion të Komisionit procesverbalet e mbajtura në datat 20.3.2015 dhe 16.4.2015, si dhe dokumentacionin e paraqitur nga subjekti. Në procesverbalin e datës 20.3.2015, subjekti ka deklaruar se përpara vitit 1998 ka qenë emigrant në shtetin grek, ku ka punuar për një periudhë 7-vjeçare dhe apartamentin e ka porositur në vitin 1997 dhe kur ka filluar punë si ndihmësgjyqtar në vitin 1998 ka hyrë në të. Të njëjtin deklaram e ka bërë edhe në procesverbalin e datës 16.4.2015. Në shpjegimet e tij, në vijim të procesverbalit të datës 20.3.2015, subjekti ka deklaruar se, në lidhje me dokumentacionin për të ardhurat e siguruara, i është drejtuar bankave të nivelit të dytë në Gjirokastrë, ku ka pasur depozitat e siguruara nga emigracioni përpara vitit 1997, por nuk i kanë kthyer përgjigje. Verbalisht i është thënë se për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar ky dokumentacion nuk ruhet. Nga dokumentacioni i paraqitur në ILDKPKI, konstatohet se BKT-ja Gjirokastrë³⁹ e informon se në vitet 2006 – 2007, me kërkesë të Arkivit Qendror të Shtetit, banka ka dorëzuar pranë këtij institucioni dokumentacionin që i përkiste periudhës përpara vitit 2000. Në deklaratën *Vetting* 2017 subjekti ka dorëzuar edhe shkresën e Arkivit Shtetëror Vendor Gjirokastrë⁴⁰, që e bën me dije se ky institucion nuk ka tërhequr asnjë dokument bankar.

2.35. Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 2⁴¹, i kërkoi informacion subjektit lidhur me koston e këtij apartamenti, kohën e përfundimit të tij, si dhe i kërkoi të paraqesë të gjithë dokumentacionin që provon burimin dhe justifikon ligjshmërinë e të ardhurave nga emigracioni.

2.36. Në përgjigje⁴², subjekti ka deklaruar se kostoja e ndërtimit të apartamentit ka qenë 26.000 USD, afërsisht 2.600.000 lekë me kursin e kohës dhe marrëveshja për kryerjen e punimeve është bërë në vitin 1996. Sipas tij ndërtimi ka përfunduar në vitin 1997 dhe në fillim të vitit 1998, përpara fillimit të detyrës si ndihmësgjyqtar, ka filluar të banojë në të. Në vijim, subjekti ka deklaruar se noterja ku ka nënshkruar marrëveshjen ka ndërruar jetë dhe nga noterja që i ka kaluar arkiva i është kthyer përgjigje se nuk e disponon këtë marrëveshje. Për vërtetimin e këtij deklarimi ka dorëzuar shkresën e noteres G.R. K.⁴³

2.37. Për sa i përket burimit të ligjshëm të krijimit të të ardhura nga emigracioni, në përgjigje të pyetësorit nr. 2⁴⁴, subjekti ka deklaruar se në emigracion kishte siguruar të ardhura në vlerën 4.000.000 lekë, të cilat i përdori për ndërtimin dhe arredimin e këtij apartamenti. Këto të ardhura i kishte depozituar në Bankën e Kursimeve Gjirokastrë, por dokumentacioni nuk ekziston në arkiv sipas përgjigjeve të kthyera nga këto institucione⁴⁵, për shkak se llogaria ishte

³⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 23.4.2021; procesverbal i datës 20.3.2015; procesverbal i datës 16.4.2015; vijim i procesverbalit të datës 20.3.2015; shkresë nr. *** prot., datë 13.4.2015, e noteres G.R. K.; vërtetim nr. *** prot., datë 30.3.2015, i BKT-së; fotokopje e pasaportës.

³⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 30.3.2015.

⁴⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 10.10.2016, e Arkivit Shtetëror Vendor Gjirokastrë.

⁴¹ E-mail i datës 7.5.2021.

⁴² E-mail i datës 13.5.2021, ora 19:33.

⁴³ Shkresë nr. *** prot., datë 13.4.2015.

⁴⁴ E-mail datë 13.5.2021.

⁴⁵ Dosje e ILDKPKI-së, vërtetim datë 10.10.2016, nga Arkivi Shtetëror Gjirokastrë, paraqitur nga subjekti.

mbyllur dhe ai nuk ruhej më në momentin e kërkimit në vitin 2015. Në vijim, subjekti ka deklaruar se ka qenë vazhdimisht me viza 1-vjeçare të dhëna nga autoritetet greke, por në shtetin grek nuk ka qenë i regjistruar si punëmarrës dhe i siguruar, për shkak se kryerja e këtyre procedurave u përkiste punëdhënësve dhe në situatën që ka shkuar nuk kishte asnjë mundësi të ndikonte që të legalizohej si punëmarrës. Gjithashtu, ai ka shpjeguar se ka kryer punë të ndryshme si në sektorin e ndërtimit etj., në punëmarrës të ndryshëm dhe për shkak se ka kaluar një kohë shumë e gjatë, 25-30 vjet, nuk ka mbajtur komunikime dhe është në pamundësi të sigurojë deklaratimet se është punësuar prej tyre. Komisioni konstaton se subjekti ka paraqitur pranë ILDKPKI-së kopje të pasaportës së lëshuar në datën 3.3.1996, ku pasqyrohet se është pajisur me vizë 1-vjeçare në shtetin grek nga data 25.11.1997 – 25.11.1998.

2.38. Subjekti ka deklaruar se është në dijeni të qëndrimit të mbajtur nga Komisioni dhe Kolegji në lidhje me vlerësimin e këtyre të ardhurave dhe thekson se ato janë siguruar dhe përdorur para fillimit të detyrës, dhe në kuptim të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016 është në pamundësi objektive për paraqitjen e akteve provuese.

2.39. Për vërtetimin e deklarimeve ka paraqitur deklaratën noteriale të ish-kryetarit të komunës Z.⁴⁶, të bashkëfshatarëve⁴⁷ dhe të afërmeve të tij⁴⁸ me të cilët ka qenë në Athinë, Greqi dhe kanë dijeni për të ardhurat dhe përdorimin e tyre.

2.40. Në vijim, Komisioni kërkoi informacion nga Enti Kombëtar i Banesave me qëllim përcaktimin në mënyrë shteruese të momentit të blerjes së kësaj prone nga subjekti i rivlerësimit. EKB-ja⁴⁹ vuri në dispozicion dokumentacionin teknik të pallatit të ndërtuar me ish-kontribut vullnetar nga shoqëria “***” sh.p.k., korrespondencën midis institucioneve përgjegjëse dhe kontratat e shitjes të truallit të lidhura me qytetarët pronarë të apartamenteve të tjera të pallatit me EKB-në Gjirokastër. Enti Kombëtar i Banesave ka bërë me dije se EKB-ja Gjirokastër disponon dokumentacion vetëm për pagesën e vlerës së truallit nga qytetarët dhe jo për pagesën e vlerës së punimeve. Në vijim, ka sqaruar se kontrata midis subjektit Albert Spiro dhe EKB-së Gjirokastër nuk u gjet në arkiv, por ka përcjellë ditarin e bankës për vitet 2003 - 2004, ku figuron kryerja e pagesës së truallit në vlerën 8.309 lekë nga subjekti i rivlerësimit.

2.41. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dërguar nga EKB-ja, Komisioni konstatoi se: lista e personave përfitues përbëhet nga 15 persona, ku nuk përfshihet emri i subjektit Albert Spiro; në 15 kontratat e lidhura për privatizimin e banesës, të nënshkruara nga viti 1999 e në vijim, vërehet se 13 prej blerësve janë në listën fillestare dhe 2 prej tyre janë emra të rinj; në listën fillestare ndodhet emri i vjehrrit të subjektit, shtetasi S.A., për të cilin EKB-ja ka përcjellë kontratën për privatizimin e banesës (pa datë), ku evidentohet vlera e truallit 8.309 lekë; dhe planimetria e apartamentit të subjektit duket e njëjtë me atë të caktuar për vjehrrin e subjektit, konkretisht dy apartamentet që ndodhen në seksionin 1, kati IV.

⁴⁶ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 12.5.2021, e shtetasit A.H.

⁴⁷ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 12.5.2021, e shtetasit S.N.

⁴⁸ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 13.5.2021, e shtetasit S.Th.

⁴⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 7.6.2021.

2.42. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: (i) subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar se ky apartament është blerë para detyrës, pasi mbetet i paqartë viti i blerjes në Gjirokastrë, për shkak se: kontrata e EKB-së për këtë apartament është lidhur fillimisht me të ndjerin, vjehrrin e subjektit, dhe më tej është lidhur në vitin 2003 midis EKB-së dhe subjektit; dhe nuk ka paraqitur dokumentacion për blerjen e këtij apartamenti nga vjehri. Për rrjedhojë, deri në këtë fazë, mungon dokumentacioni ligjor justifikues për burimin e ligjshëm të shumës 26.000 USD për blerjen e apartamentit dhe të shumës 1.000.000 lekë për arredimin.

2.43. Në përgjigje të rezultateve të hetimit⁵⁰, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se ndërtimi ka përfunduar në vitin 1997 dhe ka filluar të banojnë në këtë apartament në fillim të vitit 1998, para fillimit të punës si ndihmësgjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Konstatimi i Komisionit se kontrata e EKB-së për këtë apartament është lidhur fillimisht me të ndjerin, vjehrrin e tij, nuk është i saktë, pasi marrëveshja fillestare është bërë në vitin 1996, kohë në të cilën ishte emigrant në shtetin grek dhe marrëveshjen për apartamentin e ka nënshkruar gjatë ditëve të kthimit. Për marrjen e një kopjeje të saj është interesuar tek noterja, të cilës i ka kaluar arkiva e noteres E.P. para së cilës kishte nënshkruar marrëveshjen, pasi kjo e fundit kishte ndërruar jetë, por notere G.R. K., me shkresën nr. *** prot., datë 13.4.2015, i ka kthyer përgjigje se nuk e disponon këtë marrëveshje. Gjithashtu, ka shpjeguar se në kontratën e blerjes me nr. ***, datë 23.5.2003, nga EKB-ja, përcaktohet se pallati ***-katësh është ndërtuar në vitin 1996 me mjetet financiare të secilit pronar të apartamenteve përkatëse të këtij pallati, duke përcaktuar periudhën e ndërtimit të tij. Lidhur me faktin se një pjesë e dokumentacionit të EKB-së Gjirokastrë ndodhet në emër të vjehrrit të tij S.A., subjekti ka shpjeguar se duke qenë se ishte në emigracion ai ndiqte punimet dhe mbante kontaktet me firmën që kryente punimet dhe për këtë shkak firma që ka hartuar listën përkatëse ka shënuar emri i tij dhe jo të subjektit. Pavarësisht se kontrata tip e përcjellë në Komision nga EKB-ja në vitin 1999 është plotësuar në emrin e vjehrrit të tij, kjo kontratë nuk është e nënshkruar prej tij dhe data është e paplotësuar. Gjithashtu, shpjegon se provohet që firma e ndërtimit dhe EKB-ja njihnin atë si pronar të pronës, pasi nga dokumentet e administruara nga ASHK-ja Gjirokastrë në genplanin e apartamentit dhe planimetrinë e tij është shënuar emri i tij dhe mbajnë shënimin janar 1998. Për të provuar kohën e fillimit të zotërimit të tij, subjekti ka paraqitur CD me pamje filmike të tetorit të vitit 1998, ku kolektivi i punës së bashkëshortes ka ardhur për të uruar për banesën e re ku është e pranishme edhe vajza e tij L.S., e datëlindjes 6.6.1996.

2.44. Lidhur me të ardhurat e përdorura për blerjen e apartamentit dhe arredimin e tij, subjekti ka sqaruar se janë siguruar nga puna në emigracion në Greqi ku kishte siguruar rreth 4.000.000 lekë, që u përdorën për ndërtimin dhe arredimin e apartamentit. Këto të ardhura në vitin 1996 i kishte të depozituara në Bankën e Kursimeve Gjirokastrë dhe në vitin 2015, kur është thirrur nga ILDKPKI-ja, është përpjekur të gjejë prova të tyre, duke iu drejtuar me shkresa institucioneve bankare dhe arkivuese, por sipas përgjigjeve të kthyera dokumentacioni nuk ekziston as te “Raiffeisen Bank” dhe as në arkiv, për shkak se llogaria ishte mbyllur dhe

⁵⁰E-mail i datës 5.7.2021, ora 12:40

dokumentacioni nuk ruhej më në momentin e kërimit. Kërkesat ndaj këtyre institucioneve i ka vendosur në dispozicion me pyetësorët dhe deklaratën *Vetting* 2017. Gjithashtu, ka sqaruar se ka qenë vazhdimisht me viza 1-vjeçare të dhëna nga autoritet greke, por në shtetin grek nuk ka qenë i regjistruar si punëmarrës dhe i siguruar për shkak se kryerja e këtyre procedurave ishte shumë e kushtueshme dhe e vështirë për ata që ishin me viza periodike dhe punë të përkohshme. Gjatë qëndrimit ka kryer punë të ndryshme si në sektorin e ndërtimit, etj, në punëmarrës të ndryshëm dhe për shkak se ka kaluar një kohë shumë e gjatë, 25-30 vjet, nuk kam mbajtur komunikime dhe është në pamundësi që të sigurojë deklaratime prej tyre. Në këto kushte, për këto të ardhura të fituara dhe përdorura para fillimit të detyrës, ka deklaruar se në kuptim të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016 është në pamundësi objektive për paraqitjen e akteve provuese, pasi ka ezauruar të gjitha rrugët për marrjen e tyre.

2.45. Bashkëlidhur me shpjegimet subjekti paraqiti dokumentet: (i) kontratë shitjeje nr. ***, datë 23.5.2003, midis palës shitëse, EKB Gjirokastër, dhe palë blerëse Albert Spiro, së bashku kontratën e privatizimit të banesës, mandatpagesën, treguesit kryesorë për apartamentin, genplanin e apartamentit dhe planimetrinë e apartamentit; (ii) CD ku provohet se në tetor të vitit 1998 kolektivi i punës së bashkëshortes ka ardhur për të uruar për banesën e re dhe konstatohet jo vetëm nga data, por edhe mosha e fëmijës L.S.; (iii) deklaratë noteriale nr. ***, datë 30.6.2021, e shtetasve A. dhe G.B.; (iv) deklaratë noteriale nr. ***, datë 30.6.2021, e shtetasve E. dhe P.B.; (v) deklaratat noteriale të ish-kryetarit të komunës Z. dhe bashkëfshatarëve dhe të afërmeve të subjektit me të cilët ka qenë në Athinë, Greqi dhe kanë dijeni në lidhje me të ardhurat dhe përdorimin e tyre nga ana e tij, si dhe shkresën kthim përgjigje, datë 13.4.2015.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

2.46. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; dhe (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton si më poshtë vijon:

2.47. Sipas dokumenteve të paraqitura nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017 dhe të administruar nga ASHK-ja Gjirokastër, rezulton se EKB-ja Gjirokastër, në kontratën e shitjes së truallit me nr. ***, datë 23.5.2003, ndërmjet të tjerave, ka deklaruar se: “[...] në cilësinë e shitësit ka në pronësi të tij një pasuri të patundshme truall, të ndodhur në lagjen ‘***’, në qytetin e Gjirokastrës, mbi të cilin është ndërtuar një pallat ish ‘***’, pallat ***-katësh i ndërtuar në vitin 1996 me mjetet financiare të secilit pronar të apartamenteve përkatëse të këtij pallati. Pala blerëse Albert Spiro ka ndërtuar në këtë pallat një apartament të ndodhur në katin e katërt [...]”. Komisioni ka konstatuar se në kontratë EKB-ja deklaroi se i gjithë pallati është ndërtuar në vitin 1996 dhe subjekti i rivlerësimit ka ndërtuar me kontributin e tij apartamentin në katin e ***. Gjithashtu, në dosjen e regjistrimit ndodhet edhe genplani i banesës, i hartuar nga Drejtoria Rajonale e EKB-së Gjirokastër, me emrin e subjektit të rivlerësimit dhe si datë është vendosur janari i vitit 1998 dhe në fund është vulosur nga ky institucion.

2.48. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm burimin e krijimit dhe pasuria apartament banimi në Gjirokastër është krijuar nga subjekti përpara ushtrimit të detyrës. Për këtë arsye, Komisioni vlerëson se krijimi i kësaj pasurie nuk lidhet me procesin e rivlerësimit të subjektit.

2.49. Në vijim, Komisioni analizoi mjaftueshmërinë dhe ligjshmërinë e të ardhurave për pagimin e kësteve të blerjes së apartamentit në Vlorë, si më poshtë vijon:

Kësti i parë në vlerën 3.200.000 lekë (26.000 euro)

2.50. Referuar lëvizjeve të llogarive bankare të bashkëshortes së subjektit M.S., rezultoi se në datën 15.12.2008 kjo e fundit ka paguar në rrugë bankare këstin e parë prej 3.200.000 lekësh (26.000 euro), në përputhje me shumën deklaruar në DIPP-në e vitit 2008, si dhe në përputhje me burimin e deklaruar (shitja e apartamentit në Gjirokastër).

Kësti i dytë në vlerën 2.600.000 lekë

2.51. Referuar deklaramentit në DIPP-në e vitit 2009, shuma e paguar këtë vit ka qenë 2.600.000 lekë, ndërkohë që referuar kësteve të parashikuar në kontratën paraprake në vitin 2009 duhet të ishte paguar shuma totale prej 24.300 euro⁵¹.

2.52. Nga hetimi administrativ u konstatua se bashkëshortja e subjektit M.S., në datën 17.4.2009 ka kaluar me rrugë bankare në favor të shtetasit Sh.L. shumën 1.935.000 lekë. Për sa i përket burimit të krijimit të kësaj shume, Komisioni ka konstatuar se nga shuma prej 3.000.000 lekësh e shtuar në llogarinë e shtetases M.S. pranë BKT-së nga shitja e apartamentit në Gjirokastër gjatë vitit 2009, 1.935.000 lekë është kaluar në favor të shtetasit Sh.L. Në datën 28.12.2009 ka tërhequr vlerën prej 500.000 lekësh dhe pjesën e mbetur (565.000 lekë) e ka kaluar në depozitë bankare.

2.53. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2⁵², subjekti deklaroi se në fund të vitit 2009 ka paguar 665.000 lekë, ku 500.000 lekë janë tërhequr nga llogaria e bashkëshortes pranë BKT-së, llogari e krijuar nga pagesa e shtetasit P.Ll. dhe 165.000 lekë nga kursimet e deriatëhershme vjetore nga pagat.

2.54. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni vlerësoi se nga shuma 2.600.000 lekë e paguar në vitin 2009, vlera prej 2.435.000 lekësh⁵³ ka si burim të ardhurat nga shitja e apartamentit në Gjirokastër. Referuar arsyetimit në relacionin mbi rezultatet e hetimit kryesisht, çmimi i kontratës së shitjes është 4.479.230 lekë. Duke i zbritur kësaj vlere këstin e parë (3.200.000 lekë), shuma e burimeve të ligjshme të mbetura për këstin e dytë është 1.279.230 lekë.

2.55. Komisioni kreu analizën financiare për të ardhurat, shpenzimet, pasuritë dhe detyrimet për vitin 2009, nga ku rezultoi një balancë negative në shumën 1.993.723 lekë, e përbërë nga vlera 1.720.770 lekë si pasojë e mospërputhjeve në çmimin e apartamentit dhe vlera 272.953 lekë për kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën e likuiditeteve.

⁵¹ Kësti i dytë me vlerë 10.000 euro, në datë 30.3.2009; kësti i tretë me vlerë 10.000 euro, në datë 30.6.2009; kësti i katërt me vlerë 4.300 euro deri në datë 30.8.2009

⁵² E-mail-i datë 13.5.2021

⁵³ 1.935.000 lekë të transferuara direkt nga llogaria dhe 500.000 lekë të tërhequra cash

2.56. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: (i) subjekti dhe personat e lidhur kanë mungesë burimesh të ligjshme për vitin 2009 në shumën 272.953 lekë, për kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën e likuiditeteve.

2.57. Në përgjigje të rezultateve të hetimit⁵⁴, subjekti i rivlerësimit sqaroi se duke shpjeguar dhe provuar ligjshmërinë e të ardhurave nga shitja e apartamentit në Gjirokastrë në vlerën totale të tyre, ka arritur të provojë edhe diferencën e burimit për apartamentin në Vlorë, për të cilën Komisioni i ka kaluar barrën e provës. Përkatësisht provon burimin e vlerës së deklaruar prej 1.935.000 lekësh, të paguar në rrugë bankare nga BKT-ja dhe vlerën e deklaruar të tërhequr *cash* prej 500.000 lekësh të paguar në fund të vitit 2009.

2.58. Ndërsa për vlerën 165.000 lekë, për të cilën ka deklaruar se ka burim kursimet e deriatëhershme vjetore të të ardhurave nga pagat e tij dhe të bashkëshortes, paraqiti raportin e audituesit ligjor, ku është pasqyruar analiza financiare e vitit 2009 dhe ku janë paraqitur këto pretendime: (i) zvogëlim i shpenzimeve të jetesës nga 546.480 lekë në 466.752 lekë, pasi sipas tij Komisioni ka përllogaritur shumën e konsumit për qytetin e Tiranës në masën 11.385 lekë/person, ndërkohë që duhet të llogariste 9.724 lekë/person për qytetin e Vlorës (rajoni bregdetar); (ii) pasqyrim i shpenzimeve të arredimit nga 325.000 lekë në 230.000 lekë për vitin 2009 dhe nga 325.000 lekë në 420.000 lekë për vitin 2010; si dhe (iii) konsiderimin e pakësimit të shumës 100.000 lekë të deklaruar në pyetësoin nr. 2.

2.59. Në përfundim, pas reflektimit të të ardhurave nga shitja e apartamentit në Gjirokastrë dhe pretendimeve të sipërpërmendura, subjekti ka deklaruar se balanca pozitive e analizës financiare të vitit 2009 rezulton në shumën 1.775 lekë dhe se me kursimet nga të ardhurat e vitit arrin të shlyejë edhe shumën prej 165.000 lekësh për apartamentin në Vlorë.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

2.60. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklarinimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; dhe (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklarinimet në seancë dëgjimore, arsyeton si më poshtë vijon:

2.61. Lidhur me pretendimin e subjektit për reduktimin e shpenzimeve jetike, Komisioni thekson se për këtë përllogaritje mbështetet në informacionin zyrtar të INSTAT-it drejtuar ILDKPKI-së, të dhëna këto të përdorura për të gjithë subjektet e rivlerësimit. Shkresa nr. *** prot., e INSTAT-it, e cituar në raportin e audituesit ligjor, përcakton konsumin mujor për frymë dhe nuk specifikon qytet apo rajon konkret. Për më tepër, në pretendimet e tij lidhur me analizën e vitit 2014, subjekti kërkon që të merret në konsideratë Anketa e Buxhetit të Familjes sipas qarqeve, konkretisht qarku Vlorë. Nëse do t'i referoheshim kësaj ankete për vitin konkret,

⁵⁴ E-mail i datës 5.7.2021, ora 12:40

pra vitin 2009, shpenzimet jetike do të përlllogariteshin në shumën 756.096 lekë (63.008 lekë x 12 muaj), pra shumë më tepër se vlera e përcjellë nga INSTAT-i dhe e përdorur në analizën financiare. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit për reduktimin e shpenzimeve jetike nuk qëndron dhe shpenzimet jetike mbeten të pandryshuara në analizën financiare.

2.62. Për sa i përket pretendimit të subjektit lidhur me shpërndarjen e re të shpenzimeve të arredimit për apartamentin në Vlorë, të pasqyruar në raportin e audituesit, Komisioni vlerëson se ajo është bërë në funksion të rezultatit të analizës financiare, ndërkohë që në pyetësonin standard subjekti ka deklaruar që nuk i mban mend. Për këtë arsye shpenzimet e arredimit për apartamentin në Vlorë mbeten të pandryshuara në analizën financiare.

2.63. Lidhur me gjendjen e likuiditeteve cash në fund të vitit 2009, Komisioni vlerëson se pika 5 e nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, parashikon se: “[...] 5. Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit”. Komisioni, bazuar në këtë dispozitë ligjore, vlerëson se kursimet në formën e likuiditetit *cash* jashtë sistemit bankar, shtesat dhe pakësimet e tyre, duhet të merren parasysh duke u bazuar në deklaratimet e subjektit dhe personave të lidhur në deklaratat periodike vjetore. Sqarimet e dhëna nga subjekti në pyetëson kanë si qëllim qartësimin e deklaratimit në DIPP-në përkatëse, në rastin konkret, në atë të vitit 2009, ku ka deklaruar: “Shtesë kursime nga paga depozitë dhe cash 300.000 lekë. 100.000 lekë depozitë në ‘Alfa Bank’”, dhe më tej në pyetëson ka shpjeguar “Pra, totali i shtesës së kursimeve është 300.000 lekë; gjendja e mbartur nga viti 2008, 1.000.000, e cila është pakësuar 100.000 përdorur për arëdimin e banesës në Vlorë, së bashku me të ardhura të tjera të këtij viti + 200.000 kursimet vjetore”. Në vijim të këtij shpjegimi dhe konstatimit të depozitimit të shumës 100.000 lekë në datën 28.7.2009 në llogarinë e “Alpha Bank” (depozitim i cili reflektohet në rritjen e balancës së kësaj llogarie në fund të vitit), Komisioni pasqyroi si shtesë likuiditete *cash* vlerën prej 200.000 lekësh në relacionin mbi rezultatet e hetimit kryesisht, ndërsa pakësimi prej 100.000 lekësh nuk mund të konsiderohet, për sa kohë nuk është deklaruar në deklaratën periodike vjetore.

2.64. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të mjaftueshme në vlerën 272.953 lekë, duke u gjendur në kushtet e germës “b”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Kësti i tretë në vlerën 700.000 lekë

2.65. Lidhur me pagesën e vlerës së mbetur prej 700.000 lekësh, Komisioni vëren se në DIPP-në e vitit 2011 subjekti ka deklaruar: “Shtuar dy apartamente banimi 1+1 (një banesë) + garazh, blerë me kontratën përfundimtare të shitjes datë 7.1.2011, me nr. ***, çmimi i blerjes deklaruar më parë, vlera 6.500.000 lekë = 51.000 euro (deklaruar më parë)”, por nuk ka deklaruar pagesa të kryera për këtë apartament apo pakësim të likuiditeteve *cash*.

2.66. Në DIPP-të e viteve 2008, 2009 dhe 2010, subjekti nuk ka deklaruar detyrimin e mbetur financiar ndaj shoqërisë “****” sh.p.k., në kundërshtim me germën “d”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, që parashikon se subjekti duhet të deklarojë detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj.

2.67. Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 16.4.2015, në përgjigje të konstatimit të këtij institucioni lidhur me mosmbulimin e të ardhurave *neto* dhe pasurive *neto* për vitin

2011, subjekti ka deklaruar se këtë vit ka pakësuar gjendjen *cash* nga kursimet ndër vite dhe mosdeklarimi i këtij fakti në këtë vit ka qenë një pakujdesi. Gjendja *cash*, ka vijuar subjekti, është pakësuar 700.000 lekë si diferencë e mbetur në blerjen e apartamentit.

2.68. Për të saktësuar datën e kryerjes së pagesës prej 1.365.000 lekësh (shuma që nuk evidentohet në llogaritë bankare), Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 14.4.2021, i është drejtuar shoqërisë “***” sh.p.k., në adresën e deklaruar në QKB, për t’i vënë në dispozicion kontratat e lidhura me subjektin Albert Spiro dhe për dokumentacionin e lëshuar për shlyerjen e kësteve, por posta bëri me dije se ky subjekt është larguar.

2.69. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2⁵⁵, subjekti ka deklaruar se pagesa prej 700.000 lekësh është paguar në fillim të vitit 2011, në momentin e nënshkrimit të kontratave përfundimtare të shitjes. Të ardhurat për këtë pagesë janë siguruar nga pakësimi i gjendjes *cash*, e cila në fund të vitit 2010 ishte 1.000.000 lekë. Bashkëlidhur subjekti dorëzoi përgjigjen e shtetasit Sh.L.⁵⁶, i cili deklaron se nuk ka ruajtur mandatpagesat për shkak të kalimit të afatit 10-vjeçar dhe nga sa kujton pagesa e kësaj difference është kryer një këst pas pagesës së dytë të kryer me bankë (në fund të vitit 2009-ës ose në fillim të vitit 2010) dhe kësti tjetër në fillim të vitit 2011 para nënshkrimit të kontratave përfundimtare të shitjes. Gjithashtu, subjekti dorëzoi kopje të lëvizjes së llogarisë së shtetases M.S.S., e printuar në datën 24.3.2015⁵⁷.

2.70. Referuar arsytimit për gjendjen e likuiditeteve *cash* në paragrafin 2.63, të vendimit, Komisioni nuk i konsideroi deklaratimet e subjektit në procesverbalin e ILDKPKI-së dhe kreu analizën financiare për periudhën 1.1.2011 – 7.1.2011, duke verifikuar tërheqjet e kryera në bankë për këtë periudhë. Nga analizimi u konstatua që subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë kryer tërheqje nga banka përgjatë kësaj periudhe.

2.71. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: (i) subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme në shumën 700.000 lekë për pagesën e këstit të fundit për apartamentin në Vlorë; (ii) subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, pasi nuk ka deklaruar detyrimin e mbetur financiar ndaj shoqërisë “***” sh.p.k., në DIPP-të e viteve 2008, 2009 dhe 2010, në kundërshtim me germën “d”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, të ndryshuar; dhe (iii) subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në DIPP-në e vitit 2011, pasi nuk ka deklaruar pagesën e këstit të fundit për apartamentin në Vlorë.

2.72. Në përgjigje të rezultateve të hetimit⁵⁸, subjekti i rivlerësimit sqaroi se ka deklaruar detyrimin e kontratës së blerjes, ka deklaruar pagesat e shlyera në çdo vit që i ka kryer dhe se mund të kuptohet shumë lehtë vlera e detyrimit të mbetur ndaj shoqërisë. Mosdeklarimi i detyrimeve ndaj firmës në fund të çdo viti nuk ka pasur si qëllim fshehjen, por është një keqinterpretim i mënyrës së deklaramit. Në vijim, sqaron se nuk është trajnuar ndonjëherë në

⁵⁵ E-mail datë 13.5.2021.

⁵⁶ Shkresë e datës 11.5.2021.

⁵⁷ Lëvizje llogarie pranë BKT-së, e printuar në datën 24.3.2015.

⁵⁸ E-mail i datës 5.7.2021, ora 12:40

lidhje me plotësimin e deklaratave periodike nga ILDKPKI-ja dhe plotësimin e tyre e bënte sipas interpretimit të rubrikave të veçanta.

2.73. Ndërsa, për deklarinin në DIPP-në e vitit 2011, shpjegon se ka deklaruar regjistrimin e apartamenteve me kontratën përfundimtare të shitjes së datës 7.1.2011, që nënkupton se detyrimi i mbetur deri në këtë datë është shlyer dhe nuk ka pasaktësi në deklarinin. Për të provuar datën e shlyerjes së kësteve, subjekti paraqiti në Komisionin deklaratën e shtetasit Sh.L., ku vërteton se kësti i fundit prej 700.000 lekësh është shlyer në fillim të vitit 2011.

2.74. Në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme të shumës 700.000 lekë, subjekti ka sqaruar se burimi i saj është gjendja *cash* që në fund të vitit 2010 ka qenë 1.000.000 lekë, shumë të cilën e ka deklaruar edhe para ILDKPKI-së në vitin 2015. Duke qenë se nuk ka pasur trajnim për plotësimin e deklaratës vjetore, ka pasaktësi që lidhen me keqinterpretimin e rubrikave të saj dhe mosdhënia e rëndësisë sa duhej apo pakujdesi në momentin e plotësimit të tyre. Meqenëse gjendjen *cash* e kishte më të lehtë për menaxhim, vendosi t'i përdorë këto para për shlyerjen e këtij kësti. Në vijim, ka sqaruar se referuar vlerës së deklaruar në deklaratën *Vetting*, si kursime *cash* (300.000 lekë) del se kursimeve në vitin 2011 duhet t'i zbritet vlera e kështit 700.000 lekë dhe prej këtej rezulton saktësisht vlera e deklaruar në deklaratën *Vetting*. Gjithashtu, kërkoi të pranohen si provë deklarinimet në procesverbalet e ILDKPKI-së dhe të përfshihet si burim i ligjshëm vlera 700.000 lekë nga pakësimi i gjendjes *cash* në vitin 2010. Bashkëlidhur shpjegimeve, paraqiti shkresën datë 11.5.2021, të shtetasit Sh.L.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

2.75. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklarinimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; dhe (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklarinimet në seancë dëgjimore, arsyeton si më poshtë vijon:

2.76. Komisioni, sikurse arsyeton në paragrafin 2.63, të vendimit, bazuar në pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, vlerëson se kursimet në formën e likuiditetit *cash* jashtë sistemit bankar, shtesat dhe pakësimet e tyre, duhet të merren parasysh duke u bazuar në deklarinimet e subjektit dhe personave të lidhur, në deklaratat periodike vjetore.

2.77. Komisioni krijon bindjen se deklarinimet e subjektit në procesverbal janë bërë për shkak të konstatimit të balancës negative nga ILDKPKI-ja, përderisa ato nuk janë ndrequr me vullnetin dhe iniciativën e vetë subjektit të rivlerësimit, por janë pretenduar në vitin 2015, pra, rreth 4 vjet më vonë.

2.78. Për pasojë, deklarimi lidhur me pakësimin në shumën 700.000 lekë për vitin 2011, nuk merret në konsideratë në analizën financiare, për sa kohë nuk është deklaruar në DIPP-në e këtij viti.

2.79. Për sa i përket mos deklarinimit të detyrimit financiar të mbetur ndaj shoqërisë “***” sh.p.k., në DIPP-të në vitet 2008, 2009, 2010 dhe mosdeklarinimin e pagesën së kështit të fundit

për apartamentin në Vlorë në vitin 2011, këto mosdeklarime janë vlerësuar nga Komisioni në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin e pasurive.

2.80. Në përfundim, Komision vlerëson se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme në shumën 700.000 lekë për pagesën e këstit të fundit për apartamentin në Vlorë, duke u gjendur në kushtet e germës “b”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

3. Apartament banimi me sip. 95 m², në vlerën 60.000 euro dhe 2 garazhe në vlerën 8.000 euro, në S., Tiranë

3.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar apartament banimi me sip. 95 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, në vlerën 60.000 euro, pjesa takuese 50 % dhe 2 garazhe me nr. pasurie *** dhe ***, z. k. ***, në vlerën 8.000 euro, në S., Tiranë. Si burim krijimi ka deklaruar huamarrje në vlerën 50.000 euro dhe 18.000 euro nga kursimet familjare. Për vërtetimin e deklarimit subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues⁵⁹.

3.2. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se në DIPP-në e vitit 2011 subjekti ka deklaruar kontratë porosie për banesë + garazh, me nr. *** rep., datë 5.6.2011, dhe nr. *** rep., datë 3.12.2011, me shoqërinë “****” sh.p.k., komuna F., paguar vlera 58.000 euro, me pjesë takuese 50 %. Në DIPP-në e vitit 2012 nuk ka deklaruar pagesa të kryera për këtë pasuri dhe as detyrim të mbetur ndaj shoqërisë “****” sh.p.k.. Në DIPP-në e vitit 2013 subjekti ka deklaruar pagim kësti për banesë shoqërisë “****” sh.p.k., në shumën 5.000 euro nga llogaria në “Alpha Bank” + 25.000 lekë kursime, si dhe ka deklaruar gjendjen e detyrimit të pashlyer në vlerën 3.000 euro. Ndërkohë që, sipas deklarimeve të subjektit, vlera e mbetur duhej të ishte 5.000 euro⁶⁰. Në DIPP-në e vitit 2014 subjekti ka deklaruar se ka paguar këstin përfundimtar për banesën në komunën F., në shumën 5.000 euro, të paguar nga shitja e automjetit dhe kursimet familjare dhe se nuk ka detyrime.

3.3. Në kontratën e porosisë së apartamentit parashikohet se palët kanë përcaktuar që shuma e përgjithshme e apartamentit është 60.000 euro dhe lidhur me pagimin e çmimit deklarojnë se: (a) u likuidua nga porositësi 50 % e vlerës totale në datën 5.6.2011; (b) pjesa prej 20 % të vlerës totale do të paguhej në datën 10.10.2011; (c) pjesa prej 20 % e vlerës totale do të paguhej në datën 20.12.2011; dhe (ç) pjesa prej 10 % e vlerës totale do të paguhej me marrjen e çelësave. Ndërsa, në kontratën e porosisë së garazheve⁶¹ rezulton se çmimi i përgjithshëm i garazheve është vendosur 8.000 euro dhe deklarohet se u likuidua nga porositësi 100 % e vlerës totale në datën 3.12.2011.

⁵⁹ Certifikatë pronësie për pasurinë nr. ***, S., në pronësi të z. Albert Spiro; kartelë pasurie; kontratë porosie nr. ***, datë 5.6.2011; kontratë shitjeje nr. ***, datë 15.12.2014.

⁶⁰ Diferenca midis shumës totale 68.000 euro dhe vlerës 58.000 euro të paguar në vitin 2011 dhe vlerës 5.000 euro të paguar në vitin 2013.

⁶¹ Kontratë nr. ***, datë 5.6.2011, paraqitur nga subjekti në dokumentacionin e dorëzuar në ILDKPKI, konfirmuar nga shoqëria “****” sh.p.k. dhe nga arkiva e noteres M.Sh. të dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 10.5.2021, të noterit S.Sh.

3.4. Referuar dokumentacionit të administruar nga ASHK-ja Tiranë⁶² dhe nga shoqëria “****” sh.p.k.⁶³, vërtetohet se:

- Me kontratën noteriale të shitblerjes nr. ***, datë 15.12.2014, subjekti ka blerë apartamentin me sip. 95 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, me vendndodhje S., Tiranë, kundrejt çmimit 60.000 euro. Në këtë kontratë deklarohet se çmimi i shitjes është likuiduar totalisht nga pala blerëse, sipas përcaktimit në kontratën e porosisë të nënshkruar midis tyre me nr. ***, datë 5.6.2011, të noteres M.Sh. dhe palës blerëse i është dorëzuar apartamenti.

- Me kontratën noteriale të shitblerjes nr. ***, datë 15.12.2014, subjekti ka blerë nga shoqëria “****” sh.p.k. 2 garazhe me nr. pasurie *** dhe nr. ***, z. k. ***, me vendndodhje në S., Tiranë, kundrejt çmimit 4.000 euro secili (totali 8.000 euro). Në kontratë shprehet se shumata e blerjes janë likuiduar totalisht nga pala blerëse, sipas përcaktimit në kontratën e porosisë të nënshkruar midis tyre me nr. ***, datë 3.12.2011, të noteres M.Sh.

3.5. Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit të rivlerësimit me shoqërinë “****” sh.p.k., ortakun/administratorin A.D. dhe ortakun M.K., duke i dërguar shkresë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë⁶⁴ dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë⁶⁵ (për shkak se ka trashëguar arkivën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tepelenë). Nga dokumentacioni i dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë⁶⁶ dhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë⁶⁷ rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk kishte gjykuar asnjë proces gjyqësor me këto palë.

3.6. Në vijim, nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit të Komisionit⁶⁸, rezulton se sipas mandatarkëtimit nr. ***, datë 5.6.2011, të lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k. kjo shoqëri ka arkëtuar nga subjekti shumën 50.000 euro, me përshkrimin “arkëtim kësti për apartamentin nr. ***, kuota 9.69”. Me kërkesë të Komisionit, shoqëria “****” sh.p.k. ka përcjellë⁶⁹ të dhëna të marra nga libri i arkës lidhur me pagesat e kryera, konkretisht raportin “ditar klienti”, të nxjerrë nga programi i tyre financiar, ku evidentohen shlyerjet nga subjekti, konkretisht: në datën 5.6.2011, shuma 50.000 euro; në datën 3.12.2011, shuma 8.000 euro, me përshkrimin “lik. total garazhe”; në datën 10.5.2013, shuma 5.000 euro; dhe në datën 13.12.2014, shuma 5.000 euro.

3.7. Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 2⁷⁰, i kërkoi subjektit të paraqesë dokumentacionin ligjor justifikues lidhur me pagesën e shumës 18.000 euro pranë shoqërisë “****” sh.p.k. Në përgjigje⁷¹, subjekti deklaroi se pagesa e shumës 18.000 euro është bërë me mandatarkëtim, nga të cilat: (i) 8.000 euro janë paguar për garazhet në datën 3.12.2011 (në momentin e lidhjes

⁶² Shkresë nr. *** prot., datë 17.1.2020; fotokopje e kartelës së pasurisë apartament, me nr. ***, në pronësi të z. Albert Spiro; fotokopje e kartelës së pasurisë garazh, me nr. ***, në pronësi të z. Albert Spiro; kontratë noteriale shitblerjeje nr. ***, datë 15.12.2014; kontratë noteriale shitblerjeje nr. ***, datë 15.12.2014.

⁶³ Shkresë nr. *** prot., datë 3.5.2021.

⁶⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 14.4.2021; shkresë nr. *** prot., datë 20.4.2021.

⁶⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 20.4.2021; shkresë nr. *** prot., datë 18.5.2021.

⁶⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 19.4.2021; shkresë nr. *** prot., datë 22.4.2021.

⁶⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 24.5.2021.

⁶⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 23.4.2021, nga ILDKPKI-ja.

⁶⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 3.5.2021.

⁷⁰ E-mail i datës 7.5.2021.

⁷¹ E-mail i datës 13.5.2021, ora 19:33.

së kontratës së porosisë), me burim 5.000 euro siguruar nga kthimi i huas prej shtetasit S.A./vjehtëri i subjektit dhe 3.000 euro nga pakësimi i gjendjes *cash* prej 5.000 euro në fund të vitit 2010; (ii) 5.000 euro janë paguar në vitin 2013, të siguruar nga mbyllja e depozitës pranë “Alpha Bank” në shumën 674.684 lekë dhe diferenca rreth 25.000 lekë është plotësuar nga të ardhurat familjare deri në atë moment të atij viti; si dhe (iii) 5.000 euro janë paguar në momentin e nënshkrimit të kontratës përfundimtare të shitjes (dhjetor 2014) dhe 300.000 lekë janë siguruar nga shitja e automjetit të blerë në vitin 2006 dhe diferenca rreth 400.000 lekë nga kursimet vjetore.

3.8. Gjithashtu, subjekti deklaroi se nuk i disponon faturat, pasi në momentin e nënshkrimit të kontratave përfundimtare është pasqyruar se detyrimet ishin shlyer tërësisht. Subjekti paraqiti nga shoqëria “****” sh.p.k. të dhënat kompjuterike nga ditari i klientit, ku janë pasqyruar datat dhe këstet e paguara, sipas përshkrimit në paragrafin 3.6 të vendimit, kontratën e shitjes së mjetit nr. ***, datë 29.7.2014, dhe kopje të depozitës bankare të “Alpha Bank” të shtetasës M.S. në momentin e mbylljes së depozitës në datën 18.2.2013.

3.9. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit në lidhje me konstatimin se *subjekti ka kryer deklarim të pasaktë, pasi nuk ka deklaruar detyrimin e mbetur financiar ndaj shoqërisë “****” sh.p.k. në DIPP-në e vitit 2012, në kundërshtim me germën “d”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.*

3.10. Në përgjigje të rezultateve të hetimit⁷², subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se nuk ka pasur asnjë trajnim për mënyrën e plotësimit të deklaratave periodike, prandaj ka edhe pasaktësi në deklaratat e viteve të ndryshme. Mosdeklarimi i detyrimeve ndaj shoqërisë në fund të çdo viti është një pasaktësi që nuk ka pasur si qëllim fshehjen. Duke deklaruar detyrimin fillestar dhe sa është pagesa e bërë, detyrimi është thjesht diferenca e tyre. Në deklarimin periodik vjetor të vitit 2012 ka pasur një harresë për të deklaruar pagesën e kryer ndaj kësaj shoqërie në këtë vit, e cila është plotësuar në deklarimin e vitit 2013.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

3.11. Komisioni vlerëson se pasaktësia e deklarimit të detyrimeve në DIPP-në e vitit 2012 janë vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin e pasurive.

Burimi 1 – huamarrja në vlerën 50.000 euro

3.12. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti ka deklaruar huamarrje në vlerën 50.000 euro për blerje apartamenti në Tiranë. Për shkak të marrëdhënieve të posaçme (nuni i vajzës) fillimisht akti i marrjes është një kontratë jo noteriale e datës 20.5.2011. Me deklaratën noteriale nr. ***, datë 21.3.2015, është pranuar shlyerja në shumën 15.000 euro dhe është lidhur kontrata e huas nr. ***, datë 21.3.2015, për shumën 35.000 euro, me afat 21.3.2015 - 21.3.2026. Bashkëlidhur ka dorëzuar edhe dokumentacionin përkatës⁷³.

⁷² E-mail i datës 5.7.2021, ora 12:40

⁷³ Kontratë huaje nr. ***, datë 21.3.2015; deklaratë noteriale nr. ***, datë 21.3.2015; kontratë huaje (jo noteriale) e datës 20.5.2011, bashkë me shënimet (nga mbrapa) për shlyerjen e kësteve; certifikatë pagëzimi lëshuar nga Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, seria nr. ***, datë 29.5.2010; kontratë qiraje, datë 5.9.2006, me palë qiradhënëse shtetasit A.H.,

3.13. Në DIPP-në e vitit 2011 subjekti ka deklaruar në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” hua të marrë në vitin 2011, për blerje banese me afat 15 vjet dhe në seksionin “Të dhëna konfidenciale”, ka deklaruar: “Marrë hua nga A.H. për blerje banese 50.000 euro”, nuk ka deklaruar numër dhe datë të marrëveshjes, por ka deklaruar *marrëveshje shkresore për shkak të marrëdhënieve të posaçme*.

3.14. Lidhur me shlyerjen e huas, subjekti ka deklaruar: “Në DIPP-në e vitit 2012 ka deklaruar shlyerje të huamarrjes në vlerën 4.000 euro, nga kursimet familjare të vitit 2012; në DIPP-në e vitit 2013 ka deklaruar shlyerje në vlerën 3.500 euro nga kursimet familjare të vitit 2013; në DIPP-në e vitit 2014 ka deklaruar shlyerje 3.500 euro, paguar nga kursimet familjare; në DIPP-në e vitit 2015 ka deklaruar shlyerje në vlerën 4.000 euro, paguar nga kursimet familjare e të ardhurave nga pagat; në DIPP-në e vitit 2016 ka deklaruar shlyerje në vlerën 3.000 euro nga kursimet familjare e të ardhurave nga pagat”.

3.15. Në pyetësorin standard⁷⁴, subjekti ka deklaruar se ka marrë hua nga shtetasi A.H., me banim në Gjirokastrë, shumën 50.000 euro për blerje apartamenti në Tiranë dhe për shkak të marrëdhënieve të posaçme (nuni i vajzës, pasi bashkëshortja E.H. ka pagëzuar vajzën e subjektit K.S. në vitin 2010), fillimisht akti i marrjes është kontratë jo noteriale e datës 20.5.2011. Me deklaratën noteriale nr. ***, datë 21.3.2015, është pranuar shlyerja prej 15.000 euro dhe është lidhur kontrata e huas nr. ***, datë 21.3.2015, për shumën 35.000 euro, me afat 21.3.2015 – 21.3.2026. Për vitet 2016 - 2019 është shlyer shuma 13.000 euro dhe aktualisht kanë mbetur pa u shlyer 22.000 euro. Bashkëlidhur deklaratimit subjekti ka dorëzuar kopje të: (i) certifikatës së pagëzimit; (ii) kontratës së huas, datë 20.5.2011; (iii) kontratës së huas nr. ***, datë 21.3.2015; (iv) shkresës me nënshkrimet e shtetasit A.H., që vërteton shlyerjet në vitet 2016 - 2019; (v) deklaratës noteriale nr. ***, datë 21.3.2015; (vi) ekstraktit të QKB-së për regjistrimin e biznesit të shtetasit A.H.; (vii) ekstraktit të QKB-së për regjistrimin e biznesit të shtetasit E.H.; (viii) kontratës së qirasë nr. ***, datë 5.9.2006, të lidhur ndërmjet shtetasit A.H. etj. dhe “Raiffeisen Bank”, ku rezulton se 3 qiradhënësit përfitojnë 4.000 euro/muaj për dhënien e objektit me qira, kontratë e cila vazhdon aktualisht; si dhe (ix) deklaratës së të ardhurave individuale për vitin 2011 e shtetasit A.H., ku janë deklaruar gjithsej 4.529.604 lekë, nga të cilat 3.423.444 lekë të ardhura nga qiratë.

3.16. Komisioni, bazuar në dokumentet e paraqitura nga subjekti me deklaratën *Vetting* 2017, pyetësorin standard dhe në dokumentacionin e administruar⁷⁵ gjatë hetimit administrativ, konstaton se sipas kontratës së huas (jo noteriale) të datës 20.5.2011, të lidhur ndërmjet huadhënësit A.H. dhe huamarrësve M. dhe Albert Spiro, huadhënësi i ka dhënë hua huamarrësve shumën 50.000 euro, me afat shlyerje 15 vjet, pa interes, me qëllim përdorimi blerjen e një banese në qytetin e Tiranës. Në këtë kontratë përcaktohet se këstet e shlyerjes do të jenë për 10 vitet e para në shumën 3.000 euro/vit, që do të shlyhen brenda muajit maj dhe për 5 vitet e tjera në shumën 4.000 euro/vit. Gjithashtu, përcaktohet se në rast të kërkesës së huadhënësit, huamarrësit brenda 3 (tre) muajve do t’i kthejnë shumën 30.000 euro, kurse shuma

A.K. e V.Ll. dhe palë qiramarrëse “Raiffeisen Bank”; ekstrakt historik nga QKR-ja, i printuar në datën 24.3.2015, i personit fizik “A.H.”; ekstrakt historik nga QKR-ja, i printuar në datën 24.3.2015, i personit fizik “E.H.”.

⁷⁴ E-mail i datës 18.12.2019.

⁷⁵ Dokumente të përcjella nga noteri B.Xh., protokolluar në Komision me nr. ***, datë 23.4.2021: kontratë huaje nr. ***, datë 21.3.2015; deklaratë noteriale nr. ***, datë 21.3.2015.

tjetër do të likuidohet sipas kushteve të mësipërme nga 4.000 euro. Në faqen e pasme të kontratës janë vënë shënimet me shkrim dore të firmosura nga shtetasi A.H., si vijon: “Mora 4.000 euro për vitin 2012. Mora 3,500 euro për vitin 2013. Mora 3.500 euro për vitin 2014. Mora 4.000 euro për vitin 2015. Mora 3.000 euro për vitin 2016”.

3.17. Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit të rivlerësimit me shtetasit A. dhe E.H., duke i dërguar shkresë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë⁷⁶ dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër⁷⁷ (për shkak se ka trashëguar arkivën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tepelenë). Nga dokumentacioni i dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë⁷⁸ dhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër⁷⁹ rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk kishte gjykuar asnjë proces gjyqësor me këto palë.

3.18. Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti në pyetësorin standard⁸⁰ rezulton se në “certifikatën e pagëzimit”, të Kishës Autoqefale të Shqipërisë, me nr. serie ***, nr. regj. ***, të datës 29.5.2010, shtetasja E.H. është shënuar si nuni i K.S.

3.19. Referuar në pikën 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, shtetasit A. dhe E.H. konsiderohen “persona të tjerë të lidhur” me subjektin e rivlerësimit, për shkak të marrëdhënies së huas që ekziston ndërmjet tyre dhe të pranuar nga të dyja palët. Komisioni, bazuar në pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, hetoi lidhur me mjaftueshmërinë dhe ligjshmërinë e burimit të shumës 50.000 euro, objekt të kontratës së huas.

3.20. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se, sipas dokumentacionit të administruar nga QKB-ja⁸¹, shtetasi A.H., me vendimin e datës 23.1.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, është regjistruar si person fizik me fushë veprimtarie “furrë buke” dhe më pas është çregjistruar në datën 1.3.2016. Gjithashtu, rezulton se shtetasja E.H. është regjistruar si person fizik në datën 15.2.2005 me fushë veprimtarie “furrë buke dhe prodhime brumërash” dhe se është çregjistruar në datën 3.3.2016. Në vijim, konstatohet se shtetasi A.H. është ortak në shoqërinë “****” sh.p.k., që është regjistruar në datën 29.4.2008, me kuotë 50 % dhe vazhdon të jetë aktive. Në datën 20.10.2015 është bërë regjistrimi i shoqërisë “****” sh.p.k., me fushë veprimtarie “furrë buke dhe prodhime brumërash”, e cila vazhdon të jetë aktive, ku ortak i vetëm i saj është shtetasi A.H.

⁷⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 14.4.2021; shkresë nr. *** prot., datë 20.4.2021.

⁷⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 20.4.2021; shkresë nr. *** prot., datë 18.5.2021.

⁷⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 19.4.2021; shkresë nr. *** prot., datë 22.4.2021.

⁷⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 24.5.2021.

⁸⁰ E-mail i datës 18.12.2019.

⁸¹ Shkresë nr. *** prot., datë 7.1.2021, e QKB-së; vendim nr. ***, datë 4.2.2005, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër; kërkesë e datës 3.2.2005, e shtetasit E.H.; ekstrakt historik i shoqërisë “****” sh.p.k., datë 17.12.2019; ekstrakt historik, datë 17.12.2019, i shoqërisë “****”, sh.p.k.; ekstrakt historik, datë 27.12.2019, i subjektit “****”; ekstrakt historik datë 27.12.2019, i subjektit “E.H.”; leje mjedisi e tipit C, datë 28.7.2016, në favor të shoqërisë “****” sh.p.k.; leje mjedisi e tipit C, datë 13.6.2016, në favor të subjektit “****”; licencë, datë 5.8.2019, në favor të subjektit “****”; licencë, datë 29.7.2019, në favor të subjektit “****”.

3.21. Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë⁸² dhe Bashkia Gjirokastrë⁸³ kanë përcjellë informacion lidhur me personin fizik “E.H.” dhe personin fizik “A.H.”, konkretisht:

3.21.1. Të dhëna për fitimin e shtetases E.H. për periudhën 2005 – 2011 (përveç vitit 2007, për të cilin nuk është përcjellë informacion), në total fitimi i realizuar 4.281.600 lekë⁸⁴.

3.21.2. Të dhëna për fitimin e shtetasit A.H. vetëm për vitet 2005, 2006, 2008, 2010 dhe 2011, në total 3.561.000 lekë⁸⁵. Ndërkohë që, për vitet 2003 dhe 2004 është përcjellë informacion vetëm për qarkullimin, në shumën totale 6.700.000 lekë. Për vitet 2007 dhe 2009 janë administruar nga Bashkia Gjirokastrë deklaratat parashikuese të qarkullimit vjetor dhe taksat vendore të paguara, konkretisht: për vitin 2007 qarkullim i parashikuar 4.500.000 lekë dhe detyrimet e taksave vendore të paguara 92.000 lekë; për vitin 2009 qarkullim i parashikuar 5.500.000 lekë dhe detyrimet e taksave vendore të paguara 114.500 lekë.

3.22. Në kushtet e mungesës së informacionit, Komisioni kreu përllogaritjet, si në vijim:

3.22.1. Për “E.H.” (person fizik) për vitin 2007 u përllogarit një fitim në shumën 1.133.000 lekë, si mesatare të fitimit të vitit paraardhës (2006) dhe atij pasardhës (2008).

3.22.2. Për “A.H.” (person fizik) për vitet 2003 dhe 2004 u përllogarit fitim, përkatësisht 635.677 lekë dhe 941.744 lekë, bazuar në një marzh prej 27,54 %, si mesatare e marzhit *bruto* për vitet 2005⁸⁶ dhe 2006⁸⁷. Për vitin 2007 u përllogarit një fitim në shumën 1.033.750 lekë, si mesatare të fitimit të vitit paraardhës (2006) dhe atij pasardhës (2008). Sa i përket vitit 2009, duke qenë për këtë kategori qarkullimi (5.500.000) ka qenë në fuqi detyrimi për deklaram dhe pagesës të tatimit mbi të ardhurat personale⁸⁸, u përllogarit një fitim në shumën 900.000 lekë⁸⁹.

⁸² Shkresat nr. *** prot., datë 21.1.2019, dhe nr. *** prot., datë 21.7.2017, të DRT-së Gjirokastrë (dosje e ILDKPKI-së) dhe shkresë nr. *** prot., datë 20.5.2021.

⁸³ Shkresë nr. *** prot., datë 17.5.2021, e Bashkisë Gjirokastrë.

⁸⁴ Për vitin 2011 është llogaritur në mënyrë përpjesëtimore për 5 muaj.

⁸⁵ Për vitin 2011 është llogaritur në mënyrë përpjesëtimore për 5 muaj.

⁸⁶ Fitimi *bruto* 421.000 lekë/qarkullimi total 2.498.000 lekë.

⁸⁷ Fitimi *bruto* 1.433.000 lekë/qarkullimi total 3.748.000 lekë.

⁸⁸ Referuar nenit 12 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Tatimi mbi të ardhurat”, ndryshuar me ligjin nr. 9844, datë 17.12.2007 (ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.1.2008), shfuqizuar me ligjin nr. 177, datë 28.12.2013 (ky ligj hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.1.2014), ku citohet se: “Personat fizikë dhe juridikë, subjekte të taksës vendore mbi biznesin e vogël, sipas kuptimit të nenit 10 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, ‘Për sistemin e taksave vendore’, të cilët realizojnë një qarkullim vjetor jo më shumë se 8.000.000 lekë dhe jo më pak se 2.000.000 lekë, janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale”. Referuar pikës 1 të këtij neni: “Shkalla tatimore e aplikueshme mbi të ardhurat e tatueshme të bizneseve të vogla, subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale, është 10 për qind”. Referuar pikës 5 të këtij neni: “Kreditimi i tatimit Taksa vendore mbi biznesin e vogël, e paguar gjatë vitit pranë organeve të qeverisjes vendore, është e kreditueshme (e zbritshme) përkundrejt tatimit për t’u paguar, të llogaritur si shumëzim i të ardhurës së tatueshme, në deklaratën tatimore vjetore, me shkallën tatimore”. Gjithashtu, referuar pikës 6 të këtij neni: (1) çdo tatimpagues, subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale, sipas përcaktimit të dhënë në germën “gj”, të nenit 8, të këtij ligji, është i detyruar që deri më 31 mars të vitit që pason periudhën tatimore, të dorëzojë një deklaratë vjetore tatimore, ku të jepen hollësisht të ardhurat, gjithsej, shpenzimet e zbritshme, e ardhura e tatueshme, tatimi për t’u paguar, taksa vendore, e paguar gjatë periudhës tatimore pranë organeve të qeverisjes vendore, çdo shumë për t’u paguar apo për t’u rimbursuar, si dhe çdo hollësi tjetër e kërkuar nga ministri i Financave në udhëzimin për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës tatimore vjetore; (2) tatimi, i llogaritur në bazë të deklaratës vjetore tatimore, pakësuar me kreditimin e tatimit, përcaktuar në nenin 12/5 të këtij ligji, paguhet nga tatimpaguesi në llogarinë e organeve tatimore, në çastin e paraqitjes së deklaratës vjetore tatimore.

⁸⁹ TVB e paguar 90.000 lekë (bazuar në dokumentin “akt pagese dhe detyrimi”) pjesëtuar me 10 % (sipas legjisllacionit në fuqi të përkrahur më lart).

3.23. Në përmbledhje, të dhënat mbi aktivitetin tregtar të personave të tjerë të lidhur/E. dhe A.H. rezultoi një fitim *neto* në shumën 5.414.600 lekë nga aktiviteti tregtar i E.H. si person fizik dhe 7.072.171 lekë nga aktiviteti tregtar i A.H. si person fizik.

3.24. Gjithashtu, Komisioni analizoi llogaritë bankare të personave të tjerë të lidhur/A. dhe E.H., nga ku u konstatua se këta shtetas kanë pasur ndër vite lëvizje të konsiderueshme fondesh në sistemin bankar, duke filluar nga viti 2000. Nga ana tjetër, janë evidentuar edhe transfertat në favor të të tretëve për blerje pasurish të paluajtshme, konkretisht në datat 13.12.2007 dhe 11.1.2008 është transferuar në total shuma 150.000 euro, me përshkrimin “A.H. për blerje objekti, ish-agjencia, lagjja ‘***’, ‘Raiffeisen Bank’, Gjirokastër nga A.H., Gjirokastër” dhe në datën 19.3.2010 është transferuar shuma 50.000 euro, me përshkrimin “kalim fondi për blerje apartamenti nga A.B.H. në favor të S.Dh.M.”.

3.25. Ndër të tjera, në lëvizjet e llogarive bankare, u konstatuan depozitime/transferta të shpeshta nga shtetasi V.Ll., një nga palët qiradhënëse në kontratën e qirasë me “Raiffeisen Bank” (një nga burimet e të ardhurave cituar nga subjekti), depozitime të cilat përkojnë me pjesën takuese *neto* të personit të lidhur/A.H. (1.200 euro/muaj). Për periudhën 1.1.2007 – 20.5.2011 është depozituar në total shuma 54.774 euro.

3.26. Lidhur me faktin nëse personat e tjerë të lidhur kanë pasur burime të mjaftueshme të krijimit të shumës 50.000 euro, Komisioni, duke konsideruar datën e dhënies së huas dhe faktin se në arkën e biznesit nuk duket se mbahen vlera të larta likuiditetesh *cash*⁹⁰, analizoi llogaritë bankare për periudhën 1.1.2011 – 20.5.2011 (që nga fillimi i vitit deri në datën e dhënies së huas). Konkretisht, u verifikuan tërheqjet dhe depozitimet e kryera, nga ku rezultoi se për periudhën e sipërcituar është tërhequr shuma 5.900 euro dhe janë depozituar shumat 10.700 euro dhe 2.400.000 lekë.

3.27. Në përmbledhje të analizës së mësipërme, vërehet se: (i) fitimi nga aktiviteti tregtar për periudhën nga fillimi i aktivitetit deri në maj të vitit 2011 duket se ka qenë në shumën 12.486.771 lekë; (ii) të ardhurat nga qiradhënia për periudhën 1.1.2007 – 20.5.2011 kanë qenë në shumën 7.170.917 lekë (54.774 euro); (iii) gjendja e llogarive bankare në datën 20.5.2011, në shumën 10.120.379 lekë; (iv) shpenzime jetike për periudhën 2003 – maj 2011, në shumën 4.190.796 lekë⁹¹; dhe (v) transfertat bankare për të tretë për blerje pasurish të paluajtshme në shumën 25.375.834 lekë (200.000 euro).

3.28. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: (i) duket se personat e tjerë të lidhur/huadhënësit nuk kanë pasur burime të mjaftueshme për dhënien e huas në shumën 50.000 euro në datën 20.5.2011, pasi nga hetimi rezultoi se ata nuk kanë tërhequr nga llogaritë bankare shumën prej 50.000 euro gjatë periudhës 1.1.2011 – 20.5.2011; (ii) në arkën e biznesit nuk duket se mbajnë vlera të larta të

⁹⁰ Referuar gjendjes së likuiditeteve në arkë sipas Pasqyrave Financiare për mikronjësitë të përcjella nga DRT-ja Gjirokastër, me shkresë nr. ***, datë 20.5.2021, ku konstatohet se në datën 31.12.2010 ka qenë përkatësisht 72.746 lekë për personin fizik “E.H.” dhe 88.614 lekë për personin fizik “A.H.”.

⁹¹ Përlllogaritur për një familje me 4 persona për periudhën 2003 – maj 2011.

likuiditeteve cash; si dhe kanë investuar shumën 200.000 euro në pasuri të paluajtshme në vitet 2008 - 2011.

3.29. Në përgjigje të rezultateve të hetimit⁹², subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se *personat e lidhur nuk i kanë krijuar të ardhurat vetëm nga aktiviteti ekonomik, por kanë pasur edhe të ardhura si individë, të krijuara nga emigracioni. Në vitet 1991 - 2000 kanë qenë familjarisht në Greqi, së bashku me prindërit, dhe kanë siguruar të ardhura të konsiderueshme. Në vitin 2000 janë kthyer dhe kanë hapur dy aktivitete në qytetin e Gjirokastrës, ku janë njohur familjarisht dhe në momentin që shprehën dëshirën për të pagëzuar vajzën e tij në vitin 2009 - 2010. Në vitin 2011, kur interesohet për blerjen e një banese në Tiranë, për shkak se po afrohej koha që fëmijët të shkonin në universitet, ata shprehën gatishmërinë t'i ndihmonin në shumën 50.000 euro. Në vijim, shpjegoi se nuk e vlerësoi nga ana ligjore dhe etike të interesohet në lidhje me burimin e këtyre të ardhurave, duke qenë i bindur se të ardhurat janë të siguruara nëpërmjet punës së ndershme. Për shkak lidhjes së afërt të krijuar, marrëveshja u bë me shkresë të thjeshtë. Në vitin 2015, kur është thirrur nga ILDKPKI-ja, u interesua për burimin e krijimit dhe i kanë vënë në dispozicion kontratën me "Raiffeisen Bank", deklaratën e të ardhurave, etj., që ishin në vlerë më të madhe se huaja e dhënë. Këto dokumente ia ka vënë në dispozicion Komisionit gjatë procesit nëpërmjet pyetësorëve. Fakti se ata kanë kryer edhe investime të tjera nuk mund konsiderohet si mungesë e burimeve të ligjshme për huan. Këto investime nuk janë bërë në një moment, por janë të shpërndara në vite, gjë që nuk do të thotë se në një moment të caktuar në vitin 2011 ata kanë pasur likuiditete të mjaftueshme të lira dhe e kanë ndihmuar në blerjen e apartamentit.*

3.30. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se nëse do të merret në analizë vetëm gjendja e llogarive bankare në datën 20.5.2011, që i ka rezultuar Komisionit në shumën 10.120.379 lekë, rezulton se ata kanë pasur mundësi t'i japin hua vlerën 50.000 euro ose 6.915.000 lekë, me të ardhura të ligjshme. Gjithashtu, Komisionit ka konstatuar se fitimi nga aktiviteti tregtar për periudhën nga fillimi i aktivitetit deri në maj të vitit 2011 ka qenë në shumën 12.486.771 lekë dhe të ardhura nga qiradhënia për periudhën 1.1.2007 – 20.5.2011 kanë qenë në shumën 7.170.917 lekë (ekuivalenti 54.774 euro). Nga analiza financiare e kryer nga subjekti, rezulton se personi i lidhur ka të ardhura më të mëdha se ato që i kanë rezultuar Komisionit. Fitimi nga aktiviteti tregtar për periudhën nga fillimi i aktivitetit deri në maj të 2011, vijon subjekti, duket se ka qenë në shumën 20.884.461 lekë dhe të ardhurat nga qiradhënia për periudhën shtator 2006 – 20.5.2011 kanë qenë në shumën 8.746.658 lekë (ekuivalenti 67.200 euro).

3.31. Subjekti ka paraqitur raportin e audituesit ligjor A.M., ku është argumentuar se ndryshimet ligjore ndër vite të masës fiskale ndikojnë në normën mesatare të fitimit. Për të përlllogaritur fitimin e mundshëm për subjektin tregtar "A.H.", person fizik, në raport shpjegohet se duhet të merret në konsideratë norma e fitimit të viteve 2010 dhe 2011, për të cilën janë paraqitur pasqyra financiare. Fitimit *neto* i është shtuar edhe vlera e pagës *neto*, me arsyetimin se kjo vlerë është pasqyruar në shpenzimet ushtrimore të biznesit. Nga këto përlllogaritje ka rezultuar një normë fitimi 43,34 %, i cili është aplikuar në të gjitha periudhat

⁹² E-mail i datës 5.7.2021, ora 12:40

paraardhëse. Kjo normë fitimi është përdorur edhe për të përlllogaritur fitimin e mundshëm për subjektin tregtar “E.H.”, person fizik.

3.32. Bazuar në këto përlllogaritje, ka rezultuar një fitim total në shumën 12.886.794 lekë për “A.H.”, person fizik, dhe 7.957.667 lekë për “E.H.”, person fizik. Më tej, në raport janë përfshirë edhe të ardhura nga emigracioni, 4 persona, në shumën 18.136.500 lekë (ekuivalenti 150.000 euro) dhe të ardhurat nga qiraja në shumën 8.745.658 lekë (ekuivalenti 67.200 euro).

3.33. Si përfundim, duke i zbritur këtyre të ardhurave shumat e paguara për pasuri të paluajtshme, shpenzimet jetike dhe huan e dhënë, në raport ka rezultuar një balancë pozitive në vlerën 1.424.027 lekë.

3.34. Më tej, subjekti kërkoi që Komisioni të pranojë shpjegimet e dhëna prej tij për huan e marrë nga shtetasi A.H. dhe ta përfshijë në analizën financiare. Në rast të kundërt, pra në rast se huaja nuk do të konsiderohet, përfundoi subjekti, duhet të hiqet edhe kthimi i saj nga analiza financiare.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

3.35. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton si më poshtë vijon:

3.36. Subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka dhënë shpjegime vetëm për ligjshmërinë e të ardhurave të personave të tjerë të lidhur dhe nuk argumentoi apo provoi mjaftueshmërinë e likuiditeteve të personave të tjerë të lidhur në momentin e dhënies së huas.

3.37. Ekzistenca e likuiditeteve në sistemin bankar në datën 20.5.2011, krahas faktit që është e pamjaftueshme për të konkluduar se huaja e dhënë ka doemos një burim të ligjshëm, nuk mund të shkojë në favor të arsyetimit të subjektit, përkundrazi, tregon se personat e tjerë të lidhur përdorin në mënyrë të rregullt produktet bankare, duke investuar, ndër vite, në depozita, çka bën të vështirë të besosh se ata nuk mund të kenë pasur jashtë sistemit bankar një shumë të konsiderueshme, siç është huaja e pretenduar prej 50.000 euro.

3.38. Nga hetimi administrativ rezultoi se, sipas pasqyrave financiare për mikronjësitet të përcjella nga DRT-ja Gjirokastër, rezulton se personat e tjerë të lidhur, nuk duket të kenë mbajtur në arkën e biznesit vlera të larta likuiditetesh *cash*, nuk kanë tërhequr shuma të përafërta me huan nga llogaritë bankare në periudhën kur kjo hua është dhënë, si dhe kanë investuar shumën 200.000 euro në pasuri të paluajtshme në periudhën 2008 – 2011.

3.39. Lidhur me pretendimin se situata e subjektit është e mbështetur edhe në vendimin nr. 15, datë 17.7.2019, nga Kolegji i Posaçëm i Apelit për situatën në fjalë, Komisioni vëren se

ky rast nuk është orientim për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme. Orientimi i Kolegjit në rastin e vendimit të sipërcituar i referohet një situatë të ndryshme nga ajo e subjektit të rivlerësimit⁹³.

3.40. Në procesverbalin e ILDKPKI-së të datës 16.4.2015, lidhur me kërkesën e bërë nga ILDKPKI-ja për të provuar aftësinë financiare të huadhënësit, subjekti, përveç dokumenteve të paraqitura dhe në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, në pyetësin standard dhe pyetësin nr. 2, ka paraqitur kopje të dokumenteve në gjuhën greke të shtetasve A. dhe E.H., kopje pasaportës së shtetasit A.H., ku pasqyrohet viza e shtetit grek e vitit 1997 dhe një kopje vize ku nuk dallohet periudha, si edhe disa dokumente të tjerë, ku duket sikur pasqyrojnë të ardhura në valutën dhrahmi greke, por të padallueshme qartësisht dhe jo sipas formës së kërkuar nga ligji.

3.41. Në përfundim, Komisioni nuk krijoi bindjen lidhur me marrjen e kësaj huaje nga subjekti, duke konsideruar: (i) faktin që nuk janë kryer tërheqje nga llogaritë bankare gjatë periudhës 1.1.2011 – 20.5.2011; (ii) vlerën e konsiderueshme të huas, 50.000 euro; (iii) periudhën e gjatë të kthimit rreth 15-vjeçare; (iv) dhënien hua të një shume të tillë pa interes; (v) dhënien hua të një shume të tillë pa dokument shkresor përpara noterit (i përpiluar vetëm pas pyetjes nga ana e ILDKPKI-së); si dhe (vi) një shumë e tillë nuk është dhënë për nevoja emergjente, por për blerjen e një shtëpie të dytë.

3.42. Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e rezultateve të hetimit në lidhje me mjaftueshmërinë e burimeve financiare të personave të tjerë të lidhur për dhënien e shumës 50.000 euro subjektit të rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, Komisioni i qëndron konstatimit fillestar se personat e tjerë të lidhur/huadhënësit nuk kanë pasur burime të mjaftueshme për dhënien e huas në shumën 50.000 euro në datën 20.5.2011. Për këtë arsye, në analizën financiare nuk u pasqyrua marrja dhe kthimi i saj.

3.43. Në konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin e krijimit të të ardhurave, si dhe personat e tjerë të lidhur/huadhënësit nuk kanë pasur burime të mjaftueshme për dhënien e huas, duke u gjendur në kushtet e germës “b”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Burimi 2 - Kursimet familjare në vlerën 18.000 euro

Shuma 8.000 euro, datë 3.12.2011 (pagesa për garazhet)

3.44. Në kontratën e porosisë së garazheve⁹⁴ rezulton se çmimi i përgjithshëm i garazheve është vendosur 8.000 euro dhe deklarohet se u likuidua nga porositësi 100% e vlerës totale në

⁹³ Në vijim të këtij arsytimi, Kolegji çmon se në rastet kur subjekti i rivlerësimit gjendet para situatës së parashikuar prej nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ai duhet të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të asaj pasurie, e cila është objekt dhurimi apo huaje, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë personat e tjerë të lidhur. Interpretimi në të kundërt i kësaj dispozite konsiderohet se shkel parimin e proporcionalitetit, pasi e ngarkon subjektin me një barrë përtej asaj që ai ligjërisht është ngarkuar të mbajë dhe barazon statusin e një shtetasi tjetër, personit tjetër të lidhur, që përgjithësisht nuk ka figuruar të ketë qenë subjekt deklarues, me atë të vetë subjektit të rivlerësimit, një mision që del jashtë qëllimit të ligjit e për më tepër duket edhe i pamundur. Pavarësisht, ky arsytim në asnjë rast nuk duhet të pengojë organet e rivlerësimit që të hetojnë çdo situatë të dyshuar se personat e tjerë të lidhur mbajnë pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit, apo se janë përdorur për të fshehur ekzistencën e një marrëdhënieje që të çon në një situatë konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me një person tjetër, dyshim i cili duhet të ngrihet mbi rrethana objektive.

⁹⁴ Nr. ***, datë 5.6.2011, paraqitur nga subjekti në dokumentacionin e dorëzuar në ILDKPKI konfirmuar nga shoqëria “***” sh.p.k. dhe nga arkiva e noteres M.Sh., dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 10.5.2021, të noterit S.Sh.

datën 3.12.2011. Referuar kontratës së shitjes dhe dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria “***” sh.p.k., vërtetohet se kjo pagesë është kryer në datën 3.12.2011.

3.45. Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 16.4.2015, në përgjigje të konstatimit lidhur me mosmbulimin e të ardhurave *neto* dhe pasurive *neto* për vitin 2011, subjekti ka deklaruar se këtë vit ka pakësuar gjendjen *cash* nga kursimet ndër vite dhe mosdeklarimi i këtij fakti në këtë vit ka qenë një pakujdesi, konkretisht, gjendja *cash* është pakësuar në shumën 3.000 euro për pagesën e garazhit. Për ta specifikuar, ka deklaruar se ka paguar shumën prej 58.000 euro në apartamentin në F., nga të cilat 50.000 euro i ka marrë hua, shuma 5.000 euro është nga kthimi i huadhënies dhe shuma 3.000 euro është nga pakësimi i gjendjes *cash*.

a. *Huaja dhënë shtetasit S.A. (vjehtërit) (dhënë hua 500.000 lekë në vitin 2004 dhe kthyer shuma 5.000 euro në vitin 2011)*

3.46. Referuar pikës 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, shtetasi S.A. konsiderohet person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit, për shkak të marrëdhënies së huas që ekziston ndërmjet tyre. Komisioni bazuar në pikën 4, të nenit 32, të ligjit 84/2016, hetoi lidhur me mjaftueshmërinë e krijimit dhe ligjshmërinë e burimit të shumës 500.000 lekë të dhënë hua në vitin 2004 nga subjekti dhe të shumës 5.000 euro të kthyer në vitin 2011 nga shtetasi S.A.

3.47. Nga hetimi administrativ, Komisioni konstaton se subjekti në DIPP-në e vitit 2004 deklaroi se i ka dhënë hua shtetasit S.A. shumën 500.000 lekë dhe në seksionin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme ka deklaruar: “*Cash i mbartur prej vitit 2003. Depozitë ‘Raiffeisen Bank’ shtuar mars 2004 tërhequr tetor 2004, pakësuar 500.000 lekë (dhënë hua)*”. Në DIPP-në e vitit 2011 ka deklaruar kthimin e huas të dhënë në vitin 2004 në shumën 5.000 euro.

3.48. Në pyetësin nr. 2⁹⁵, subjekti u pyet lidhur me burimin financiar të shumës prej 500.000 lekë të dhënë hua në vitin 2004, si dhe iu kërkuar të paraqesë dokumentacionin ligjor justifikues, lidhur me burimin e krijimit të shumës 5.000 euro nga ana e të ndjerit, shtetasit S.A., dokumentacion ligjor justifikues që provon këtë marrëdhënie huadhënie-huamarrje dhe nëse ka paguar detyrimet tatimore lidhur me fitimin e realizuar nga kjo marrëdhënie, konkretisht mbi diferencën e shumës 5.000 euro me shumën 500.000 lekë.

3.49. Në përgjigje⁹⁶, subjekti deklaroi se burimi financiar i shumës 500.000 lekë ka qenë gjendja *cash* prej 450.000 lekësh e deklaruar në vitin 2003 dhe kursime familjare nga pagat rreth 50.000 lekë të siguruara deri në momentin e vendosjes së depozitës, shumë e cila është tërhequr në tetor. Huamarrësi ka qenë babai i bashkëshortes (ndërruar jetë në vitin 2014) dhe që nga viti 2000 ai ka përfituar pension pleqërie edhe në shtetin grek. Subjekti, për të provuar këtë deklaram, ka paraqitur librezën ku depozitohej pensioni për periudhën 30.8.2010 – 21.1.2013, si dhe të ardhurat e siguruara nga pensioni i pleqërisë së tij dhe nënës së bashkëshortes. Gjithashtu, deklaroi se duke qenë prindi i bashkëshortes nuk kanë hartuar ndonjë marrëveshje apo kontratë. Kjo shumë është dhënë hua, pasi në vitin 2004 prindërit e bashkëshortes kanë prenotuar një apartament 1+1 në Gjirokastër dhe kanë paguar këstin e parë.

⁹⁵ E-mail i datës 7.5.2021.

⁹⁶ E-mail i datës 13.5.2021, ora 19.33.

Për shkak të marrëdhënies së ngushtë familjare, diferenca e shumës 5.000 euro me 500.000 lekë, nuk është vlerësuar si fitim dhe qëllimi nuk ka qenë shmangia e detyrimeve tatimore.

3.50. Lidhur me burimin e ligjshëm financiar për dhënien e huas nga subjekti shtetasit S.A., Komisioni konstatoi se sipas analizës financiare për periudhën 1998 – 2003 (krijimi i kursimeve në vlerën 450.000 lekë) dhe vitit 2004 (viti i dhënies së huas), subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme financiare të ligjshme për dhënien e kësaj huaje.

3.51. Lidhur me burimin e ligjshëm për kthimin e kësaj huaje nga shtetasi S.A., Komisioni analizoi të ardhurat nga pensioni në shtetin grek dhe në Shqipëri të të ndjerit S.A. dhe bashkëshortes së tij, bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, dhe rezultoi se gjatë periudhës 21.8.2010 – 3.12.2011 nga llogaria bankare në shtetin grek janë kryer disa tërheqje me vlerë totale 5.225 euro, burimi i të cilave kanë qenë të ardhurat nga pensioni. Gjithashtu, i ndjeri shtetasi S.A. dhe bashkëshortja e tij gjatë periudhës 1.1.2010 – 30.11.2011, kanë përfituar të ardhura nga pensioni në Shqipëri në shumën 872.675 lekë, ndërkohë që shpenzimet jetike për të njëjtën periudhë kanë qenë 523.710 lekë. Në përfundim, Komisioni vlerëson se i ndjeri shtetasi S.A. dhe bashkëshortja e tij kanë pasur burime të ligjshme financiare për kthimin e huas.

b. Pakësimi i kursimeve cash të mbartura në shumën 3.000 euro

3.52. Nga hetimi administrativ i Komisionit rezultoi se subjekti nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2011 pakësim të kursimeve *cash*. Pakësimin e gjendjes *cash*, subjekti e ka deklaruar përpara ILDKPKI-së në procesverbalin e datës 16.4.2015, në përgjigje të konstatimit lidhur me mosmbulimin e të ardhurave *neto* dhe pasurive *neto* për vitin 2011. Referuar procesverbalit, subjekti ka deklaruar se këtë vit ka pakësuar gjendjen *cash* nga kursimet ndër vite dhe, konkretisht, shumën 3.000 euro për pagesën e garazhit dhe për mosdeklarimin e këtij fakti në këtë vit, shprehet se ka qenë një pakujdesi. Gjithashtu, në pyetësin nr. 2, deklaroi se nga gjendja në fund të vitit 2010 prej 5.000 euro nga të cilat 3.000 euro janë përdorur për pagimin e kështit të garazhit Tiranë.

3.53. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: (i) subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme në shumën 191.500 lekë për pagesën e garazheve në Tiranë, pasi mungon dokumentacioni ligjor justifikues lidhur me fitimin e realizuar nga kthimi i huas; dhe (ii) subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme në shumën 3.000 euro për pagesën e garazheve në Tiranë.

3.54. Në përgjigje të rezultateve të hetimit⁹⁷, subjekti i rivlerësimit sqaroi se huaja nuk është dhënë me qëllim fitimin, por është dhënë si ndihmë vjehtë për të vërë pagesën për blerjen e apartamentit. Në këtë kuptim, nuk ka kërkuar fitim dhe as nuk e interpreton si realizim fitimi. Kjo është një formë ndihme nga prindërit e bashkëshortes gjatë vitit 2011 kur ishte duke blerë apartamentin në Tiranë. Meqenëse kishin pasur mundësi dhe likuiditete të lira, sepse prej vitit 2000 vjehtëri përfitonte pension në shtetin grek dhe shitën banesën e vjetër, atëherë kanë kthyer

⁹⁷. E-mail i datës 5.7.2021, ora 12:40

huan e marrë në vitin 2004, duke i dhuruar pjesën e diferencës me huan e dhënë. Shitja e pronës në shtator të vitit 2011 në vlerën 408.000 lekë është konstatuar edhe nga Komisioni me dokumentacioni e dërguar nga ASHK-ja Gjirokastër, shkresë protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 19.4.2021, duke provuar edhe burimin e ligjshëm të vlerës 5.000 euro. Pra, kjo është një dhuratë (ndihmë) për të cilën nuk ka pasur detyrim për shlyerje të tatimeve dhe nuk ka qenë fitim siç e ka interpretuar prej Komisioni, prandaj subjekti kërkoi të merret në konsideratë dhe të përfshihet në analizën financiare me vlerë 5.000 euro.

3.55. Lidhur me pakësimin e gjendjes *cash* në shumën 3.000 euro, sqaron se burimi i ligjshëm i kësaj shume është vlera e kthyer nga shtetasi R.S. pas blerjes së automjetit. Kjo vlerë është kthyer nga ky shtetas dhe është përdorur brenda vitit si pagesë për garazhin. Për këtë arsye nuk është deklaruar në DIPPP-në si kursim vlera e kthyer nga ky shtetas.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

3.56. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, propësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton si më poshtë:

3.57. Lidhur me fitimin e realizuar nga marrëdhënia e huas në vlerën 191.500 lekë, Komisioni vlerëson se nga analizimi deklaratimeve të subjektit në DIPP-në e vitit 2004, DIPP-në e vitit 2011 dhe deklaratimeve në pyetësorin nr. 2, ndërmjet subjektit dhe vjehrrit është krijuar një marrëdhënie huaje dhe jo një marrëdhënie dhurimi sikurse pretendon subjekti në shpjegimet e tij për rezultatin e hetimit, pasi në DIPP-në e vitit 2004 ka deklaruar se i ka dhënë hua 500.000 lekë dhe më pas në DIPP-në e vitit 2011 deklaroi se: “*Shtuar (kthyer huaja e dhënë në vitin 2004) 5.000 euro*” dhe në seksionin “Të dhëna konfidenciale” deklaroi se: “*S.A. kthyer 5.000 euro për huan e marrë prej 500.000 lekë në vitin 2004*”. Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, në nenin 8, përcakton: “*1. Për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale, merren si të ardhura të tatueshme: [...] d) të ardhurat nga enfiteoza, huaja dhe qiratë, më përjashtim të rasteve, kur të ardhurat janë realizuar nga zhvillimi i një veprimtarie tregtare, në kuptim të legjislacionit tregtar*”. Pika 3, e nenit D, e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 30, i ligjit nr. 84/2016, kërkon që subjekti të shpjegojë bindshëm jo vetëm burimin e ligjshëm të pasurive të deklaruara, por edhe ligjshmërinë e të ardhurave, të cilat duhet të jenë të krijuara nga burime të ligjshme, të jenë të deklaruara dhe për to të jenë paguar detyrimet tatimore përkatëse. Bazuar në këto dispozita ligjore, Komisioni vlerëson se subjekti ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme në shumën 191.500 lekë dhe, si pasojë, në analizën financiare pasqyroi vetëm kthimin e huas në shumën 500.000 lekë.

3.58. Për më tepër, nuk mund të merret në konsideratë pretendimi i subjektit se diferenca e përfituar ka qenë në formën e ndihmës, për sa kohë kjo vlerë nuk është deklaruar si dhuratë në deklaratën periodike vjetore dhe në deklaratën *Vetting*.

3.59. Lidhur me pakësimin e gjendjes *cash* në vlerën 3.000 euro, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2011, pakësimin e gjendjes *cash* në vlerën 3.000 euro. Këtë deklaram e ka bërë përpara ILDKPKI-së, në procesverbalin e datës 16.4.2015, në përgjigje të konstatimit lidhur me mosbulimin e të ardhurave *neto* dhe pasurive *neto* për vitin 2011. Në pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, parashikohet: “[...] 5. Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelimit”. Në kushtet kur subjekti ka pasur detyrimin të deklaronte shtesat apo pakësimet e gjendjes *cash*, sipas ligjit nr. 9049/2003, ndër vite, analiza e Komisionit bazohet vetëm në deklaramet e bëra nga subjekti në deklaramat periodike vjetore, duke mos e marrë në konsideratë pretendimin e subjektit për pakësimin gjendjes *cash* në vlerën 3.000 euro.

3.60. Më tej, vërehet një ndryshim i qëndrimit të subjektit të rivlerësimit në këtë fazë të procesit, pasi në procesverbalin e ILDKPKI-së, si dhe gjatë hetimit ka deklaruar se vlera 3.000 euro ka si burim likuiditetet *cash* të disponuara në fund të vitit 2010, ndërkohë që në prapësime deklaroi që burim është vlera e kthyer nga shtetasi R.S.

3.61. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme në shumën 191.500 lekë dhe 3.000 euro për pagesën e garazheve në Tiranë, duke u gjendur në kushtet e germës “b”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Pagimi i shumës 5.000 euro, datë 10.5.2013 (për blerjen e apartamentit)

3.62. Nga hetimi Komisionit rezultoi se subjekti në DIPP-në e vitit 2013 ka deklaruar si burim: “Nga llogaria në ‘Alpha Bank’ +25.000 lekë kursime”, dhe në seksionin e ndryshimit të pasurive ka deklaruar “pakësuar mbyllje llogari ‘Alpha Bank’ në vlerën 675.000 lekë”

3.63. Referuar dokumentacionit të administruar nga “Alpha Bank”⁹⁸, konfirmohet se në datën 18.2.2013, bashkëshortja e subjektit ka tërhequr nga llogaria e saj shumën 673.286 lekë. Burimi i kësaj shume është maturimi i dy depozitave në këtë datë, respektivisht njëra në shumën 561.164 lekë dhe tjetra në shumën 113.388 lekë.

3.64. Depozita e parë është krijuar me anë të një derdhjeje në llogari në vlerën 400.000 lekë në datën 27.12.2006, e cila është kaluar më pas në depozitë me afat. Ndërsa depozita e dytë është krijuar në datën 28.7.2009, me anë të një derdhjeje në llogari në vlerën 100.000 lekë nga bashkëshortja e subjektit.

3.65. Duke mos pasur një datë të saktë se kur mund të jetë kryer shpenzimi për mobilimin dhe shlyerja pjesore e huas, Komisioni kreu analizën financiare në datën 31.12.2013, për verifikimin e burimeve të ligjshme për pagesën e kështit prej 5.000 euro, për sa kohë rritja e depozitës bankare është pasqyruar në çdo vit kalendarik duke afektuar analizën financiare. Nga analiza financiare e pasurive, shpenzimeve dhe të ardhurave të subjektit dhe personave të lidhur për vitin 2013, rezultoi një balancë negative në shumën 146.465 lekë.

3.66. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në

⁹⁸Shkresat nr. *** prot., datë 26.12.2019 dhe nr. *** prot., datë 11.5.2021.

lidhje me konstatimin se: (i) subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën 146.465 lekë për blerjen e pasurive, kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën në kursime për vitin 2013.

3.67. Në përgjigje të rezultateve të hetimit⁹⁹, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se, duke konsideruar në analizën financiare të gjitha sqarimet dhe provat e përcjella prej tij, rezultati i këtij viti do të ndryshojë sipas tabelës së paraqitur, ku rezulton një balancë pozitive në shumën 343.818 lekë. Në këtë tabelë evidentohen shpenzime jetese më të ulëta se ato të përlllogaritura nga Komisioni dhe nuk përfshihen shpenzime arredimi.

3.68. Ndërkohë që në raportin e audituesit ligjor, është paraqitur një tabelë tjetër, ku pasqyrohet një balancë pozitive në shumën 28.535 lekë dhe ku evidentohet një vlerë e ndryshme lidhur me shpenzimet e arredimit në vitin 2013, konkretisht, vlera 175.000 lekë përkundrejt vlerës 350.000 lekë të përlllogaritur nga Komisioni.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

3.69. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton si më poshtë:

3.70. Duke marrë në konsideratë pretendimet e subjektit, lidhur me shlyerjen e huas, Komisioni konstaton se balanca e vitit 2013 rezulton pozitive në shumën 344.270 lekë dhe, për rrjedhojë, arrin në përfundimin se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për kryerjen e shpenzimeve dhe pagesën e këstit në vitin 2013.

Pagimi i shumës 5.000 euro, datë 13.12.2014 (për blerjen e apartamentit)

3.71. Nga hetimi i Komisionit rezulton se subjekti në DIPP-në e vitit 2014, ka deklaruar se vlera 300.000 lekë e shitjes¹⁰⁰ së automjetit me targa ***, është përdorur për shlyerjen e këstit të banesës dhe, më tej, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka sqaruar se diferenca rreth 400.000 lekë është paguar nga kursimet vjetore.

3.72. Duke mos pasur një datë të saktë se kur mund të jetë kryer shpenzimi për arredimin dhe shlyerjen pjesore të huas, Komisioni kreu analizën financiare në datën 31.12.2014, për verifikimin e burimeve të ligjshme për pagesën e këstit prej 5.000 euro. Nga analiza financiare për pasuritë, shpenzimet dhe të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur për vitin 2014, rezultoi një balancë negative në shumën 678.795 lekë.

3.73. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: (i) subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime të ligjshme

⁹⁹ E-mail i datës 5.7.2021, ora 12:40

¹⁰⁰ Kontratë nr. ***, datë 29.7.2014.

financiare për blerjen e pasurive, kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën në kursime për vitin 2014, me një balancë negative në shumën 678.795 lekë.

3.74. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁰¹, subjekti i rivlerësimit paraqiti pretendime për analizën financiare të vitit 2014, të shpjguara edhe në raportin e audituesit ligjor, konkretisht, lidhur me: (i) pagat e bashkëshortes së subjektit, pasi referuar llogarisë së saj të pagës në “Raiffeisen Bank”, rezultojnë në shumën 729.430 lekë dhe jo sa është llogaritur nga Komisioni; (ii) pagat e subjektit, referuar llogarisë së tij të pagës në “Tiranës Bank” rezultojnë në shumën 1.328.060 lekë dhe jo sa është llogaritur nga Komisioni; (iii) shpenzimet e konsumit familjar duhen llogaritur në shumën prej 659.172 lekë (54.931*12 muaj), pasi bazuar në të në të dhënat e publikuar nga INSTAT rezulton se shpenzimet mesatare mujore për jetesë për konsum ushqimor, jo ushqimor, edukim dhe blerje pajisje afatgjata për një person në qytetin e Vlorës për vitin 2014 janë 54.931 lekë/muaj për familje; (iv) për vitin 2014 nuk ka deklaruar shpenzime arredimi, ndërkohë që Komisioni i ka përlllogaritur; (v) rishikimin e shpenzimeve për udhëtime në analizën financiare të të gjitha viteve, specifikisht rishikimin e vendosjes së kartonit jeshil për çdo udhëtim; reduktimin e shpenzimeve për udhëtimet brenda ditës në Janinë duke vendosur një kosto 15-20 euro në total përkundrejt vlerave të vendosura nga Komisioni të shpjguara në metodikën e analizës financiare¹⁰², për arsye se kanë pasur për qëllim blerje të ushqimeve dhe të mirave të tjera si blerje në farmaci, të cilat përfshihen në shpenzime jetike dhe, si të tilla, nuk duhet të përlllogariten edhe shpenzime qëndrimi; udhëtimet në Kosovë janë përlllogaritur në mënyrë të padrejtë në vlerën 50 euro/ditë, pra, me vlerë të njëjtë si qëndrimet në Romë, Athinë, të cilat kanë një standard jetese më të lartë.

3.75. Për sa i përket shpenzimeve të arredimit për apartamentin në Tiranë, subjekti deklaroi se: *“Shpjegoj se kam deklaruar se këto shpenzime janë bërë në vitet 2013, 2015, 2016 dhe 2017 dhe nuk shikoj arsye pse të konsiderohen nga Komisioni vetëm në vitet 2013-2014. Siç dihet këto janë shpenzime që gjithsecili i kryen sipas mundësive dhe nevojave/planeve të veta. Unë nuk kam pasur qëllim në vitin 2013 të transferohesha në Tiranë, pasi punën time dhe të bashkëshortes e kam pasur të lidhur me qytetin e Vlorës. Ndërsa për sa i përket fillimit të banimit në këtë apartament, kam deklaruar se në këtë apartament fillimisht (tetor 2013 – tetor 2014) ka jetuar djali i motrës së bashkëshortes, i cili ishte student dhe jetonte në kushte shumë minimaliste në këtë apartament. Unë nuk e kisha plotësuar të gjithë apartamentin, por vetëm disa mobilje kryesore. Nga muaji tetor 2014 - korrik 2019 në këtë banesë ka filluar të banojë dhe vajza ime, L.S., së bashku me nënën e bashkëshortes dhe prandaj vendosa të bëja plotësimin e tij me arredimin e nevojshëm i cili është kufizuar nga mundësitë e mia financiare dhe prandaj është shtyrë në periudhën 2005 – 2017. Besoj se këto vlera janë përkatësisht sa edhe mundësitë e mia financiare të çdo viti, përkatësisht në vitin 2015 kam shpenzuar rreth 170.000 lekë, në vitin 2016 kam shpenzuar rreth 30.000 lekë dhe në vitin 2017 rreth 150.000 lekë”.*

3.76. Në përfundim, analiza financiare e paraqitur nga subjekti rezulton me një balancë

¹⁰¹ E-mail i datës 5.7.2021, ora 12:40.

¹⁰² Për sa i përket udhëtimeve drejt Janinës, u konsideruan shpenzime si në vijim: në rastet vajtje-ardhje brenda të njëjtës ditë në Janinë, shpenzimet e qëndrimit u konsideruan 20 euro/ditë. Për fëmijët (5-18 vjeç) u konsiderua 50% e kësaj vlere, pra 10 euro/ditë; shpenzime udhëtimi për rastet kur nuk ka udhëtuar me automjetin personal u konsideruan 20 euro për udhëtimet Vlorë – Janinë dhe 10 euro për Gjirokastër – Janinë.

pozitive në vlerën 4.781 lekë.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

3.77. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton si më poshtë:

3.78. *Lidhur me pretendimin e subjektit se pagat e bashkëshortes në vitin 2014 kanë qenë në shumën 729.430 lekë përkundrejt shumës 690.730 lekë të përlllogaritur në rezultatet e hetimit*, Komisioni arsyeton se ky pretendim është i pabazuar, pasi në shumën 729.430 lekë në tabelën e paraqitur në raportin e audituesit ligjor për pagat e vitit 2014 është përfshirë edhe shuma për shpërbllim e kredituar në datën 5.1.2015, në vlerën 38.700 lekë, vlerë e cila është pikërisht diferenca midis dy vlerave të sipërpërmendura dhe që Komisioni e ka përfshirë në analizën e vitit në të cilën kjo shumë është përfituar, pra, në vitin 2015.

3.79. *Lidhur me pretendimin e subjektit se pagat e subjektit në vitin 2014 kanë qenë në shumën 1.328.060 lekë përkundrejt shumës 1.317.061 lekë të përlllogaritur në rezultatet e hetimit*, Komisioni arsyeton se ky pretendim është i pabazuar, pasi në tabelën e paraqitur në raportin e audituesit ligjor për pagat e vitit 2014 është përfshirë edhe shuma e kredituar nga Ministria e Financave në datën 10.12.2014 në vlerën 11.000 lekë, vlerë e cila duhet të ketë të bëjë me dieta¹⁰³, për sa kohë që shuma e pagave *neto* të kredituara në llogarinë e subjektit gjatë vitit 2014 (duke mos e përfshirë shumën 11.000 lekë), përkon ekzaktësisht më pagat *neto* për periudhën dhjetor 2013 – nëntor 2014 të përlllogaritura mbi bazën e informacionit të përcjellë nga ISSh-ja¹⁰⁴.

3.80. *Lidhur me pretendimin e subjektit për reduktimin e shpenzimeve jetike*, referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, shpenzimet bazike që përlllogariten sipas INSTAT-it, janë mbështetur mbi një mesatare të përgjithshme që përfshin edhe nivelin e varfërisë, bazuar në shpenzimet e përditshme jetike të qëndrimit dhe jetesës në Republikën e Shqipërisë dhe pagat mujore të këtushme. Ato referohen në mungesë të dokumentacionit si dyshemeja nën të cilën nuk mund të argumentohet, përveçse mbi prova shkresore. Për këto arsye, ky pretendim i subjektit u gjet i pabazuar.

3.81. *Lidhur me pretendimin e subjektit për reduktimin e shpenzimeve të udhëtimit*, Komisioni arsyeton se subjektit, bashkë me relacionin e rezultateve të hetimit kryesisht, i është vendosur në dispozicion aneksi 01, në të cilin, ndër të tjera, është përfshirë edhe një faqe me emërtim “TIMS”, ku pasqyrohen të detajuara kostot për secilin udhëtim. Për udhëtimet jo me automjetin personal të subjektit, nuk janë përlllogaritur shpenzime për kartonin jeshil. Duke qenë se kartoni jeshil në shumën 40 euro, ka një afat dy javor, Komisioni saktësoi udhëtimin e datës 5.8.2010,

¹⁰³Aneks 02 - në rast se në dokumentacionin e administruar është konfirmuar se pagesa të caktuara kanë natyrën e dietës, kjo shumë nuk është përfshirë në analizën financiare, pasi ato janë vlera monetare të destinuara për të mbuluar shpenzimet e kryera gjatë një veprimtarie të caktuar.

¹⁰⁴Shkresë nr. *** prot., datë 27.12.2019.

duke i zbritur shumën 40 euro, për të cilin ishte përlllogaritur në udhëtimin e datës 23.7.2010 dhe udhëtimin e datës 5.2.2016, duke i zbritur shumën 40 euro, për të cilin ishte përlllogaritur në udhëtimin e datës 1.2.2016. Në çdo rast, shuma e kartonëve jeshil në vlerën 40 euro për një afat 2-javor nuk e ka tejkaluar vlerën 400 euro/automjet për një afat 1-vjeçar.

3.82. *Lidhur me pretendimin për reduktimin e shpenzimeve për udhëtimet 1 ditore në Janinë, duke konsideruar 15-20 euro/ditë në total përkundrejt vlerave të përlllogaritura nga Komisioni, Komisioni thekson se edhe në rastin e përlllogaritur maksimalisht 40 euro/ditë, sërish këto vlera janë më të ulëta se praktika e përdorur nga Kolegji¹⁰⁵, sipas së cilës shpenzimet e qëndrimit për personat e rritur janë përlllogaritur në shumën 50 euro/ditë pavarësisht kthimit ose jo brenda ditës dhe pavarësisht destinacionit. Ky argument vlen edhe për pretendimin lidhur me shpenzimet për udhëtimet në Kosovë. Për këto arsye, Komisioni e gjeti të pabazuar pretendimin e subjektit dhe pasqyroi vetëm reduktimin e shumës 40 euro në analizën e vitit 2010 dhe 40 euro në analizën e vitit 2016.*

3.83. Për sa i përket pretendimit të subjektit për shpenzimet e arredimit në apartamentin në Tiranë, Komisioni i qëndron arsyetimit në rezultatet e hetimit, për sa kohë në këtë apartament është banuar që prej tetor të vitit 2013 dhe në vijim, si dhe duke pasur parasysh se pjesa më e madhe e shpenzimeve të arredimit (përfshirë pajisjet elektrike) janë shpenzime të cilat kryhen përpara ose në fillim të banimit.

3.84. Duke marrë në konsideratë pretendimet e subjektit lidhur me mospasqyrimin e shlyerjes së huas, për sa kohë vetë huaja nuk u paraqit në analizën financiare, rezulton se balanca negative e vitit 2014 është në vlerën 188.410 lekë.

3.85. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burime të ligjshme financiare në vlerën 188.410 lekë për blerjen e pasurive, kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën e kursimeve në vitin 2014, duke u gjendur në kushtet e gërmës “b”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

4. Autoveturë tip “Daimler Chrysler” (Mercedes-Benz), me vlerë 3.850 euro, prodhim i vitit 2004

4.1. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti ka deklaruar autoveturë 4+1, me targa ***, prodhim i vitit 2004, blerë në vitin 2011, në vlerën 3.850 euro dhe regjistruar pranë DRSHTRR-së Vlorë. Pjesa takuese: 50%. Si burim krijimi deklaroi kursimet familjare. Për vërtetimin e deklaratimit, subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues¹⁰⁶.

4.2. Nga hetimi administrativ i Komisionit, rezulton se subjekti në DIPP-në e vitit 2011 ka deklaruar autoveturë “Mercedes-Benz” të regjistruar pranë DRSHTRR-së Vlorë në vlerën 3.850 euro dhe nuk ka deklaruar burimi krijimi.

¹⁰⁵Vendim nr. 11-2019 (JR), datë 22.5.2019, i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

¹⁰⁶1. Vërtetim datë 24.10.2016 nga DPSHTRR-ja Vlorë; (2) faturë e shitjes datë 13.10.2011 në gjuhën gjermane; (3) formulari zhdoganimi datë 27.10.2011; (4) kopje e faqes së sistemit elektronik të DPSHTRR-së; (5) kartë e regjistrimit të automjetit në gjermanisht bashkë me përkthimin shqip; (6) mandatpagese për doganën e datës 27.10.2011, nga “Tirana Bank”; (7) urdhër çlirimi nga Dogana Kakavijë.

4.3. Në pyetësoin standard¹⁰⁷, subjekti ka deklaruar se në vitin 2011 i ka transferuar shtetasit R.S.¹⁰⁸ shumën 10.500 euro dhe e ka pajisur me prokurë për blerje automjeti në Gjermani. Për vërtetimin e këtij deklarimi ka dorëzuar mandatin e depozitimit të kësaj shume në datën 11.10.2011 në llogarinë e shtetasit R.S. në NBG. Pas blerjes së automjetit, ka vijuar subjekti, diferenca i është kthyer dorazi në momentin kur i ka sjellë automjetin.

4.4. Referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* të vitit 2017 dhe të konfirmuar nga DPSHTRr-ja¹⁰⁹, rezulton se automjeti është i tipit “Daimler Chrysler C200 CDI”, blerë nga shtetasi M.H., me faturë shitje në datën 13.10.2011, në vlerën 3.850 euro dhe se automjeti është me defekt në sensorin e vajit dhe ka probleme në motor. Për zhdoganimin e automjetit, subjekti ka paguar shumën 142.800 lekë, sipas mandatit bankar, datë 27.10.2011, të “Tiranë Bank”.

4.5. Nga kontrolli i kryer në AMF, rezulton se subjekti është përdorues i këtij automjeti që nga data 7.11.2011.

4.6. Komisioni kreu analizën financiare në datën 11.10.2011 për të verifikuar burimin e ligjshëm të shumës së depozituar prej 10.500 euro dhe subjekti rezulton me balancë negative në shumën 962.598 lekë.

4.7. Komisioni vëren se pavarësisht dyshimeve mbi vlerën e vërtetë të automjetit, pasi depozitimi në bankë është bërë vetëm dy ditë përpara blerjes në Gjermani, duket e vështirë që një automjet me probleme të tilla të ketë udhëtuar nga Gjermania për një distancë prej rreth 1.700 km dhe, në çdo rast, diferenca prej 6.650 euro duhet të ketë qenë e përafërt me shpenzimet e kryera për riparimin e tij, për sa kohë që subjekti nuk e ka deklaruar si të kursyer *cash* këtë shumë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011. Për këtë arsye, Komisioni paraqiti shumën 6.650 euro si shpenzim në analizën financiare.

4.8. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: (i) subjekti dhe personat e lidhura kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën 962.598 lekë për depozitimin e shumës 10.500 euro në datën 11.10.2011.

4.9. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹¹⁰, subjekti shpjegoi se në momentin e xhirimit të shumës 10.500 euro shtetasit R.S. për blerje automjeti, ka pasur gjendje *cash* shumën prej 300.000 lekësh (diferenca e gjendjes *cash* në fund të vitit 2010 me pagesën e këstit të fundit 700.000 lekë për blerjen e apartamentit në Vlorë) dhe shumën 5.000 euro të deklaruar si kursime në deklaratimet periodike deri në fund të vitit 2010, si dhe kursime të tjera familjare të krijuara deri në atë moment nga të ardhurat e vitit 2011. Deklarimi i gjendjes *cash* është bërë në ILDKPKI dhe është saktësuar në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 (pyetja 8). Në vijim, shpjegon se, pasi shtetasi R.S. e njoftoi se ka gjetur një automjet në gjendje të mirë me vlerë të ulët, për shkak të disa defekteve të riparueshme, që mund të bëhen edhe në Shqipëri, ra dakord ta blinte.

¹⁰⁷E-mail-i datës 18.12.2019.

¹⁰⁸ Nga verifikimi në QKB rezultoi se shtetasi R.S. është ortak i vetëm i shoqërisë “***” sh.p.k., NIPT ***, e regjistruar në datën 1.7.1996, me fushë veprimtarie “tregtim automjete të përdorura”.

¹⁰⁹Shkresë nr. *** prot., datë 10.1.2020.

¹¹⁰ E-mail i datës 5.7.2021, ora 12:40

Më pas, pasi u kthye nga Gjermania, ky shtetas i ka dhënë dorazi shumë 6.000 euro, pasi për automjetin ishin shpenzuar 4.500 euro me gjithë transportin.

4.10. Gjithashtu, subjekti shpjegon se një pjesë të shumës së kthyer, në vlerën 3.000 euro, i ka përdorur për pagimin e garazhit, kurse pjesën tjetër 2.000 euro e 1.000 euro i konvertoi në lekë dhe ka plotësuar shumë 300.000 lekë *cash*. Sipas tij, konstatimi i Komisionit lidhur me shpenzimet e kryera për riparimin e tij nuk është i saktë, pasi ai ka deklaruar se automjeti për të ardhur në Shqipëri ka kushtuar 4.500 euro nga të cilat vlera në kontratën e shitjes është 3.850 euro dhe diferenca 650 euro (4.500-3.850) janë shpenzimet e transportit deri në Shqipëri dhe në analizën financiare duhet të vendosen këto vlera si shpenzime për automjetin bashkë me shumë prej 6.000 euro të kthyer nga shtetasi R.S. Për vërtetimin e deklaramëve, bashkë me shpjegimet, subjekti ka paraqitur deklaratën nr. ***, datë 24.6.2021, të shtetasit R.S.

4.11. Po kështu, vijon subjekti, gjetja e Komisionit se gjithë shuma e derdhur është përdorur për blerjen dhe riparimin e këtij automjeti nuk është e saktë dhe, po kështu, nuk qëndrojnë as konstatimet e Komisionit lidhur me paraqitjen si shpenzim të vlerës 6.650 euro. Nëse shpenzimet për riparimin do të ishin me vlerë më të lartë se vetë vlera e automjetit, atëherë nuk do të kishte kuptim ta blija atë, shpjegon subjekti. Ndërsa lidhur me konstatimin tjetër se kjo shumë nuk është deklaruar si kursim në DIPP-në e vitit 2011, sqaron se nuk është bërë prej tij, sepse kjo vlerë siç është sqaruar, është përdorur brenda vitit për të bërë pagesën e garazhit.

4.12. Lidhur me shpenzimet e paraqitura në analizën financiare të vitit 2011, subjekti kërkon të mos përfshihet në analizë zëri “shpenzime për detyrimet tatimore për shitje pasurie të paluajtshme”, në vlerën 51.500 lekë.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

4.13. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaramet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaramet periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaramet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

4.14. Nga hetimi administrativ, Komisioni konstaton se subjekti ka depozituar në bankë në favor të shtetasit R.S. shumë 10.500 euro, dy ditë përpara blerjes së automjetit në Gjermani, çka tregon që automjeti ishte përzgjedhur dhe palët kishin rënë dakord për çmimin e blerjes dhe për shpenzimet e riparimit. Në kushtet kur automjeti ishte me defekt në sensorin e vajit dhe kishte probleme në motor, duket e vështirë të ketë udhëtuar nga Gjermania për një distancë rreth 1.700 km. Gjithashtu, subjekti nuk provoi shumë e shpenzuar për riparimin e tij.

4.15. Në pikën 5, të neni 32, të ligjit 84/2016, parashikohet: “[...] 5. *Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelimit*”. Në kushtet kur subjekti ka pasur detyrimin të deklaronte shtesat apo pakësimet e gjendjes *cash* sipas ligjit nr. 9049/2003, ndër vite, analiza e Komisionit bazohet vetëm në deklaramet e bëra prej tij në deklaramet periodike vjetore dhe për sa kohë që nuk e ka deklaruar si të kursyer *cash* këtë shumë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011, Komisioni e paraqiti shumë 6.650 euro si shpenzim në analizën financiare.

4.16. Komisioni vëren se nëse merret parasysh përdorimi i likuiditeteve *cash* në fund të vitit 2010, balanca negative e fondeve në fund të vitit kalendarik do të jetë në vlerën 956.485 lekë¹¹¹, për sa kohë vlera 6.650 euro konsiderohet shpenzim.

4.17. Për sa i përket vlerës 51.500 lekë të pasqyruar në analizën financiare të vitit 2011, Komisioni sqaron se kjo vlerë ka të bëjë me pagesa për llogari të ZVRPP-së Vlorë të kryera nga llogaria bankare e bashkëshortes së subjektit në “Raiffeisen Bank” në datën 18.1.2011. Disa prej këtyre transfertave janë administruar edhe në përgjigjen¹¹² e ASHK-së Drejtoria Vendore Vlorë.

Përshkrim	2011
Gjendje <i>cash</i> datë 1.1.2011	1,865,000
Gjendje likuiditete në bankë në datën 1.1.2011	1,017,174
Likuiditete në datën 1.1.2011	2,882,174
Gjendje <i>cash</i> në datën 31.12.2011	1,865,000
Gjendje likuiditete në bankë në datën 31.12.2011	1,181,650
Likuiditete në datën 31.12.2011	3,046,650
Të ardhura nga pagat subjekti	1,078,331
Të ardhura nga pagat bashkëshortja	523,347
Të ardhura nga interesat bankare	59,011
Total të ardhura	1,660,689
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI/INSTAT	546,480
Shpenzime për detyrimet tatimore për shitje pasurie të paluajtshme	51,500
Shpenzime për udhëtime nga sistemi <i>TIMS</i>	213,844
Shpenzime për automjete (TPL AMF)	18,100
Pagesë për blerjen e automjetit me targa *** (10.500 euro)	1,479,975
Pagesë detyrime doganore për automjetin me targa ***	142,800
Total shpenzime	2,452,699
Balanca e fondeve (të ardhura-shpenzime-likuiditete në fund + likuiditete në fillim)	-956,485

4.18. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti dhe personat e lidhura kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën 956.485 lekë për automjetin me targa ***, duke u gjendur në kushtet e germës “b”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

5. Depozitë bankare në emër të bashkëshortes në vlerën 524.733 lekë, në BKT

5.1. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti deklaroi depozitë bankare në emër të bashkëshortes në vlerën 524.733 lekë, në BKT. Pjesa takuese: 50 %. Nuk ka deklaruar burim krijimi. Për vërtetimin e deklaramit ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues.¹¹³

5.2. Nga dokumentacioni i administruar nga BKT¹¹⁴ konfirmohet se shtetasja M.S. disponon depozitë bankare në vlerën 527.397,51 lekë me datë maturimi 20.1.2020.

5.3. Në lëvizjet e llogarive bankare konstatohet se kjo depozitë është krijuar në datën 18.1.2010, në shumën fillestare 400.000,72 lekë dhe burimi i saj është transfera e kryer nga

¹¹¹Duke konsideruar të ardhurat nga paga, interesat bankare dhe shpenzimet vjetore, si edhe duke përjashtuar pagesat për apartamentin dhe garazhin, të cilat nuk kanë si burim të ardhurat e paraqitura në këtë tabelë.

¹¹²Shkresë nr. ***, datë 22.1.2020.

¹¹³Vërtetim nr. *** prot., datë 25.1.2017, i BKT-së.

¹¹⁴Shkresë nr. *** prot., datë 17.1.2020.

shtetasi P.Ll. për këstin e dytë të shtëpisë në Gjirokastrë, në vlerën 3.000.000 lekë, datë 14.1.2009.

5.4. Referuar paragrafit 2.30, të vendimit, subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën 563.618 lekë, lidhur me të ardhurat nga shitja e apartamentit në Gjirokastrë. Për sa i përket burimit të ligjshëm të kësaj depozite, Komisioni kreu analizën financiare të vitit 2009, vit në të cilin e kanë origjinën fondet për krijimin e kësaj depozite, nga ku rezultoi një balancë negative në vlerën 272.953 lekë. Për të dyja këto balanca negative, Komisioni ka konkluduar në paragrafët përkatës në këtë vendim.

6. Llogari bankare e hapur në emër të vajzës K.S., në vlerën 9.010 lekë, në BKT.

6.1. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti deklaroi llogari bankare në emër të vajzës K.S. të hapur në vitin 2015, në vlerën 9.010 lekë. Si burim krijimi deklaroi pagesë nga klubi shumë sportesh “***”. Për vërtetimin e deklaratës subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues¹¹⁵.

6.2. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se referuar dokumentacionit të administruar nga BKT-ja¹¹⁶ konfirmohet se shtetasja K.S. disponon llogari bankare me gjendje 9.010 lekë në datën 26.1.2017. Në lëvizjet e llogarive bankare konstatohet se kreditimet kanë të bëjnë me dieta nga klubi shumë sportesh “***”.

6.3. Nga hetimi administrativ, lidhur me këtë llogari, nuk u konstatuan problematika që lidhen me procesin e rivlerësimit të subjektit.

6.4. Si përfundim, Komisioni vlerëson se deklarimi i subjektit është i saktë dhe ka burime të ligjshme me dokumentacion justifikues për krijimin e saj.

7. Kursime cash në vlerat 2.000 euro dhe 300.000 lekë

7.1. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti ka deklaruar kursime në vlerën 2.000 euro dhe 300.000 lekë. Si burim krijimi deklaroi kursime familjare ndër vite.

7.2. Nga hetimi administrativ konstatohet se subjekti lidhur me gjendjen *cash* në deklaratat periodike vjetore, deklaroi: (i) në DIPP-në e vitit 2003: “Gjendje *cash* 0.45, burimi kursime familjare”; (ii) në DIPP-në e vitit 2004: “Cash i mbartur 2003, depozitë Raiffeisen Bank, shtuar mars 2004, tërhequr tetor 2004, pakësuar 500.000 lekë (dhënë hua)”; (iii) në DIPP-në e vitit 2005: “Shtuar - kursime familjare nga të ardhurat e vitit 2005, 500.000 lekë”; (iv) në DIPP-në e vitit 2006 nuk ka deklaruar gjendje/shtesa/pakësime; (v) në DIPP-në e vitit 2007: “Shtesa kursime nga të ardhurat 1.000 euro depozituar në Tirana Bank; 2.000 euro gjendje *cash*. Vlera 3.000 euro”; (vi) në DIPP-në e vitit 2008: “Shtesë kursime nga të ardhura nga pagat, vlerë 4.000 euro = 500.000 lekë gjendje *cash*, tërheqje nga depozita pranë Tirana Bank krijuar në vitin 2007, vlera 1.000 euro gjendje *cash*”; (vii) në DIPP-në e vitit 2009: “Shtesë kursime nga pagat depozitë dhe *cash*. Vlera 300.000 lekë dhe 100.000 lekë depozitë Alpha Bank”; (viii) në DIPP-në e vitit 2010: “Shtesë kursime nga paga, vlerë 300.000 lekë. Pakësim tërheqje BKT 180.000 lekë”; (ix) në DIPP-në e vitit 2011, 2012, 2013 dhe 2014 nuk ka deklaruar gjendje/shtesa/pakësime; (x) në DIPP-në e vitit 2015: “Mbyllur llogaria pranë

¹¹⁵Gjendje llogarie datë 25.1.2017 nga BKT-ja.

¹¹⁶Shkresë nr. *** prot., datë 17.1.2020.

Veneto Bank (në emër të bashkëshortes), shtuar cash, vlera 119.419 lekë; si dhe (x) në DIPP-në e vitit 2016: “Pakësuar cash 119.419 lekë”.

7.3. Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, datë 16.4.2015, në përgjigje të konstatimit të ILDKPKI-së lidhur me mosmbulimin e të ardhurave *neto* dhe pasurive *neto* për vitin 2011 në një vlerë prej 997.800 lekësh, subjekti ka deklaruar se këtë vit ka pakësuar gjendjen *cash* nga kursimet ndër vite dhe mosdeklarimi i këtij fakti ka qenë një pakujdesi. Gjendja *cash*, ka vijuar subjekti, është pakësuar në shumën 700.000 lekë si diferencë e mbetur në blerjen e apartamentit dhe shuma 3.000 euro për pagesën e apartamentit dhe garazhit. Pra, për ta specifikuar, deklararon se ka paguar shumën 58.000 euro në apartamentin në F, nga të cilat 50.000 euro i ka marrë hua, shuma 5.000 euro është nga kthimi i huadhënies dhe shuma 3.000 euro është nga pakësimi i gjendjes *cash*.

7.4. Me anë të pyetësorit nr. 2¹¹⁷, subjektit iu kërkua të përcaktojë, bazuar në deklaratimet e tij vjetore, se sa ka qenë gjendja e likuiditeteve *cash* (jashtë sistemit bankar) në fund të çdo viti kalendarik dhe nga analizimi i përgjigjeve të subjektit, Komisioni konstaton mospërputhje midis deklaratave periodike vjetore dhe shpjegimeve të dhëna në pyetësorin nr. 2, konkretisht: (i) për vitin 2009 nuk janë deklaruar pakësime në DIPP-në përkatëse, ndërkohë që në pyetësor subjekti ka deklaruar një pakësim prej 100.000 lekësh, konkretisht ka deklaruar: “Gjendja e mbartur nga viti 2008 1.000.000, e cila është pakësuar 100.000 përdorur për arredimin e banesës Vlorë së bashku me të ardhura të tjera të këtij viti + 200.000 kursimet vjetore”; (ii) për vitin 2010 ka deklaruar: “Shtesë kursime nga paga, vlerë 300.000 lekë”, ndërkohë që në pyetësor subjekti ka deklaruar një pakësim prej 100.000 lekësh, konkretisht ka deklaruar “100.000 lekë janë pakësuar nga gjendja e vitit 2009 prej 1.100.000 dhe janë përdorur për arredimin e banesës Vlorë së bashku me të ardhura të tjera të këtij viti”. Gjithashtu, subjekti në përlllogaritjet e tij shtesën e deklaruar prej 300.000 lekësh e ka konsideruar të konvertuar në vlerën prej 2.000 euro; (iii) për vitin 2011, në pyetësorin nr. 2 subjekti i ka qëndruar deklaratimeve në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, lidhur me pakësimin gjatë këtij viti të shumës 700.000 lekë dhe shumës 3.000 euro.

7.5. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: (i) ka mospërputhje midis gjendjes së likuiditeteve *cash* të akumuluar në fund të vitit 2016 dhe gjendjes së likuiditeteve *cash* të deklaruar në deklaratën *Vetting*.

7.6. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹¹⁸, subjekti shpjegoi se në lidhje me këtë fakt ka dhënë shpjegime të hollësishme në pyetësorin nr. 2 (pyetja 8), si dhe u qëndron atyre shpjegimeve. Mendon se gabimi është bërë sidomos kur është bërë përmbledhja e gjithë vitit, që duke mos qenë e qëllimshme, nuk të kujtohen, por vetëm kur janë evidentuar është kujtuar dhe ka kuptuar gabimet e bëra. Megjithatë, shpjegon se kur është thirrur për të dhënë shpjegime në ILDKPKI, ka deklaruar gjendjen reale dhe se nuk ka pasur si qëllim të mbulojë konstatimin e vlerës negative në atë vit, por vetëm atëherë është kujtuar për veprimet. Në vijim, subjekti

¹¹⁷E-mail-i i datës 7.5.2021.

¹¹⁸E-mail i datës 5.7.2021, ora 12:40

shpjegon se, sipas logjikës, nuk mund të këtë pasur mundësi të shlyejë një këst me vlerë 700.000 lekë, vetëm disa ditë pasi kishte hyrë muaji janar, pasi ende nuk kishin kaluar pagat mujore. E njëjta situatë lidhet edhe me shumën 3.000 euro të përdorur për blerjen e garazhit.

7.7. Për deklarinimin e vitit 2009, subjekti sqaron se ka deklaruar: “*Shtesë kursime nga pagat, depozitë dhe cash. Vlera: 300.000 lekë, 100.000 lekë depozitë në Alpha Bank*” dhe nga ky deklarinim duhet kuptuar se shtesa totale e vitit ka qenë në shumën 300.000 lekë, nga të cilat 100.000 lekë janë depozitë në “Alpha Bank”. Kjo përputhet dhe me deklarinimin e të ardhurave të atij viti të deklaruar saktësisht “*shtesë nga interesat bankare në ‘Alfa Bank’ dhe BKT, vlera 100.000 lekë*”. Pra, kursimet në shumën 100.000 lekë në depozitë kanë burim të ardhurat nga interesat bankare. Ndërsa shtesa totale në vit ka qenë 300.000 lekë. Në pyetësin nr. 2 për gjendjen *cash* ka deklaruar se për shpenzimet e arredimit të vitit 2009 ka shpenzuar shumën 100.000 lekë nga gjendja e kursimeve dhe në fund të vitit 2009 gjendja e kursimeve është në shumën 1.100.000 lekë.

7.8. Për deklarinimin e vitit 2010, subjekti sqaron se ka deklaruar: “*Shtesë kursime nga paga, vlerë 300.000 lekë*”, ndërsa në pyetësin nr. 2, nuk ka ndryshuar deklarinimin, por vetëm ka dhënë sqarime se shumën 300.000 lekë e ka konvertuar në euro, të cilat i janë shtuar gjendjes së kursimeve euro, e cila arrin në vlerën 5.000 euro në fund të vitit 2010. Gjithashtu, ka shpjeguar edhe se ka shpenzuar shumën prej 100.000 lekësh për shpenzimet e arredimit, sipas logjikës së sqaruar për deklarinimin e vitit 2009. Për sa më sipër, rezulton se në fund të vitit 2016 gjendja e kursimeve është saktësisht sa është deklarimi në deklaratën *Vetting*, pra, në shumën 300.000 lekë dhe 2.000 euro. Mospërputhja e konstatuar nga Komisioni vjen si shkak i mospranimit të shpjegimeve të subjektit në ILDKPK dhe gjatë procesit dhe, si të tilla, nuk janë mospërputhje reale.

7.9. Lidhur me konstatimin e Komisionit për mospërputhjen në vlerën e gjendjes së kursimeve në deklaratën *Vetting* me deklaratat vjetore, që vijnë nga mos konsiderimi i shpjegimeve të subjektit, sqaron se kjo bie ndesh me detyrimin gjatë procesit të rivlerësimit, të përcaktuar në nenin D, të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 9409/2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar. Sipas tij, deklaratat e pasurisë dhe kontrolli i interesave nuk janë dokumente të izoluara por pjesë e një zinxhir procesi të rregullt që siç përcaktohet në ligj ka për qëllim të monitorojë deklarinimin dhe kontrollin e pasurisë legjitimitetin e burimeve të krijimit të saj. Në vijim, shton se gjatë janarit të vitit 2017 ka pasur disa shpenzime, të cilat i ka deklaruar në pyetësin nr. 2, si p.sh., plotësimi i arredimit dhe mobilimit për apartamentit në Tiranë (rreth 150.000 lekë), si dhe shlyerja e një pjesë të huas ndaj shtetasit A.H. (3.500 euro), të cilat Komisioni duhet t’i konsiderojë edhe këto si prova që shpjegojnë gjendjen *cash* në datën e deklaratës “*Vetting*”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

7.10. Komisioni vlerëson se subjekti, në zbatim të germës “d”, të nenit 4, të ligjit 9049/2003, të ndryshuar, ka pasur detyrimin të deklaronte shtesat apo pakësimet e gjendjes *cash* në deklarimet vjetore të pasurisë. Si rrjedhojë, Komisioni, bazuar në pikën 5, të nenit 32, të ligjit 84/2016, pasqyroj në analizën financiare, vetëm shtesat dhe pakësimet e gjendjes *cash* të deklaruara nga subjekti dhe personat e lidhur në deklaratat periodike/vjetore.

7.11. Në këto kushte, Komisioni vlerëson se pakësimet në shumën 100.000 lekë për vitet 2009 dhe 2010, të deklaruara në pyetësin nr. 2, nuk merren në konsideratë për sa kohë nuk janë deklaruar në deklaratën periodike vjetore përkatëse. Gjithashtu, nuk merret në konsideratë dhe deklarimi i subjektit se në DIPP-në e vitit 2010, shtesa prej 300.000 lekësh ka qenë 2.000 euro, përderisa në deklaratë është deklaruar qartësisht se shtesa ka qenë në shumën 300.000 lekë dhe deklarimi është bërë në datën 15.3.2011.

7.12. Gjithashtu, edhe deklaratimet lidhur me pakësimet në shumat 700.000 lekë dhe 3.000 euro për vitin 2011, në procesverbalin e ILDKPKI-së, nuk merren në konsideratë, për sa kohë nuk janë ndrequr me vullnetin dhe iniciativën e vetë subjektit të rivlerësimit, por duket që janë bërë në funksion të konstatimit të balancës negative nga ILDKPKI-ja.

1.1. Për rrjedhojë, gjendja e likuiditeteve *cash* në fund të vitit 2016, duket se ka qenë në shumat 1.500.000 lekë dhe 3.000 euro, ndërkohë që në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti ka deklaruar shumat 300.000 lekë dhe 2.000 euro.

7.13. Në përfundim, Komisioni vlerëson se ka deklarim jo të saktë dhe në përputhje me ligjin, duke pasur parasysh mospërputhjet midis gjendjes së likuiditeteve *cash* të grumbulluara në fund të vitit 2016 dhe gjendjes së likuiditeteve *cash* të deklaruar në deklaratën *Vetting*, duke u gjendur në kushtet e germës “a”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Analiza financiare e Komisionit lidhur me vlerësimin e pasurisë

7.14. Komisioni kreu analizën financiare duke konsideruar pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur për periudhën 1998 – 2016, nga ku rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë qenë në pamundësi për të përballuar me burime të ligjshme blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve ndër vite.

7.15. Në përfundim, referuar shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti, në prapësime, të cilat janë analizuar në paragrafët përkatës të këtij vendimi, analiza financiare pasqyrohet në tabelën në vijim:

Viti	Pasuri	Ndryshim likuiditete <i>cash</i>	Ndryshim likuiditete bankë	Të ardhurat	Detyrimet	Shpenzime	Diferenca për shpenzime	Vitet me balancë negative
1998 - 2003	0	450,000	420,895	3,291,091	0	1,821,057	599,139	0
2004	0	-450,000	63,051	1,167,210	-500,000	389,397	664,762	0
2005	0	500,000	70,669	1,110,419	0	438,228	101,522	0
2006	600,000	0	-122,788	1,214,589	0	502,959	234,418	0
2007	0	241,820	81,863	1,198,649	0	747,372	127,594	0
2008	6,500,000	623,180	-24,504	4,446,845	3,300,000	599,722	48,446	0
2009	0	200,000	701,228	3,924,680	-2,600,000	1,260,023	-836,571	-836,571
2010	0	300,000	-173,239	1,484,458	0	1,289,473	68,224	0
2011	9,994,658	0	164,475	1,660,689	1,190,000	1,910,041	-9,218,485	-9,218,485
2012	0	0	54,230	1,720,971	0	764,551	902,191	0
2013	0	0	-646,356	1,707,463	-700,000	1,309,549	344,270	0
2014	0	0	27,053	2,331,938	-700,000	1,793,295	-188,410	-188,410
2015	0	119,419	-92,475	2,092,698	0	1,334,480	731,274	0
2016	0	-119,419	12,618	2,019,312	0	1,623,596	502,517	0
TOTAL	17,094,658	1,865,000	536,720	29,371,012	- 10,000	15,783,745	-5,919,110	-10,243,466

Përfundimet e Komisionit lidhur me vlerësimin e pasurisë

7.16. Trupi gjykues, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, arrin në këto përfundime:

- i.** Deklarime jo të sakta dhe në përputhje me ligjin dhe mungesë të burimeve të ligjshme për financimin e pasurisë apartament me sip. 98 m² dhe garazh me sip. 25 m² në Vlorë, duke u gjendur në kushtet e germave “a” dhe “b”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.
- ii.** Mungesë të burimeve të ligjshme për financimin e pasurisë apartament me sip. 95 m², dhe 2 garazhe, në S., Tiranë, duke u gjendur në kushtet e germës “b”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.
- iii.** Mungesë të burimeve të ligjshme për financimin e pasurisë autoveturë tip “Daimler Chrysler” (Mercedes-Benz), me vlerë 3.850 euro, prodhim i vitit 2004, duke u gjendur në kushtet e germës “b”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016
- iv.** Deklarime jo të sakta dhe në përputhje me ligjin, në lidhje me deklarimin e gjendjes së likuiditeteve *cash* në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, duke u gjendur në kushtet e germave “a” dhe “b”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.
- v.** Mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve, ndër vite, sipas analizës financiare të Komisionit, duke u gjendur në kushtet e germës “b”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

7.17. Si konkluzion mbi rivlerësimin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me këtë kriter, duke u gjendur në kushtet e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

B. KONTROLLI I FIGURËS

1. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 1.6.2021, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 31.5.2021, të KDZH-së, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

2. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit Albert Spiro: (a) ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar; (b) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej tij në deklaratën për kontrollin e figurës; (c) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

3. Pavarësisht raportit të dërguar nga DSIK-ja, Komisioni ka kryer hetim administrativ, prej të cilit rezulton se konstatimet e Grupit të Punës për kontrollin e figurës janë të sakta.

Hetimi i Komisionit

4. Nisur nga informacionet e marra nga organet verifikuese, Komisioni hetoi lidhur me personin tjetër të lidhur A.H. Nga dokumentacioni i administruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë¹¹⁹ rezultoi se pranë kësaj gjykate është gjykuar dosja penale nr. ***, datë 15.11.2008, me të pandehur A.H., i akuzuar për veprat penale “shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë” dhe “shpërdorim detyre”, të parashikuara nga nenet 289/2 dhe 248 të Kodit Penal, me objekt vlerësimin e masës së ndalimit.

5. Komisioni kërkoi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë¹²⁰ informacion lidhur me gjykimin e çështjes në themel. Në përgjigje, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë¹²¹ sqaron se nuk kishte çështje penale themeli në ngarkim të shtetasit A.H. për veprat penale të parashikuara nga nenet 289/2 dhe 248 të Kodit Penal.

6. Në vijim, Komisioni kërkoi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë¹²² kopje të dosjes së procedimit penal në ngarkim të shtetasit A.H. Në përgjigje,¹²³ ky institucion vuri në dispozicion të Komisionit kopje të dosjes së procedimit penal nr. ***, të vitit 2008, që bën fjalë për veprën penale “vrasje në rrethana të cilësuar”, “shkatërrim i pronës” dhe “shpërdorim i detyrës”, të parashikuara nga nenet 79/g, pika “e”, 150 dhe 248, të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit A.H.

7. Nga shqyrtimi i dosjes rezultoi se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin e datës 26.2.2009, ka vendosur pushimin e hetimeve në ngarkim të personit nën hetim A.H. me arsyetimin se ky shtetas, në rastin konkret, në shoqërinë e “****” nuk ka pasur funksione të përcaktuara, funksione nga të cilat mund të buronin përgjegjësi ligjore, por njëkohësisht as *de facto*, gjatë kryerjes së punimeve për hapen e sheshndërtimit dhe ndërtimin e murit mbajtës beton/arme nuk ka ushtruar funksione që mund ta ngarkonin me përgjegjësi.

8. Në përfundim, Komisioni vlerëson se personi tjetër i lidhur, shtetasi A.H., nuk është akuzuar për vepra penale të parashikuara nga neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale dhe pikës 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, që mund të vlerësohet si kontakt i papërshtatshëm nga subjekti i rivlerësimit. Gjithashtu, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë pjesë e trupës gjyqësore në vendimet gjyqësore të marra ndaj tij.

Përfundimet e Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

9. Nga hetimit administrativ i Komisionit nuk u provua në ndonjë formë që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, nuk është i përfshirë, si dhe nuk është i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

¹¹⁹Shkresë nr. *** prot., datë 11.5.2021.

¹²⁰Shkresë nr. *** prot., datë 20.5.2021.

¹²¹Shkresë nr. *** prot., datë 25.5.2021.

¹²²Shkresë nr. *** prot., datë 20.5.2021.

¹²³Shkresë nr. *** prot., datë 27.5.2021.

10. Në përfundim të hetimit administrativ, vlerësimi të provave dhe shpjegimeve të subjektit, Komisioni vlerëson se subjekti ka plotësuar saktë deklaratën e kontrollit të figurës, nuk ka kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të pikës 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, duke konkluduar se subjekti i rivlerësimit Albert Spiro ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

11. Në përfundim, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në kohën e përcaktuar nga ligji nr. 84/2016, nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe nuk ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kontrollin e figurës, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

1. Sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, relatori përgatit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale mbështetur në raportin e inspektorëve, informacionin e marrë nga burime të tjera, si dhe në kriteret e vlerësimit, të parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve dhe akteve të tjera ligjore.

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ka përgatitur një raport për vlerësimin profesional si vijon:

3. Ky raport vlerësimi ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të vlerësimit: (a) aftësive profesionale; (b) aftësive organizative; (c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; (d) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

4. Ky vlerësim është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (1) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (2) pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (3) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

5. Nga analiza e të dhënave në dosjen personale konstatohet se gjyqtari Albert Spiro ka marrë titullin “Jurist” në Universitetin e Tiranës në datën 4.7.1996. Pas studimeve në datën 9.5.1998 është emëruar: ndihmës gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë; në datën 27.4.2000 është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tepelenë; në datën 6.11.2007 është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë; dhe nga data 7.1.2019 ushtron detyrën e zëvendëskryetarit të po kësaj gjykate.

Lidhur me aftësitë profesionale

Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit Albert Spiro ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Kualifikon drejt marrëdhënien juridiko-civile, objekt shqyrtimi gjyqësor. I kushton rëndësinë e duhur identifikimit të kërimit të palëve, dëgjon kërkimet procedurale të tyre, shprehet në çdo rast me urdhra dhe vendime të ndërmjetme të arsyetuara. Zbaton me korrektesë procedurën e gjykimit të shkurtuar, kriteret për aplikimin e dispozitës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim sipas nenit 59 të Kodit Penal. Njeh parimet e përgjithshme të së drejtës dhe i zbaton ato gjatë gjykimit, por nuk i përdor shprehimisht në tekstin e vendimeve përfundimtare.

Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit Albert Spiro ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare plotësojnë elementet e përcaktuara nga ligji, janë të ndara në tri pjesë dhe janë të kuptueshme. Pjesa hyrëse e vendimit ka qenë e plotë në çdo rast të vëzhguar. Z. Albert Spiro respekton rregullat e drejtshkrimit dhe, në përgjithësi, i përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Struktura është e qëndrueshme dhe e standardizuar, duke i shërbyer funksionit të qartësisë së argumentimit ligjor. Vendimet përfundimtare të tij plotësojnë, sipas rastit, kërkesat e legjislacionit procedural civil apo kërkesat e legjislacionit procedural penal. Subjekti i rivlerësimit duket që përdor të njëjtën strukturë në hartimin e vendimit.

Hetimi i Komisionit

6. Pavarësisht raportit të dërguar nga KLGJ-ja, Komisioni kreu një hetim të pavarur në lidhje me tri dokumentet e përzgjedhura nga subjekti, pesë dosjet e shortuara sipas një shorti objektiv dhe ankesave të paraqitura pranë Inspektoratit të KLD-së. Pas analizimit të tyre u konstatuan problematika dhe u kërkuar shpjegime dhe prova për dokumentin 2, të përzgjedhur nga subjekti dhe dosjet 2 dhe 3, të shortuara, si vijon:

7. Lidhur me dokumentin 2, vendimin nr. ***, datë 6.10.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me palë: paditës F.B.; të paditur Ministria e Zhvillimit Ekonomik Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes; person i tretë ZVRPP Vlorë; me objekt “detyrimin për njohjen e paditësin pronar për truallin për shkak të parashkrimit fitues”, Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti për konstatimin *se subjekti ka ndryshuar shkakun ligjor të padisë pa kërkesën e palës paditëse.*

8. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹²⁴ subjekti shpjegoi se pala paditëse në seancën gjyqësore të datës 20.7.2015 (f. *** e dosjes gjyqësore) ka paraqitur kërkesë për ndryshimin e objektit të padisë duke përcaktuar: “*Detyrimi i të paditurit Ministria e Zhvillimit Ekonomik Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për të njohur paditësin pronar mbi pasurinë e llojit truall nr. *** për shkak të parashkrimit fitues*”. Pra, nuk është bërë ndryshimi i objektit të padisë, por vetëm saktësimi i tij nga paditësi (pasi përsëri shkakun ligjor ka qenë parashkrimi) duke pretenduar si fitimin e pronësisë me parashkrim fitues me titull po ashtu edhe pa titull. Në rastin konkret nuk është tejkalar disponimi i palës paditëse mbi padinë, pasi ka kërkesë të palës për

¹²⁴E-mail i datës 5.7.2021, ora 12:40

saktësimin e objektit të padisë si në padi dhe në kërkimet përfundimtare pala paditëse ka kërkuar edhe pranimin e padisë në bazë të nenit 169 të Kodit Civil dhe e ka cituar përmbajtjen e atij neni dhe ka arsyetuar se plotësohen kërkesat për fitimin e pronësisë si me parashkrimin fitues me titull dhe atë pa titull.

9. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme.

10. Lidhur me dosjen 2, çështjen penale (masë sigurimi) nr. ***, datë 25.2.2015, që i përket Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me objekt “caktimi i masës së sigurimit ndaj të dyshuarit D.F. për veprën penale ‘vjedhje e energjisë elektrike ose impulseve telefonike’, parashikuar nga neni 137/2 i Kodit Penal”, të përfunduar me vendimin nr. ***, datë 26.2.2015, Komisioni kërkoi nga subjekti shpjegime për konstatimin se: “*Vendimi i dhënë nuk është i arsyetuar*”, pasi pavarësisht se në procesverbalin e seancës gjyqësore është përmendur qëndrimi i mbrojtësit, në vendimin gjyqësor ky qëndrim nuk është pasqyruar.

11. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹²⁵, subjekti shpjegoi se seanca e datës 26.2.2015 ka qenë me objekt caktim mase sigurimi dhe sipas parashikimeve të nenit 244 të Kodit të Procedurës Penale (para ndryshimeve me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017) është zhvilluar vetëm me praninë e prokurorit dhe pa praninë e mbrojtësit dhe personit ndaj të cilit kërkohej të caktohej masa e sigurimit. Pasqyrimi në fund të procesverbalit i shprehjes “... *mbrojtësja tha ...*” është një lapsus i sekretares gjyqësore për shkak të ngarkesës dhe nuk është verifikuar prej tij si gjyqtar në momentin e nënshkrimit të procesverbalit. Në vendimet që kanë të bëjnë me masat e sigurimit nuk analizohen provat në mënyrën klasike, por vetëm në kuadër të dyshimeve të arsyeshme për të krijuar bindjen te gjykata se personi i dyshuar është autori i veprës penale.

Analiza e Komisionit

12. Komisioni, duke marrë parasysh ngarkesën që kanë gjykatat, bazuar në parimin e proporcionalitetit të parashikuar në pikën 5 të nenit 4 dhe në pikën 1, të nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, vlerëson se subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme dhe parregullsia në procesverbalin e seancës gjyqësore nuk ndikon në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit.

13. Lidhur me dosjen 3, çështjen civile nr. *** regj., datë 7.9.2015 regj., që i përket palëve: paditës A.Xh.; person i tretë Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Vlorë, Qendra e Transferimit të Teknologjisë Bujqësore Shamogjin Vlorë, me objekt: “vërtetimin e faktit juridik të vjetërsisë në punë për periudhën shtator 1980 – korrik 1991 si punëtoresh”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 3.11.2015, Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti lidhur me konstatimin se: (i) *subjekti është shmangur nga arsyetimi, zbatimi i normës procedurale që orienton gjykatën në vlerësimin e rrethanave të faktit në harmoni dhe në raport me njëra-tjetrën, tregues që lidhen me nivelin e cilësisë së njohurive ligjore, të bazuar në treguesin e aftësisë së përgjithshme për të interpretuar ligjin sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016;* (ii) *duket se subjekti ka gjykuar këtë çështje në kushtet e konfliktit të interesit, duke qenë se avokat i palës paditëse (fituese e këtij gjyqi) ka qenë F.M., nga i cili në vitet 2007 – 2009 subjekti ka përfitur përdorimin pa kundërshpërblim të një apartamenti.*

¹²⁵E-mail i datës 5.7.2021, ora 12:40

14. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹²⁶ subjekti shpjegoi se nuk janë shkelur parashikimet e nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile në lidhje me strukturimin e vendimit. Në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit janë përmendur rrethanat e çështjes ashtu si janë konstatuar gjatë gjykimit nga provat e paraqitura nga pala paditëse. Në vendim rezulton analiza e faktit të pretenduar dhe provuar në gjykim në raport me dispozitën ligjore ku mbështetet padia. Fillimisht janë marrë në shqyrtim kërkesat që parashikon neni 388 i Kodit të Procedurës Civile dhe, më pas, është bërë analiza e kërkesave të ligjit në raport me atë çka është provuar në gjykim. Arsyetimi i këtij vendimi përmbush kërkesat ligjore procedurale dhe është sipas detyrimit që ka gjykata për të respektuar këtë standard në varësi të rrethanave konkrete dhe natyrës së vendimit. Vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë dhe nuk janë bërë vërejtje në lidhje me arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë.

17. Në lidhje me konstatimin se ka qenë në konflikt interesi për shkak se mbrojtës ka qenë z. F.M., nga i cili në vitet 2007 – 2009 ka përfituar përdorimin pa kundërshtim të një apartamenti, sqaron se në kohën e dhënies së këtij apartamenti z. F.M. ka qenë me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, detyrë të cilën e ka ushtruar deri sa ka dalë në pension në fillim të vitit 2011. Nga praktika gjyqësore rezulton se kërkesa për heqje dorë paraqitej dhe pranohej vetëm në momentin kur aktualisht mund të ishte në këto rrethana. Fakti se para 6 vjetësh ka përfituar përdorimin pa kundërshtim të një apartamenti nga ana e avokatit subjekti ka vlerësuar se nuk përbën shkak për heqje dorë dhe as për arsye serioze njëanshmërie.

18. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme.

Lidhur me aftësitë organizative

Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, gjyqtari Albert Spiro ka gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë gjithsej 1564 çështje gjyqësore, nga të cilat 530 çështje penale (222 penale themeli, masa sigurimi 127, penale e veçantë 135 dhe 46 përgjime), si dhe 1034 çështje civile (641 civile me palë kundërshtare dhe 393 kërkesa civile).

Sipas të dhënave statistikore rezulton se gjyqtari Albert Spiro, për periudhën e rivlerësimit, ka gjykuar për një periudhë 2-vjeçare 641 çështje civile të përgjithshme me palë kundërshtare, si dhe për një periudhë 1-vjeçare, 222 çështje penale krime dhe kundërvajtje. Rrjedhimisht, ngarkesa e tij sasiore ka qenë dukshëm mbi standardin minimal.¹²⁷

Në analizë të të dhënave të mësipërme konstatohet se subjekti i rivlerësimit, ndonëse ka pasur ngarkesë të lartë sasiore, respekton kohën në gjykim si element i rëndësishëm i procesit të

¹²⁶ E-mail i datës 5.7.2021, ora 12:40

¹²⁷ Sipas germës “e”, të pikës 3, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë, që është organizuar në dhomën civile, seksioni i përgjithshëm, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 120 gjykime çështjesh civile që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje me palë kundërshtare. Gjithashtu, sipas germës “a”, të pikës 3, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë, që është organizuar në dhomën penale, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 100 gjykime çështjesh penale (krime e kundërvajtje), pra për 3 vjet jo më pak se 360 çështje civile me palë kundërshtare dhe jo më pak se 300 çështje penale (krime e kundërvajtje).

rregullt ligjor dhe i ka gjykuar të gjitha çështjet brenda afateve standarde të gjykimit, qofshin çështje penale apo civile. Gjithashtu, i ka kushtuar rëndësinë e duhur arsytimit të vendimeve gjyqësore, duke respektuar afatet ligjore në çdo rast të vëzhguar.

Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit Albert Spiro ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore. Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje përmes vendimeve formale për caktimin e seancës përgatitore, të cilat janë marrë në një kohë të shkurtër duke filluar nga data e marrjes së çështjes me short. Seancat gjyqësore janë caktuar në një afat kohor të arsyeshëm. Ka rezultuar se seancat gjyqësore janë zhvilluar në orarin e planifikuar. Nga vëzhgimi i pesë dosjeve të shortuara rezulton se të gjitha seancat gjyqësore janë zhvilluar në sallë gjykimi dhe janë regjistruar me sistemin audio, ndërsa për çështjen penale masë sigurimi, gjykimi është zhvilluar në sallë, por është vendosur nga gjyqtari i çështjes që për shkak të natyrës së saj të mos mbahet në sistemin FTR audio.

Nga analiza e dosjeve gjyqësore rezulton se seancat gjyqësore janë caktuar nga 5-23 ditë nga njëra-tjetra dhe vetëm në një rast, seanca e radhës, duke përfunduar gjykimin e çështjeve brenda afatit 6-mujor të caktuar nga germës “e”, të pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit. Subjekti i rivlerësimit është kujdesur në të gjitha rastet për të respektuar afatin ligjor 5-ditor për shpalljen e vendimit të arsyetuar të parashikuar nga neni 308/2 i Kodit të Procedurës Civile apo për paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare të palëve sipas parashikimeve të nenit 302 të Kodit të Procedurës Civile.

Gjatë gjykimit, gjyqtari Albert Spiro ka monitoruar njoftimet e palëve për të shmangur vonesat në dërgimin e tyre apo për të siguruar zhvillimin korrekt të gjykimit. Ndjek hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve me të drejtat dhe detyrimet procedurale, si dhe për prezantimin e gjykatës. Orienton drejt debatin dhe hetimin gjyqësor, marrjen e provave, kërkimet dhe prapësimet e palëve deri në dhënien e vendimit përfundimtar. Për çdo kërkesë apo hap procedural merr rregullisht mendimin e palëve në gjykim. Ai i kushton rëndësi kërkimeve procedurale të palëve, në funksion të garantimit të pjesëmarrjes së plotë të palëve në proces dhe të dëgjimit të pretendimeve të tyre, si dhe kujdeset për të realizuar palët të drejtën e mbrojtjes apo përfaqësimit me avokat. Disponon me vendime të ndërmjetme të arsyetuara për çdo veprim procedural të kryer gjatë gjykimit.

Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short përgjithësisht nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Në dosje gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar. Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale. Radhitja e akteve në dosje nuk paraqet vështirësi për identifikimin dhe shfrytëzimin e tyre nga të interesuarit.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

Etika në punë

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarit Albert Spiro.

Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Albert Spiro dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Albert Spiro, për të cilin gjithashtu, në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve.

Aftësia personale dhe angazhimi profesional

Aftësia e komunikimit

Konstatohet se gjyqtari Albert Spiro komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse në gjykim. Ai ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse si gjatë veprimtarisë përgatitore dhe asaj gjyqësore, ku shfaq sjellje etike duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe duke respektuar barazinë e palëve. Në dokumentet dhe dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale dhe komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

Aftësia për të bashkëpunuar

Nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit Alberti Spiro për të bashkëpunuar me kolegët.

Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit Albert Spiro ka marrë pjesë në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit ka marrë pjesë në 14 seminare të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës (shihni trajnimet në 3 vitet e fundit). Këto të dhëna tregojnë se gjyqtari ka marrë pjesë në 27 ditë të formimit vazhdues për një periudhë trevjeçare. Lënda e trajnimit, ku ka marrë pjesë ka lidhje të arsyeshme kryesisht me detyrën e gjyqtarit të shkallës së parë. Gjyqtari, lidhur me trajnimet e tjera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, ka deklaruar se nuk ka pasur të tilla.

Të dhëna nga burime arkivore të KLGJ-së

19. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtarin Albert Spiro janë paraqitur gjithsej 6 ankesa në vitin 2015 në Inspektoratin e KLD-së. Ankesat e vitit 2015 janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, pasi pretendimet kanë rezultuar të pabazuara, ndër të cilat 2 ankesa me arsyetimin se pretendimet nuk përmbajnë fakte dhe rrethana për verifikim dhe 4 ankesa janë bashkuar me ankesa të tjera si ankesa të përsëritura më parë. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Albert Spiro përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk rezulton të ketë ardhur ndonjë kërkesë nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë propozuar në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë ndonjë masë për procedim disiplinor.

Hetimi i kryer nga Komisioni

20. Me shkresën nr. *** prot., datë 23.12.2020, Komisioni ka kërkuar informacion nga Prokuroria e Përgjithshme nëse në ngarkim të subjektit ka të regjistruar procedim penal, mosfillim ose pushim në ngarkim.

21. Më tej, Komisioni¹²⁸ kërkoi informacion nga Prokuroria e Përgjithshme nëse në ngarkim të subjektit ka të regjistruar procedim penal, mosfillim ose pushim në ngarkim.

22. Prokuroria e Përgjithshme¹²⁹ ka përcjellë pranë Komisionit informacionin e ardhur nga prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore dhe nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Ky institucion informoi se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda në datën 11.11.2018 ka regjistruar procedimin penal nr. *** për veprat penale “korrupsion aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, “korrupsion pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, të parashikuara nga nenet 319 dhe 319/ç të Kodit Penal.

23. Komisioni¹³⁰ kërkoi nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar kopje të fashikullit për procedimet penale nr. ***, datë 11.11.2018 dhe nr. ***, datë 20.12.2019. Në përgjigje¹³¹, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar informon se ndaj shtetasit Albert Spiro është regjistruar kallëzimi nr. ***, viti 2018 dhe pas kryerjes së verifikimeve është vendosur regjistrimi i procedimit penal nr. ***, viti 2018 për veprat penale të parashikuara nga nenet 319 dhe 319/ç pa emër të regjistruar. Pas kryerjes së hetimeve në lidhje me këtë procedim është vendosur dërgimi për kompetencë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në datën 18.12.2019 dhe është regjistruar me nr. ***, datë 20.12.2019. Ky procedim është në fazën e hetimit dhe nuk ka emra të regjistruar. Në vijim informon se ndaj shtetasit Albert Spiro është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, viti 2020. Pas kryerjes së verifikimeve në lidhje me kallëzimin është vendosur mosfillimi i procedimit. Bashkëlidhur ka dërguar fashikullin e procedimit në formatin elektronik CD.

24. Gjithashtu, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka regjistruar kallëzimin penal nr. ***, datë 18.11.2019 mbi bazën e kallëzimit të paraqitur nga shtetasi A.P. kundrejt subjektit Albert Spiro etj. Për këtë kallëzim është vendosur mosfillimi me vendimin e datës 6.12.2019. Bashkëlidhur ka vënë në dispozicion kopje të dosjes penale.

25. Lidhur me kallëzimin penal nr. ***, viti 2020, subjekti shpjegoi se ka qenë anëtar i trupit gjykues në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tepelenë si në vendimin e dënimit edhe në kërkesën për rishikim. Shtetasit i është garantuar e drejta e mbrojtjes dhe në vendimin përfundimtar është deklaruar fajtor dhe dënuar me burgim të përjetshëm për vrasjen e bashkëshortes dhe vajzës 13-vjeçare. Ka përfituar gjykimin e shkurtuar duke u dënuar me 25 vjet burgim. Vendimi nuk është ankimuar nga i pandehuri, ndërsa kërkesa për rishikimin e vendimit nuk ishte shoqëruar me asnjë akt provues, sikurse parashikohej nga neni 452 i Kodit të Procedurës Penale dhe nga

¹²⁸Shkresë nr. *** prot., datë 23.12.2020.

¹²⁹Shkresë nr. *** prot., datë 28.4.2020.

¹³⁰Shkresat nr. *** prot., datë 6.5.2021 dhe nr. *** prot., datë 10.5.2021.

¹³¹Shkresë nr. *** prot., datë 14.5.2021.

gjykata është vendosur mospranimi i kërkesës. Ky vendim është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë.

26. Në lidhje me kallëzimin penal nr. ***, datë 18.11.2019, të shtetasit A.P., subjekti shpjegoi se ka qenë anëtar i trupit gjykues së bashku me gjyqtarin S.H. dhe kryesuese ka qenë gjyqtare A.Z. Në datën 12.11.2019, ora 11:00, ishte caktuar seanca gjyqësore ndaj babait të tij, i cili ishte i përfaqësuar me avokat dhe ndërkohë që zhvillohej seanca prokurori ka kërkuar zëvendësimin e masës së sigurimit në “arrest me burg”. Trupi gjykues u tërhoq për të vendosur në lidhje me kërkesën. Sipas tij, jo vetëm ai nuk ka shkelur fshehtësinë e dhomës së këshillimit, por nuk ka konstatuar që ndonjë nga anëtarët e trupit gjykues të ketë komunikuar në lidhje me vendimin e gjykatës. Në përfundim të hetimeve edhe Prokuroria e Rrethit Fier ka konkluduar se fakti nuk përbën veprë penale, pasi sipas procesverbalit të ekzekutimit të vendimit të gjykatës, të mbajtur nga policia gjyqësore, ekzekutimi i vendimit për ndryshimin e masës së sigurimit në “arrest me burg”, është bërë në orën 14:10, pra rreth 2 orë pasi ishte shpallur vendimi.

27. Në përfundim të hetimit administrativ dhe pas shqyrtimit të fshikullit të dosjes penale Komisioni konstatoi se nuk ka indicie që të implikojë subjektin në kryerjen e ndonjë veprë penale apo cenim të figurës.

28. Në përfundim, Komisioni, pasi mori në shqyrtim ankesat e depozituara në KLD, si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore të analizuara nga KLGJ-ja, vlerëson se nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

DENONCIMET NGA PUBLIKU

Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Albert Spiro, janë administruar 12 denoncime nga publiku. Referuar nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kërkoi shpjegime për të gjitha denoncimet.

1. Në lidhje me denoncimin nr. * prot., datë 18.12.2017, të administruar nga Komisioni, i shtetasit S.K.,** i cili akuzon subjektin e rivlerësimit për vendim të padrejtë në kundërshtim me ligjin, si dhe kryerjen e veprimeve korruptive.

Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e tij, deklaroi se është i pabazuar. Ai ka shqyrtuar çështjen penale në ngarkim të shtetasit H.S. dhe ka marrë vendimin përkatës, i cili ka marrë formë të prerë. Në gjykimin civil denoncuesi ishte debitori dhe nuk e ekzekutonte vendimin gjykata. Në këtë çështje e ka këqyrur dhe vetë vendin e ngjarjes në prani edhe të denoncuesit.

Në përfundim, Komisioni, pasi shqyrtoi pretendimet e denoncuesit dhe u njoh me vendimin nr. ***, datë 29.1.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, konstaton se denoncuesi pretendon fakte që kanë lidhje me korrektësinë e vendimit, rrethana që nuk mund të shqyrtohet nga Komisioni sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016. Në këto kushte, në mbështetje të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni vlerëson se denoncimi nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

2. Në lidhje me denoncimin nr. * prot., datë 20.2.2018, të administruar nga Komisioni, i shtetases V.Xh.,** e cila kërkon që ndaj subjektit të rivlerësimit Albert Spiro dhe gjyqtarëve të tjerë të nisë hetim penal dhe disiplinor për shkak se ka dënuar djalin e saj, i cili ka qenë i pafajshëm, për veprën penale “prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike”, me 8 vjet burgim. Bashkëlidhur denoncimit ka dorëzuar kopje të ankimit të bërë përpara Gjykatës së Apelit Vlorë.

Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e tij, deklaroi se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka paraqitur kërkesën për gjykimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2013, në ngarkim të të pandehurve I.Xh. dhe E.L., të akuzuar se kanë kryer veprat penale “prodhim dhe shitje të narkotikëve në bashkëpunim” dhe “mbajtje, prodhim dhe transportim të substancave kimike”, parashikuar nga nenet 283/2 dhe 285 të Kodit Penal. Kjo çështje është kthyer për rigjykim nga Gjykata e Apelit Vlorë. Ndaj këtij vendimi është ushtruar rekurs nga Prokuroria e Apelit Vlorë dhe Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 31.3.2016, ka vendosur mospranimin e rekursit. Rigjykimi është zhvilluar në kushtet e mungesës për të pandehurin E.L. dhe të pandehurit I.Xh., i cili duke qenë me masë sigurimi “arrest në burg” i është fshehur hetimit dhe gjykimin të çështjes. Ky gjykim është zhvilluar me procedurën e gjykimin të zakonshëm dhe shkak për zgjatjen janë bërë procedurat e njoftimit të të pandehurit I.Xh., që ka qenë me masë sigurimi “arrest në burg” dhe për shkak se i është shmangur gjykimin është gjykuar në mungesë, mungesa e mbrojtëses së tij, mosparaqitja e dëshmitarëve për arsye dhe të padijenisë për shkak të njoftimeve pasi kanë qenë të larguar.

Në përfundim, Komisioni, pasi shqyrtoi pretendimet e denoncueses dhe u njoh me vendimin nr. ***, datë 27.7.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, që ka vendosur deklarin fajtor të të pandehurit I.Xh. për kryerjen e veprës penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve në bashkëpunim” dhe e ka dënuar me 8 vjet burgim dhe me vendimin nr. ***, datë 11.4.2018, të Gjykatës së Apelit Vlorë, që ka vendosur deklarin e pafajshëm të të pandehurit I.Xh., nëpërmjet faqes elektronike www.gjykata.gov.al, konstaton se denoncuesja pretendon fakte që kanë lidhje me korrektësinë e vendimit, rrethanë që nuk mund të shqyrtohet nga Komisioni sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016. Në këto kushte, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni vlerëson se denoncimi nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

3. Në lidhje me denoncimin nr. * prot., datë 20.2.2018, të administruar nga Komisioni me, i shtetases D.M.,** e cila ankohet për dhënien e një vendimi të padrejtë dhe për mbështetjen dhe favorizimin që i ka bërë prokurorit dhe të paditurit.

Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij deklaroi se shtetasi F.A. ka bërë kallëzim penal ndaj shtetasit B.A. për kryerjen e veprës penale “mashttrim”, të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal. Prokurori, me vendimin e datës 28.6.2017, vendosi të pushojë procedimin penal nr. ***, të vitit 2017, pasi fakti i kallëzuar nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Pas ankimit të shtetasit F.A., Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 12.12.2017, ka vendosur rrëzimin e ankimit të kërkuarit F.A. kundër vendimit të prokurorisë për pushimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2017. Në çështjen objekt gjykimi, gjykata vlerësoi se nuk ka veprime të tjera hetimore, të cilat duhet të kryhen dhe kanë rëndësi për mënyrën e zgjidhjes së

kësaj çështjeje penale dhe, për këtë shkak, kërkesa e palës ankuuese duhet të rrëzohet. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 6.7.2018.

Në përfundim, Komisioni, pasi u njoh me vendimin nr. ***, datë 12.12.2017, të gjyqtarit Albert Spiro, të vënë në dispozicion nga denoncuesja, vlerëson se denoncuesja në ankimin ka pasqyruar pretendime që kanë lidhje me themelin e çështjes, rrethana që nuk mund të shqyrtohen nga Komisioni, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit E, fjalia e fundit, e Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016. Në këto kushte, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni vlerëson se denoncimi nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

4. Në lidhje me denoncimin nr. * prot., datë 20.3.2018, të administruar nga Komisioni, i shtetasit G.T.**, i cili ankohet për veprime të kundërligjshme dhe për dhënien e vendimeve të paarsyetuara.

Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij deklaroi se ka qenë anëtar i trupit gjykues që ka shqyrtuar çështjen penale në ngarkim të të pandehurit G.T., i akuzuar për veprën penale “vjedhje duke shpërdoruar detyrën”, të parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal dhe, në përfundim, me vendimin nr. ***, datë 4.4.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë e ka deklaruar fajtor dhe dënuar me 5 vjet burgim. Pas ankimit në Gjykatën e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 21.1.2021, është vendosur prishja e vendimit nr. ***, datë 4.4.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe dërgimin e akteve në gjykatën kompetente, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. Ky shtetas është ankuar edhe pranë ILD-së dhe me vendimin nr. ***, datë 22.12.2020, nga ana e këtij institucioni është vendosur arkivimi i ankesës.

Në përfundim, Komisioni pasi u njoh me vendimin nr. ***, datë 4.4.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, nëpërmjet sistemit elektronik www.gjykata.gov.al, vlerëson se vendimi gjyqësor përmbush kriteret arsyetimit të përcaktuar në nenin 383, të Kodit të Procedurës Penale. Në këto kushte, në mbështetje të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni vlerëson se denoncimi nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

5. Në lidhje me denoncimin nr. * prot., datë 8.5.2018, të administruar nga Komisioni, i shtetasit R.K.**, i cili kundërshton vendimin nr. ***, datë 24.4.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, që ka vendosur rrëzimin e kërkesës për revokimin e vendimit të pushimit të çështjes penale nr. ***, të Prokurorisë së Rrethit Vlorë.

Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij deklaroi se gjykata, në vendim, ka arsyetuar se provat e reja të paraqitura nga pala kërkuuese gjatë këtij gjykimi, nuk krijojnë bindje se vendimi i pushimit për procedimin penal nr. ***, datë 15.10.2015, nuk është i bazuar. Janë paraqitur si prova për të revokuar vendimin e pushimit nr. ***, datë 23.6.2016, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë së bashku me aktekspertimin. Vetëm paraqitja e një prove, qoftë dhe aktekspertimi në një proces gjyqësor civil nuk ka pasoja mbi procesin penal dhe nuk mund të shërbejë si shkak për revokimin e vendimit të pushimit në rrethanat kur Kodi i Procedurës Penale parashikon se vetëm vendimi gjyqësor civil ka pasoje mbi procesin penal.

Në përfundim, Komisioni, pasi shqyrtoi pretendimet e denoncuesit dhe u njoh me vendimin nr. ***, datë 24.4.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe me vendimin nr. ***, datë 17.7.2018, të Gjykatës së Apelit Vlorë, nëpërmjet faqes elektronike www.gjykata.gov.al, vlerëson se në ankim denoncuesi ka pasqyruar pretendime që kanë lidhje me themelin e çështjes, rrethana që nuk mund të shqyrtohen nga Komisioni, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit E, fjalia e fundit, e Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016. Në këto kushte, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni vlerëson se denoncimi nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

6. Në lidhje me denoncimin nr. * prot., datë 24.5.2018, të administruar nga Komisioni, i shtetasit I.I.**, i cili ankohet se subjekti i rivlerësimit në vendimin nr. ***, datë 26.11.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nuk ka marrë parasysh provat e paraqitura në gjykim dhe ka kryer shkelje të renda procedurale pasi çështja duhej gjykuar me tre gjyqtarë.

Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij deklaroi se pretendimi është i pabazuar. Denoncuesi ka paraqitur ankim dhe pranë Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe për të katër ankimet është vendosur arkivimi dhe mospranimi i ankesës.

Në përfundim, Komisioni, pasi u njoh me vendimin nr. ***, datë 26.11.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit si dokument ligjor për rivlerësimin e aftësive profesionale, vlerëson se denoncuesi parashtron pretendime që kanë lidhje me themelin e çështjes, rrethana që nuk mund të shqyrtohen nga Komisioni sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit E, fjalia e fundit, e Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016. Në këto kushte, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni vlerëson se denoncimi nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

7. Në lidhje me denoncimin nr. * prot., datë 11.7.2018, të administruar nga Komisioni, i shtetasit D.R.**, i cili akuzon subjektin e rivlerësimit për shpërdorim detyre.

Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij deklaroi se vendimmarrja është kontrolluar në të gjitha shkallët e gjyqimit dhe ka mbetur në fuqi dhe mendon se ankimi është i pabazuar.

Nga verifikimet e bëra në faqen elektronike www.gjykata.gov.al dhe në faqet elektronike zyrtare të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, Komisioni konstatoi se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 5.10.2010, të Gjykatës së Apelit Vlorë. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. ***, datë 18.7.2013, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga z. D.R. Në vijim, denoncuesi ka paraqitur kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese, e cila me vendimin nr. ***, datë 8.11.2013, ka vendosur rrëzimin e kërkesës.

Në përfundim, Komisioni, pasi shqyrtoi pretendimet e denoncuesit dhe u njoh me vendimin nr. ***, datë 15.10.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të paraqitur nga denoncuesi, vlerëson se denoncuesi ka ngritur pretendime që kanë lidhje me themelin e çështjes, rrethana që nuk mund të shqyrtohen nga Komisioni sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit E, fjalia e fundit, e Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016. Në këto kushte, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe

prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni vlerëson se denoncimi nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

8. Në lidhje me denoncimin nr. * prot., datë 18.12.2019, të administruar nga Komisioni, i shtetasit B.Sh.,** i cili akuzon subjektin e rivlerësimit për dhënie vendimi të padrejtë dhe mos heqjen e masës së sigurimit “arrest shtëpie”.

Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij deklaroi se ankuesi ka qenë i pandehur në çështjen përkatëse dhe gjatë gjykimit ka paraqitur disa herë kërkesa për zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi”. Nga provat e paraqitura gjykata ka vlerësuar se kjo kërkesë duhet të rrëzohet. Për problemet shëndetësore që ka pasur nga gjykata janë njoftuar shërbimet e policisë që të mos e pengojnë në datat e caktuara që ai ka pretenduar se duhet të shkonte për vizitë mjekësore. Vendimi është dhënë mbi bazën e provave të shqyrtuara me procedurën e gjykimit të zakonshëm dhe bindja e gjykatës ka qenë se denoncuesi ka kryer veprë penale dhe për këtë shkak e ka deklaruar fajtor. Subjekti mendon se ankimi është i pabazuar.

Në përfundim, Komisioni, pasi u njoh me vendimin nr. ***, datë 8.11.2019, të Gjykatës së Apelit Vlorë nëpërmjet sistemit elektronik www.gjykata.gov.al, vlerëson se pretendimet e denoncuesit kanë lidhje me themelin e çështjes, rrethana që nuk mund të shqyrtohen nga Komisioni sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit E, fjalës e fundit, e Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016. Në këto kushte, në mbështetje të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni vlerëson se denoncimi nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

9. Në lidhje me denoncimin nr. * prot., datë 15.1.2020, të administruar nga Komisioni, i shtetasit A.A.,** e cila pretendon se subjekti ka kryer veprime në kundërshtim me ligjin.

Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij deklaroi se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka paraqitur kërkesën për dërgimin në gjyq të çështjes penale nr. ***, të vitit 2018, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier me të pandehur shtetasin E.A., i akuzuar se ka kryer veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290/1/4, i Kodit Penal. Me vendimin nr. ***, datë 30.10.2019, gjykata e ka deklaruar fajtor dhe e ka dënuar me 6 vjet burgim. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 16.9.2020, të Gjykatës së Apelit Vlorë. Ai ka qenë kryesues i trupit gjykues dhe gjykimi është zhvilluar me procedurën e gjykimit të zakonshëm duke pranuar dhe shqyrtuar të gjitha provat e kërkuara nga palët.

Në përfundim, Komisioni, pasi mori në shqyrtim pretendimet e denoncueses dhe u njoh me vendimin nr. ***, datë 8.11.2019, të Gjykatës së Apelit Vlorë, nëpërmjet sistemit elektronik www.gjykata.gov.al, vlerëson se denoncuesja në ankimin e saj ka paraqitur pretendime që kanë lidhje me themelin e çështjes, rrethana që nuk mund të shqyrtohen nga Komisioni sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit E, fjalës e fundit, e Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016. Në këto kushte, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni vlerëson se denoncimi nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

10. Në lidhje me denoncimin nr. * prot., datë 9.3.2020, të administruar nga Komisioni, i shtetases Zh.K.,** e cila akuzon subjektin e rivlerësimit për pushimin e çështjes penale të filluar sipas kallëzimit penal që ankuesja kishte bërë ndaj ZVRPP-së. Prokuroria, pas përfundimit të hetimeve doli në konkluzionin se juristi i ZVRPP-së Vlorë, z. L.S. ka konsumuar elementet e veprës penale të parashikuar nga neni 190/3 i Kodit Penal dhe e ka dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij deklaroi se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, pas përfundimit të hetimeve doli në konkluzionin se juristi i ZVRPP-së Vlorë, z. L.S., ka konsumuar elementet e veprës penale të parashikuar nga neni 190/3 i Kodit Penal dhe e ka dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Veprimet e kryera nga i pandehuri L.S. kanë të bëjnë me pranimin e aplikimit të kryer nga shtetasja P.K. Nga certifikata e përbërjes familjare të z. T.K., lëshuar në datën 12.4.2017, është vërtetuar se në datën 1.12.1992, pjesëtarë të familjes kanë qenë shtetasit T., Zh., N. dhe P.K., si dhe dy fëmijët e mitur të shtetasve T. dhe Zh.K. Në formularë e aplikimit nuk rezultoi që të ketë paraqitur të dhëna të rreme ose të mos kenë paraqitur të dhëna që kanë rezultuar nga dokumentacioni përkatës. Si kryerja e procedurave për pajisjen me certifikatë pronësie dhe regjistrimi në emër të bashkëpronarëve parashikohen në ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”. Si pasojë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 8.10.2019, ka vendosur pushimin e çështjes penale.

Në përfundim, Komisioni, pasi shqyrtoi pretendimet e denoncueses, u njoh me vendimin nr. ***, datë 11.5.2020, të Gjykatës së Apelit Vlorë, e cila ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, vlerëson se denoncuesja ka paraqitur pretendime që kanë lidhje me themelin e çështjes, rrethana që nuk mund të shqyrtohen nga Komisioni, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit E, fjalës e fundit, e Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016. Në këto kushte, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni vlerëson se denoncimi nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

11. Në lidhje me denoncimin nr. * prot., datë 29.5.2020, të administruar nga Komisioni, i shtetasit I.Gj.,** i cili ankohet për një proces jo të rregullt ligjor.

Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij deklaroi se ka qenë anëtar i trupit gjykues që ka gjykuar çështjen penale në ngarkim të shtetasit I.Gj. etj. dhe, në përfundim, me vendimin nr. ***, datë 2.7.2001, është deklaruar fajtor për veprën penale “vjedhje me pasojë vdekjen” 2 herë, “armëmbajtje pa leje” dhe në bashkim të dënimeve është dënuar me burgim të përjetshëm. Vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjjirokastër me vendimin nr. ***, datë 3.5.2002, dhe Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 25.10.2002, ka vendosur mospranimin e rekursit. Pretendimet e këtij shtetasi janë shqyrtuar gjatë gjykimeve dhe kanë rezultuar të paprovuara dhe, në këto rrethana, vlerëson se ankimi është i papabuar.

Në përfundim, Komisioni, pasi shqyrtoi pretendimet e denoncuesit, u njoh me vendimet: nr. ***, datë 2.7.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tepelenë; nr. ***, datë 3.5.2002, të Gjykatës së Apelit Gjjirokastër; nr. ***, datë 22.12.2016, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë të paraqitura nga denoncuesi, konstaton se denoncuesi ka paraqitur pretendime që kanë lidhje me themelin e çështjes, rrethana që nuk mund të shqyrtohen nga Komisioni sipas përcaktimit

të pikës 2, të nenit E, fjalës e fundit, e Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016. Në këto kushte, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni vlerëson se denoncimi nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

12. Në lidhje me denoncimin nr. *, datë 28.12.2020, të administruar nga Komisioni, i shtetasit K.C., i cili ka paraqitur kallëzim penal ndaj disa subjekteve të rivlerësimit, si dhe subjektit Albert Spiro.**

Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij deklaron se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka paraqitur kërkesën për caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale dhe masa e sigurimit personal me karakter ndalues “ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale ose afariste”, parashikuar nga neni 243 i Kodit të Procedurës Penale ndaj shtetasit K.C., i dyshuar për kryerjen e veprës penale “falsifikim të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal. Sipas grafikut të gatishmërisë, në datën 14.12.2020, kjo çështje i ka kaluar për gjykim. Me vendimin nr. ***, datë 16.12.2020, në dhomë këshillimi ka vendosur pranimin e kërkesës. Në datën 23.12.2020 i është komunikuar ky vendim mbrojtësit të shtetasit K.C., si dhe data e seancës gjyqësore për verifikimin e masës së sigurimit datë 28.12.2020. Në këtë datë është paraqitur vetëm mbrojtësi dhe seanca është shtyrë për në datën 29.12.2020, ku është paraqitur edhe ankuesi K.C. Në këto rrethana, pretendimet e tij se janë shkelur nga gjyqtari i çështjes dispozitat mbi njoftimin dhe gjykimin e tij në mungesë janë të pavërteta.

Në përfundim, Komisioni, pasi shqyrtoi pretendimet e denoncuesit vlerëson se referuar nenit 244 të Kodit të Procedurës Penale, i ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, vendimi i gjykatës për caktimin e masave të sigurimit merret në dhomë këshillimi. Në këto kushte, denoncimi nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në provat që disponon për vlerësimin e pasurisë, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, vendosi që subjektin të rivlerësimit Albert Spiro, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, t’i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neneve Ç, D dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, si dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Albert Spiro, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 12.7.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Brunilda BEKTESHI
Kryesuese

Etleda ÇIFTJA
Relatore

Pamela QIRKO
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Olsida Goxhaj